

*Inkurajimi i një perspektive kritike të  
historisë në Kosovë:  
Diskutimi i narracionit të Luftës së  
Dytë Botërore nga mësuesit  
e historisë*

*Nga*

*Anna Di Lellio, Orli Fridman,  
Srđan Hercigonja dhe Abit Hoxha*

*Shkurt 2017*

Inkurajimi i një perspektive kritike të historisë në Kosovë:  
Diskutimi i narracionit të Luftës së Dytë Botërore nga mësuesit e historisë

**Autorët:**

Anna Di Lellio, Orli Fridman, Srđan Hercigonja dhe Abit Hoxha

**Përkthimi në serbisht:**

Luna Đorđević

**Përkthimi në shqip:**

Garentina Kraja



**I financuar nga:**



Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht qëndrimet e Agjencisë Austriake për Zhvillim.

## Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhja Ekzekutive .....	4
Kapitulli 1: Hyrje .....	6
Kapitulli 2: Rreth hulumtimit.....	8
Kapitulli 3: Historiografia e Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi, Serbi dhe Kosovë – 1945 deri tani .....	14
Kapitulli 4: Arsimtarët e historisë dhe mësimi i historisë në shkollat në gjuhën serbe të Kosovës.....	31
Kapitulli 5: Arsimtarët e historisë dhe mësimi i historisë në shkollat në gjuhën shqipe të Kosovës .....	40
Kapitulli 6: Përmbyllje.....	52
Shtojca A: Konteksti Ligjor.....	56
Shtojca B: Librat Shkollorë .....	57
Shtojca C: Lista e Intervistave.....	58

## Përmbledhja Ekzekutive

Ky raport ofron një perspektivë unike lidhur me mënyrën se si mësohet aktualisht historia në shkollat e mesme në Kosovë, duke u fokusuar në mësimin e historisë së Luftës së Dytë Botërore. Konkluzionet e këtij raporti bazohen në hulumtimin e kryer nga dy grupe studiuesish, të cilët studiojnë të dy sistemet arsimore që funksionojnë në Kosovë, njëri i administruar nga autoritetet e Kosovës (shkollat e mesme në shqip) dhe tjetri i administruar nga Beogradi (shkollat e mesme në serbisht). Duke kryer intervista të thelluara me njëzet e pesë (25) mësimdhënës, studiuesit ju afrojnë më shumë se çdo studim paraardhës asaj që ndodh realisht gjatë diskutimeve në klasë.

Studiuesit zgjedhën mësimin e historisë së Luftës së Dytë Botërore, sepse kjo luftë, e cila i dha jetë Jugosllavisë socialiste, ka pasur të njëjtën fuqi për të prodhuar narracione dhe kundërnarracione kombëtare, si asnjë ngjarje tjetër në historinë moderne të Kosovës dhe Serbisë. Në fakt, analiza e burimeve parësore dhe dytësore mbi librat shkollorë të historisë për Luftën e Dytë Botërore, e cila parashtrohet në këtë raport, rrëfen se si historia e këtij konflikti – qoftë kjo historia e shqiptarëve apo historia e serbëve – është dominuar nga pikëpamje të ngushta dhe të egzagjeruara në një drejtim apo një tjetër, gjë që reflekton një lidhje të fortë mes narracionit historik dhe çështjeve që lidhen me krijimin e kombit.

Gjithsesi, gjetjet e këtij raporti tregojnë se problemi me mësimin e historisë së Luftës së Dytë Botërore nuk ka të bëjë thjesht me faktin që narracionet nacionaliste që përjashtojnë njëra-tjetrën, vazhdojnë të dominojnë. Realiteti është më kompleks:

- Mësimdhënësit nga të dyja grupet janë “rojet” e narracioneve përkatëse kombëtare. Por, këto narracione kombëtare nuk janë homogjene – çdo mësimdhënës ndikohet edhe nga qendrimi i tij/saj ideologjik dhe politik, ndërkohë që e kaluara e mësimdhënësit përcakton qasjen e tij gjatë mësimdhënies, si dhe gjatë ndërveprimit të tij me historinë.
- Mësimdhënësit janë dyshues ndaj ndikimit të autoriteteve institucionale – qeveritë e huaja, organizatat ndërkombëtare, ministritë e vendeve përkatëse – mbi praktikën dhe mjetet e tyre didaktike. Por, ata janë edhe konformistë dhe implementojnë në një masë të madhe udhëzimet administrative, si kurrikula dhe programet, për sa kohë që këto të fundit nuk shkojnë ndesh me idetë që janë të rrënjësura thellë në historitë personale dhe të përbashkëta lidhur me Luftën.
- Këto histori personale dhe të përbashkëta që mësuesit përdorin gjatë diskutimeve në klasë, nuk janë thjesht private. Ato përputhen me përkatësitë politike që ekzistojnë nën atë që duket si një narracion homogjen kombëtar. Këto histori janë, po ashtu, ideologjike dhe kontribuojnë që të bëhet më e vështirë për të kuptuar disa pyetje themelore lidhur me Luftën e Dytë Botërore: Cila është natyra e fashizmit? Cilat janë format e ndryshme të rezistencës ndaj fashizmit? Cilët ishin partizanët? Çfarë është Holokausti?

Ky raport arrin në konkluzionin se mësimdhënësit e historisë në Kosovë kanë nevojë të kenë në dispozicion studime më të mira historike. Sidoqoftë, ndryshimi nuk mund të vijë nga jashtë,

as edhe nga reformatore që mund të kenë qëllimet më të mira, siç janë, për shembull, grupet e ekspertëve që janë të interesuar të promovojnë dialogun historik mes kombeve që janë në armiqësi me njëri-tjetrin.

Përndrazi, në mënyrë që të jetë efektiv, ndryshimi duhet të vijë fillimisht nga brenda, nga një thyerje në vetë-izolimin e historiografisë së Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe Serbi. Studiuesit shqiptarë dhe serbë kanë nevojë për fonde, në mënyrë që të studiojnë jashtë vendit, të hulumtojnë në arkivat në rajon dhe më tej, dhe të prodhojnë një literaturë të re mbi historinë e Luftës së Dytë Botërore, literaturë që merret me aspektet themelore të këtij konflikti, të cilat shpesh përjashtohen ose shtrembërohen nga narracionet historike kombëtare.

## Kapitulli 1: Hyrje

Ky hulumtim përqëndrohet në mësimdhënien për Luftën e Dytë Botërore nga mësimdhënësit në shkollat e mesme në Kosovë.

Viteve të fundit, një sërë publikimesh kanë analizuar rolin e zhvillimit të kurrikulës dhe librave të historisë në formësimin e mësimdhënies për të kaluarën në shtetet që dolën nga shpërbërja e Jugosllavisë.<sup>1</sup> Megjithatë, mësimdhënia e historisë ende nuk është hulumtuar, ndërkohë që roli i mësimdhënësit është kyç në formësimin e ballaqaqimit të nxënësit me historinë dhe kuptimin e historisë, historiografisë dhe, natyrisht, politikës së kujtesës. Ndryshe nga hulumtimi i deritashëm që është kufizuar në analizë krahasimore të instrumenteve të mësimdhënies – librave, kurrikulës zyrtare dhe pedagogjisë zyrtare – ne i trajtojmë drejtpërdrejt mësimdhënësit, në përpjekje për t’ju afruar dhe për të kuptuar atë që ndodh gjatë diskutimeve në klasë.

Përse hulumtimi ynë përqëndrohet në historinë e Luftës së Dytë Botërore?

Në Kosovë, historiografite e Luftës së Dytë Botërore, sikur edhe kujtimet individuale dhe kolektive, vazhdojnë të ndikojnë dhe të ndikohen nga shqetësimet aktuale politike. Kjo, natyrisht, nuk është dukuri e veçantë në Kosovë e as në rajonin e gjerë të ish-Jugosllavisë, me të cilin Kosova ndan historinë e pas-Luftës së Dytë Botërore.<sup>2</sup> Si njëra nga ngjarjet më traumatike të shekullit XX, Lufta e Dytë Botërore ka prodhuar historiografi të mitologjizuara dhe të politizuara, të cilat u shkojnë për shtat projekteve të legjitimitetit kombëtar dhe të mohimit në mbarë Evropën. Ky fenomen filloi menjëherë pas përfundimit të luftës, kur ish-Blloku Lindor dhe shtetet e Evropës Perëndimore ndërtuan legjitimitetin e tyre mbi bazën e përfaqësimit ikonik të betejës kundër fashizmit dhe nazizmit. Për Jugosllavinë e pasluftës, beteja anti-fashiste ishte miti i fuqishëm krijues që dominoi politikën arsimore dhe kulturore.<sup>3</sup>

1 Augusta Dimou, red., *“Transition” and the Politics of History Education in Southeast Europe*. George Eckert Institute (Göttingen: V&R Unipress), 2009; Wolfgang Hopken, red., *Oil on Fire? Textbooks, Ethnic Stereotypes and Violence in South Eastern Europe*. Georg Eckert Institute Studies on International Textbooks Research 89 (Hannover: Hahnsche Buchhandlung), 1996; Christina Kolouri, red., *Clio in the Balkans: The Politics of History Education* (Thessaloniki: Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe: 2002); Shkelzen Gashi, “Kosova 1912-2000 in the History Textbooks of Kosova and Serbia,” në *Civic and Uncivic Values in Kosovo. History, Politics, and Value Transformation*, i redaktuar nga Sabrina P. Sabrina, Albert Simkus, dhe Ola Listhaug (Budapest-New York: Central European University Press, 2015), 237-272, dhe “Kosova 1912-2000 in the History Textbooks of Kosova, Albania and Serbia” (Prishtina: KAHCR and KEC, 2012); Du-bravka Stojanović, “Secanje protiv istorije. Udzenici istorije kao globalni problem,” *Београдски историјски гласник IV* (2013): 185-204 dhe “Konstrukcija proslosti – slučaj srpskih udzbenika istorije,” *Genero, 10-11* (2007): 51-61 dhe “Serbia: History to Order,” (2007). <http://chalkboard.tol.org/serbia-history-to-order/> (linku i klikuar me shtator 26, 2016); Marijana Toma, red., *Forum za trazicionu pravdu - Udžbenici istorije u post-konfliktnim društvima: Obrazovanje za pomirenje?* (Beograd: Fond za humanitarno pravo, 2015).

2 Mes të tjerësh, Christian Karner and Bram Mertens, red., *The Use and Abuse of Memory. Interpreting World War II in Contemporary European Politics* (Transaction Publishers: 2013) dhe Richard Ned Lebow, Wulf Kansteiner, Claudio Fogu, red., *The Politics of Memory in Postwar Europe*, (Duke University Press, 2006).

3 Për diskutim gjithpërfshirës të konstruksionit kulturor të këtij miti krijues shih Andrew B. Wachtel, *Making a Nation, Breaking a Nation, Literature and Cultural Politics in Yugoslavia* (Stanford University Press: 1998).

Me rënjen e komunizmit dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian, në shumë shtete pati rishqyrtime zyrtare të kujtesës publike dhe historiografive kombëtare. Por ishte pikërisht në Jugosllavi që historiografite revizioniste të Luftës, mes shumë faktorëve të tjerë, që tragjikisht dhanë arsyetimin për shpërbërjen e unitetit supranacional të shtetit dhe luftrave të viteve 1990.<sup>4</sup> Në Kosovën e pasluftës, shtetësia e së cilës vazhdon të sfidohet nga Serbia,<sup>5</sup> historiografi të ndryshme për Luftën e Dytë Botërore ushqehen nga kujtime të ndryshme nacionale të kësaj ngjarje të dhunshme, dhe shpesh formësojnë ose formësohen nga interpretimet kontradiktore të historisë së gjashtë dekadave të fundit të Kosovës. Andaj, këto historiografi kanë potencial të thellojnë mosbesimin mes shqiptarëve dhe serbëve.

Ky hulumtim heton disa nga aktorët kyç që prodhojnë dhe transmetojnë historiografite dhe kujtimet serbe dhe shqiptare në Kosovë: mësimdhënësit e shkollave të mesme publike si “vektorë të kujtimit”<sup>6</sup>, bartës zyrtarë të versioneve të tyre të kujtesës historike. Roli i mësimdhënësve dhe zgjedhjet e tyre të prezantimit të historisë janë vendimtare, e shpesh edhe më të rëndësishme, se librat shkollorë të historisë. Për këtë arsye, ne kërkojmë t’i kuptojmë më thellë këta aktorë dhe rolin e tyre në përcaktimin e një të kaluare që kontestohet, në raport me të tashmen, si dhe strategjitë e tyre për ta përdorur politikisht të kaluarën.<sup>7</sup>

Ky raport përbëhet nga tri pjesë. Fillimisht, shpjegojmë se si e kemi dizajnuar hulumtimin (Kapitulli 2). Së dyti, bëjmë prezentimin e shqyrtimit të historiografisë së Luftës së Dytë Botërore që po pëson ndryshim, në Jugosllavi, Serbi dhe Kosovë, si dhe të një analize të librave shkollorë që përdoren nga mësimdhënësit serbë dhe shqiptarë (Kapitulli 3). Në pjesën e tretë, përshkruajmë dhe analizojmë intervistat e detajuara që kemi bërë me një mostër të përzgjedhur rastësisht të mësimdhënësve të shkollave të mesme, të cilët i kemi pyetur se si e diskutojnë Luftën e Dytë Botërore në klasë; si i përdorin tekstet shkollorë dhe materialet e tjera; dhe si ballafaqohen me ngjarjet traumatike të Luftës që kanë ndodhur në Kosovë (Kapitulli 4 dhe 5).

---

4 Për faktorët e shumtë që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë, përfshirë historiografinë, shih Dejan Jović, “The Disintegration of Yugoslavia: A Critical Review of Explanatory Approaches,” *European Journal of Social Theory* 4, 1 (2001): 101-120 dhe Jasna Dragović Soso, “Why did Yugoslavia Disintegrate? An Overview of Contending Explanations,” në *State Collapse in South-Eastern Europe: New Perspectives on Yugoslavia’s Dissolution*, i redaktuar me Lenard J. Cohen (West Lafayette: Purdue University Press: 2008), 1-39.

5 Nuk është vetëm Serbia ajo që nuk e ka njohur Kosovën, por vetëm Serbia është e rëndësishme të përmendet këtu përkitazi me hulumtimin tonë. Deri më sot, pavarësia e Kosovës është njohur nga 112 nga 193 vendet anëtare të OKB-së.

6 E kemi përdorur termin “vektorë të kujtimit” ashtu siç është vendosur në analizën e Francës së pasluftës nga Henry Rousso, *The Vichy Syndrome: History and Memory in France since 1944* (Harvard University Press, 1991). Shih gjithashtu Nancy Eood, *Vectors of Memory: Legacy of Trauma in Postëar Europe* (Oxford University Press: 1999).

7 Strategjitë e kujtimeve janë fokus i Georges Mink dhe Laure Neumayer, *History, Memory and Politics in Central and Eastern Europe. Memory Games* (Palgrave, 2013); Muriel Blaive, Christian Gerbel, dhe Thomas Lindenberger, red., *Clashes in European Memory. The Case of Communist Repression and the Holocaust* (Studien Verlag: 2011); Malgorzata Pakier, dhe Stråth Bo, *A European Memory? Contested Histories and Politics of Remembrance* (Berghan Books: 2010).

---

## Kapitulli 2: Rreth hulumtimit

Në pranverën e vonshme dhe verën e vitit 2016, ne intervistuar një grup mësimdhënësish të shkollave të mesme në Kosovë, shqiptarë dhe serbë.

Aktualisht këto dy grupe punojnë nën dy qeveri të ndryshme, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Serbisë. Megjithatë, kjo ndarje nuk ka qenë gjithmonë e evidente në të kaluarën, kur disa nga të intervistuarit kanë punuar nën autoritete dhe politika të ndryshme arsimore. E kemi pasur parasysh këtë kornizë të ndryshueshme institucionale, të cilën e adresojmë shkurtimisht në Kapitullin 3, kur i intervistuarim mësimdhënësit individualë se si ua mësojnë nxënësve historinë e Luftës së Dytë Botërore, në veçanti, se si është manifestuar në lokalitete.

Për intervistat, ne përgatitëm një shabllon pyetjesh, por nuk kemi përdorur anketë. Në vend të kësaj, ne zhvilluam biseda me mësimdhënës, si më poshtë.

### *Autorët/Hulumtuesit*

Dy ekipe hulumtuesish e dizajnuan studimin në tërësi, identifikuan mostrat dhe kryen intervistat. Të gjitha intervistat janë bërë në gjuhën amtare të të intervistuarve.

Mësimdhënësit shqiptarë janë intervistuar nga: Anna Di Lellio, profesoreshë e politikës pranë New York University (NYU) dhe The New School në Nju Jork, dhe drejtoreshë e Iniciativës së Historisë Orale të Kosovës; dhe Abit Hoxha, ekspert i mediave dhe kandidat doktore në gazetari, si dhe komentator i mirënjohur i çështjeve politike dhe kulturore në Kosovë. Në katër raste, intervistat janë bërë vetëm nga njëri nga anëtarët e ekipit, respektivisht dy nga Anna Di Lellio dhe dy nga Abit Hoxha.

Mësimdhënësit serbë u intervistuar nga Orli Fridman, profesoreshë e politikës pranë Fakultetit të Medias dhe Komunikimit (FMK), Singidunum University, dhe drejtoreshë e Qendrës për Studimeve Komparative të Konfliktit (CFCCS); dhe Srdjan Hercigonja, studiues i ri nga Qendra e Studimeve Komparative të Konfliktit pranë Fakultetit të Medias dhe Komunikimit. Hercigonja ka një diplomë master në shkencë politike. Hulumtimi interdisciplinor i Fridmanit në studimet e paqes dhe konfliktit dhe studimet e memories përqëndrohet në Serbi dhe në marrëdhëniet Kosovë-Serbi.

### *Të intervistuarit*

Bëmë gjithsej 24 intervista, të ndara në dy mostra: mësimdhënësit shqiptarë dhe serbë. Grupi i parë është më i madh, meqë popullata shqiptare në Kosovë është më e madhe se ajo serbe, dhe numri i shkollave është gjithashtu më i madh.

Te shqiptarët, kryem 17 intervista me mësimdhënës dhe 2 me autorë të teksteve shkollore të historisë; nga mësimdhënësit, njëri, së fundi, është bërë administrator për arsim dhe katër janë pensionuar. Te serbët, i bënë pesë intervista me mësimdhënës aktualë.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Gjithashtu, i kemi intervistuar edhe dy studentë doktore të historisë nga Mitrovica veriore, të cilët po trajnohen të bëhen mësimdhënës historie, dhe një intervistë përgatitore me një mësimdhënës historie në Beo-



Intervistat kanë parasysh dallimet rajonale, gjinore dhe moshore.

- Vendosëm në favor të përfaqësimit të gjerë rajonal, në mënyrë që të sigurojmë një pikëpamje gjithpërfshirës të arsimimit në fushën e historisë në Kosovë. Kosova përbëhet nga rajone që dallojnë ekonomikisht, politikisht dhe historikisht, dhe ne e filluam hulumtimin tonë me supozimin se prejardhja e mësimdhënësve apo vendi ku punojnë, ndikon në punën e tyre.
- Mësimdhënësit serbë i kemi intervistuar në dy lokacione: Mitrovicë të Veriut dhe në Graçanicë. Dy nga të intervistuarit jetojnë në rrethinën e Graçanicës (rreth 15 kilometra larg) dhe çdo ditë udhëtojnë në qytet nga fshati i tyre. Për shkak se qyteti gjendet në pjesën jugore të lumit Ibër, në afërsi të Prishtinës, konteksti shoqëror, kulturor dhe politik i këtyre mësimdhënësve është Kosova pas pavarësisë, në të cilën ata janë të integruar në shkallë të ndryshme. Tre mësimdhënësit të tjerë punojnë në Mitrovicën e veriut, që është në veri të Ibrit, ose pjesë e Kosovës që është e afërt me Serbinë. Dy jetojnë në qytet, ndërsa i treti që është me prejardhje nga Kosova dhe është zhvendosur më 1999, udhëton nga Serbia. Ata janë më larg Kosovës shtet, fjalë për fjalë dhe politikisht.
- Dallimet rajonale luajnë rol mes shqiptarëve, gjithashtu, dhe ne kemi përfshirë një varg të gjerë të tyre. Intervistua mësimdhënësit nga pjesa jugore e Mitrovicës, në Vushtrinë e afërt, Skënderaj të Drenicës; Pejë dhe Klinë, nga rajoni i Dukagjinit; Prizren; Gjakovë dhe Gjilan. Mësimdhënësit nga Prishtina janë të mbipërfaqësuar, për shkak se bëhet fjalë për kryeqytetin dhe qendrën më të madhe urbane të Kosovës.
- Jemi munduar të sigurojmë përfaqësim gjinor, ndonëse shumica e mësimdhënësve të historisë duket të jenë meshkuj, dhe si rrjedhojë femrat përbëjnë minoritet në mostrat tona: mes mësimdhënësve serb, një është grua, mes shqiptarëve, pesë.
- Të dyja mostrat përfshijnë mësimdhënës që kanë filluar të punojnë para vitit 1999, kur përfundoi lufta e fundit, dhe kur ndryshoi statusi i Kosovës, si dhe gjeneratën më të re që ka filluar të jap mësim pas luftës. Intervistimi i mësimdhënësve të gjeneratave të vjetra na ka lejuar ta shqyrtojmë mësimin e historisë që nga koha e Jugosllavisë e deri sot, përfshirë edhe shkollimin/trajnimin e të intervistuarve tanë.

---

grad. Dy studentët e doktoraturës janë gati për t'u bërë mësimdhënës të historisë meqë janë duke i finalizuar studimet në Universitetin e Prishtinës që për momentin gjendet në Mitrovicë. Intervista me mësimdhënësin e historisë në Beograd intervista me mësimdhënësin e historisë nga Beogradi është bërë për ta testuar dhe identifikuar dallimin mes mësimin të historisë në Serbi me atë në shkollat e mesme në gjuhën serbe në Kosovë.

## ***Përzgjedhja e të intervistuarve***

Të intervistuarit janë zgjedhur rëndom dhe përmes efektit të mbledhjes (topit të borës). Mësimdhënësit shqiptarë i kemi identifikuar pa përdorur kontaktet institucionale, për të siguruar liri të ballaqaqimit me të intervistuarit tanë. Filluam me raudin e parë të të intervistuarve në bazë të përvojës personale, njohurisë dhe kontakteve, dhe pastaj i pyetëm ata për kontakte tjera.

Të intervistuarit serbë fillimisht janë kontaktuar përmes telefonit dhe emailit, atëherë janë kontaktuar sërish me telefon para ardhjes në Kosovë. Komunikimi telefonik mes Kosovës dhe Serbisë është më shumë se thjesht një çështje teknike, është çështje politike. Thirrjet në celular nga Beogradi, Serbia, në çfarëdo lokacioni në jug të lumit Ibër në Kosovë, nënkuptojnë thirrje ndërkombëtare, meqë rrjeti mobil serb është jashtë funksionit në Kosovë për më shumë se një dekadë.<sup>9</sup>

Në mesin e mësimdhënësve shqiptarë që kontaktuam, një numër refuzuan të marrin pjesë duket na dhënë arsye të ndryshme. Tre mësimdhënës nga Prishtina na thanë se nuk kanë kohë. Një nga Gjilani refuzoi pasi sqaruam se një raport do të publikohet i bazuar në intervista. Përkundër disa përpjekjeve, ka qenë e pamundur të sigurojmë pjesëmarrjen e ndonjë mësimdhënësi nga Deçani, ku asociacioni i historianëve së fundi është përfshirë në një debat të tensionuar politik rreth historisë së Manastirit Ortodoks serb, dhe refuzoi ftesën që të jetë pjesë e këtij hulumtimi. Njëri nga këta mësimdhënës, gjithashtu, refuzoi pjesëmarrjen kur u njoftua se një hulumtues i huaj do të jetë i angazhuar në këtë përpjekje.

Të gjithë mësimdhënësit serbë që u jemi afruar, kanë pranuar të marrin pjesë në studim. Një mësimdhënës nga Mitrovica ka deklaruar se nuk është i gatshëm të flasë me dikë që gjuhë amtare e ka “*Šiptar*.”<sup>10</sup> Ndonëse mësimdhënësi ka pohuar një gjë të tillë gjoja për shkak të mungesës së njohurisë së gjuhës shqipe, çfarë ka nënkuptuar është se, nëse pjesëmarrja e tij në studim përfshin bisedë me një shqiptar, atëherë nuk do të ishte i gatshëm të intervistohet. Kur e ka kuptuar se intervistuesit janë nga Beogradi, atëherë është pajtuar të marrë pjesë.

## ***Dinamika mes intervistuesve dhe të intervistuarve***

Brenda serbëve të Kosovës ekziston ende një ndjenjë e fuqishme se dija është e përqendruar në Beograd. Kjo krijoi një dinamikë interesante me intervistuesit, derisa pjesëmarrësit herë pas here do t'i referoheshin Universitetit të Beogradit ose Serbisë si burim i dijes, dhe neve, hulumtuesve, si dikush që e di këtë fakt, në stilin “Ju jeni nga Beogradi, e dini.” Të gjithë mësimdhënësit që morën pjesë në intervista bashkëpunuan plotësisht me ne dhe u munduan të përgjigjeshin në pyetjet tona, të ndajnë pozicionin e tyre, përvojat dhe mendimet.

---

9 Kjo nuk vlen për thirrjet tokësore në Kosovë, të cilat ende janë me kodin shtetëror +381, që do të thotë se të thërrasësh nga Beogradi në Kosovë përmes linjës tokësore ende llogaritet si thirrje lokale. Së fundi, titujt mediatik sugjerojnë që Kosova mund ta marrë kodin e vet telefonik me kodin shtetëror +383.

10 *Šiptar* është term poshtëruar serb për shqiptar.

Përvoja jonë me hulumtimin në Mitrovicën e Veriut ka qenë shumë ndryshe nga përvoja jonë në Graçanicë. Si dy të jashtëm, si qytetare e Izraelit që jeton dhe punon në Beograd, dhe si një beogradas, qytetar i Serbisë, pozita jonë dhe qëllimet është dashur të sqarohen apo të theksohen në pjesën veriore të Kosovës. Mitrovica e Veriut është komunitet pak a shumë i mbyllur, i shkëputur nga Prishtina, ku qëndruam gjatë kohës sa ishim në Kosovë. Meqë vinim nga kryeqyteti, nuk mund të hynim në qytet me veturë dhe na është dashur ta kalojmë urën në këmbë. E kishim ndjenjën që në këtë qytet, pothuaj secili që vjen nga jashtë, sidomos nëse bëjnë pyetje, konsiderohen si vizitorë të rastësishëm dhe mbase të dyshimtë. Graçanica, në anën tjetër, është 10 minuta vozitje me veturë nga kryeqyteti. Aty nuk të jepet ndjenja e komunitetit të mbyllur. Shkëmbimet ditore dhe komunikimi mes kësaj komune dhe Prishtinës janë normalizuar disi viteve të fundit. Nuk kemi pasur ndjenjë të dyshimit ndaj nesh, bile në të kundërtën, ka pasur edhe pak interesim për të folur me ne, derisa u ftuam në shkollë. Nga 3 mësimdhënës të kontaktuar, arritëm t'i intervistojmë dy.

Të gjitha intervistat në Graçanicë janë zhvilluar në shkollë, në një klasë. Intervistat në Mitrovicë të Veriut janë zhvilluar në kafiteri, ndërkohë që në një rast e takuam mësimdhënësin në shkollë, në sallën e mësimdhënësve dhe u mirëpritëm me ngrohtësi nga pjesëmarrësja e vetme femër në studim.

Një dinamikë e tillë nuk i ka karakterizuar intervistat me mësimdhënësit shqiptarë. I intervistua mësimdhënësit shqiptarë në shkolla dhe kafiteri, varësisht nga koha kur i kemi zhvilluar intervistat. Nëse intervistat ishin aranzhuar pas mësimt, ato i kemi zhvilluar në kafiteri, ndërkohë që përndryshe ato janë bërë në shkolla, dhe në dy raste në qendër edukative.

Përpos intervistave, ne vizituam edhe disa klasë. Në Vushtrri, e vëzhguam orën e historisë për klasën e 10-të, ndonëse nuk ishte e përqendruar në Luftën e Dytë Botërore, ndërsa në Skenderaj dhe Prishtinë u takuam me klasën e 10-të dhe të 12, respektivisht, dhe zhvilluam bisedë me nxënës.

### ***Intervistat***

Intervistat përbëhen nga dy pjesë. Në pjesën e parë, i pyesim mësimdhënësit se si e kanë mësuar Luftën e Dytë Botërore dhe çfarë mbajnë mend nga shkollimi i tyre në lëndën e historisë. Pastaj bëjmë pyetje të përgjithshme se si e kanë mësuar dhe si e mësojnë historinë e Luftës së Dytë Botërore.

E kishim parasysh se u pëlqente të flisnin për referenca në kuptim të gjerë, dhe u ndjemë se vazhdimisht supozonin se pyetjet ishin për ngjarjet historike në përgjithësi dhe jo për metodën e mësimdhënies apo përmbajtjen. Mësimdhënësit gjithashtu patën tendencë të na japin përgjigje të përgjithësuar në pyetjet për ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, por përdorën edhe terminologji anekdotash dhe narracion. Ata nuk hezituan të flasin për burimet alternative që i përdorin, siç janë anekdotat, gojëdhënat nga dëshmitarët, dhe mediat. Kur u pyetën më specifikisht se si ua sqarojnë këto burime të ndryshme studentëve në raport me tekstet shkollore, përgjigjet e tyre dalluan.

Pjesa e fundit e intervistave është dizajnuar për t'i ballafaquar mësimdhënësit me përmbajtjen e librave shkollorë të historisë dhe historiografisë së njohur shkencore të Luftës së Dytë Botërore. Menduam që intervistat rekonstruktive ka gjasa të gjenerojnë përgjigje më të sakta dhe relevante se sa ato të siguruara gjatë pjesës së përgjithshme të intervistave.

Me mësimdhënësit shqiptarë, kjo pjesë e intervistës prodhoi debate faktuale rreth teksteve shkollorë, autorëve të teksteve, dhe diskrepancave mes mësimdhënies dhe historiografisë. Në përgjithësi, kjo ndodhi kur ata nuk pajtoheshin me përmbajtjen e librave shkollorë, ankoheshin për numrin e vogël të orëve mësimore që i kushtohen mësimi të Luftës së Dytë Botërore, por po ashtu u përgjigjen duke u mbrojtur ose duke kundërshtuar çfarë kishin thënë më herët.

Në rastin e mësimdhënësve serbë, sidomos atyre nga Mitrovica e Veriut, u ballafaquam me një mase pakënaqësie për shkak të pyetjeve që sfidonin narracionin popullor që i portretizon serbët si të vetmit antifashist, dhe shqiptarët si të gjithë bashkëpunëtorë të forcave okupuese. Shumica e mësimdhënësve serbë shprehën pakënaqësi me përmbajtjen e librave shkollorë dhe u ankuan për numrin e vogël të orëve kushtuar Luftës së Dytë Botërore, dhe faktit që ata shpesh duhet ta nxitojnë këtë pjesë të kurrikulës meqë ndodhet në fund të vitit akademik, kur studentët janë më pak të vëmendshëm.

### ***Sfidat dhe mëdyshjet***

Jemi të vetëdijshëm që për të siguruar pikëpamje më të sigurtë se si mësimdhënësit e mësojnë historinë, do të na nevojitej një observim sistematik i klasës, meqë intervistat me mësimdhënësit individual kryesisht na kanë dhënë një pasqyrim subjektiv të punës së tyre. Megjithatë, kemi konsideruar se observimi i klasës do të paraqiste sfida serioze dhe ndikim, sepse prania e një vështruesi të jashtëm ndryshon dinamikën e klasës, sidomos në Kosovë, ku historia është shumë e politizuar. Këtë gjë e konfirmuam gjatë procesit të intervistimit, kur disa mësimdhënës u ankuan për presion politik, në të kaluarën dhe të tashmen, dhe për mungesën e lirisë së shprehjes në klasë. Duke i marrë parasysh anshmeritë subjektive, intervistat e detajizuara ende përbëjnë përmbledhje solide të të dhënave dhe informative për praktikën e mësimdhënies.

Njëra nga sfidat ishte përzgjedhja e mësimdhënësve shqiptarë në Kosovë dhe kategorizimi i përvojës së tyre, kryesisht për shkak të mësimdhënies joformale që ka ndodhë gjatë viteve të 1990-ta (shih Kapitullin 3). Për shkak se shumica e shkollimit është bërë në mënyrë joformale, në ndërtesa si bodrumet dhe shtëpitë private, nuk ekziston dokumentim i përvojës apo regjistër administrativ nga ajo kohë. Një numër i mirë i mësimdhënësve kurrë nuk kanë pranuar mirënjohje për mësimdhënien e tyre vullnetare të historisë dhe andaj është shumë vështirë të llogariten saktë vitet e përvojës së tyre në mësimdhënie. Ata shpjegojnë se gjatë viteve të 1990-ta nuk kanë pasur kontrata dhe jo gjithëherë janë paguar. Për këtë arsye kemi vendosur t'i ndajmë të intervistuarit mes atyre që kanë dhënë mësim para luftës së 1999 dhe atyre që kanë dhënë mësim vetëm pas luftës. Ky dallim kohor reflekton ndryshimet e rëndësishme në kontekstet politike, të cilat duam t'i marrim parasysh për shkak se supozojmë se mësimdhënësit e historisë e kanë mësuar historinë ndryshe në kohë të ndryshme. Periudhës që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990 i referohemi si periudha jugosllave; dekadës nga 1990 deri më 1999 si shkollimi paralel; dhe periudhës pas 1999 si mësimdhënia e pasluftës e historisë.

Njëra nga sfidat kryesore derisa i aranzhonim intervistat me mësimdhënësit serbë të historisë ishte refuzimi i mundshëm për shkak se ky hulumtim po ndodhte edhe me mësimdhënësit shqiptarë. Duke pasur parasysh parimet etike të hulumtimit shkencor, kemi shpjeguar se për çfarë hulumtimi bëhet fjalë dhe çfarë fusha do të mbulonte. Megjithatë, derisa i adresoheshim apo u afroheshim të intervistuarve, në shumë raste na është dashur të përdorim terme si Kosova dhe Metohija në vend të Kosovës, terme të cilat nuk i përdorim në komunikimin tonë të përditshëm apo hulumtim. Po ashtu, na është dashur të theksojmë se hulumtimi nuk po bëhej dhe nuk po finançohej nga autoritetet e Kosovës, sepse kërkesa jonë për intervista në një rast të tillë ka gjasa që do të refuzohej. Kjo në veçanti ka ndodhur në Mitrovicë të Veriut, ku ekipi ynë e ka gjetur veten në një ambient shumë nacionalist, në të cilin na është dashur të përshtatemi duke marrë parasysh kontekstin për të qenë në gjendje që ta realizojmë me sukses hulumtimin.

### ***Etika***

Çdo të intervistuari ja kemi shpjeguar projektin hulumtues deri në detaje para se të zhvillohej intervista, duke u dhënë atyre të drejtën të tërhiqen nga intervista ose të mos përgjigjen në pyetjet për të cilat do të dëshironin të mos flisnin. Nuk kemi përdorur pajtim me shkrim duke e njohur kontekstin kulturor të rajonit dhe përvojën që i bën njerëzit hezitues dhe mëdyshës për të vënë nënshkrim në dokumente. Në vend të kësaj, kemi kërkuar nga të intervistuarit pajtueshmëri verbale dhe pajtim që ta përdorim intervistën për qëllime akademike dhe duke siguruar anonimitet.

## Kapitulli 3: Historiografisë e Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi, Serbi dhe Kosovë – 1945 deri më tani

Ndonëse ky hulumtim e ka për temë mësimdhënien e tashme të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, menduam që duhet t'i adresojmë historiografisë e ndryshueshme të së kaluarës për këtë ngjarje përgjatë një periudhe më të gjatë kohore, që fillon me vitin 1945. Janë dy arsye pse mendojmë që ky kontekst më i gjerë është i domosdoshëm:

- E para, për shkak se ekziston një lidhje mes rrënimin të historiografisë jugosllave për Luftën e Dytë Botërore dhe shpërbërjes së unitetit nacional jugosllav. Kështu që duhet të fillojmë me përvetësimin kulturor të mitit themelues të fuqishëm të Jugosllavisë së pasluftës: partizanët komunistë të Titos si model i “viktimizimit aktiv,”<sup>11</sup> figura të përsosura themeluesish të një “shteti të lindur nga lufta,”<sup>12</sup> dhe shënjes të përsosur të bashkimit supranacional, si vëllezër që tok së bashku luftojnë për t'i çliruar të gjitha kombet nga fashizmi (“vëllazërim bashkim”). Historiografia e Luftës së Dytë Botërore ishte mjet i “strategjisë së menaxhmentit të identitetit”<sup>13</sup> të shtetit të ri shumëkombësh të Jugosllavisë. Për ta bërë një gjë të tillë, dinamikat e komplikuar të Luftës, e cila ishte, si çdokund tjetër në Evropë, luftë nacionale por edhe ideologjike dhe civile, u reduktuan në betejën manikeiste ndërmjet të mirës (partizanët komunistë) dhe të keqes (fashistët por edhe të gjitha forcat antifashiste që nuk ishin komuniste).<sup>14</sup> Natyrisht, kjo qasje i shtypi të gjitha narracionet kundërshtuese.
- Së dyti, shqyrtimi i historiografisë së ndryshueshme jugosllave për Luftën përmes periudhës së pasluftës na jep një pikëpamje më të qartë rreth historiografive aktuale shqiptare dhe serbe për një ngjarje të njëjtë. Kur Jugosllavia kollopsoi, historiografia zyrtare dhe kujtesa publike në Kosovë nuk u zëvendësuan përnjëherë me historiografi alternative të re dhe homogjene: me narracionet përjashtuese shqiptare dhe serbe. Tensionet ishin të pranishme brenda secilit grup nacional edhe para krizës së viteve të 1990-ta, të tilla çfarë janë gjithmonë edhe në kujtimet e homogjenizuara, dhe që vazhdojnë të ekzistojnë edhe tani.<sup>15</sup> Pasqyra që e prezantojmë më poshtë ka për qëllim

11 Miranda Jakiša, “On Partisans and Partisanship in Yugoslavia’s Art,” në *Partisans in Yugoslavia. Literature Films and Visual Culture*, i redaktuar Miranda Jakiša and Nikica Gilić (Transcript: 2015), 9-30, 17.

12 Siç ishte thënë në rreshtat e fundit të produksionit filmik më të shpërblyer jugosllav të viteve të 60-ta, Beteja e Neretvës.

13 Wolfgang Hoepken, “War Memory and Education in a Fragmented Society: The Case of Yugoslavia,” *East European Politics and Societies*, 13, 1 (Winter 1999): 190- 227, 196.

14 E përdorim nocionin i luftës civile në këtë kontekst nga vepra kritike e dy intelektualëve të mëdhenj italian: Norberto Bobbio dhe Claudio Pavone, *Sulla guerra civile. La resistenza a due voci* (Torino: Bollati Boringhieri, 2015) dhe Claudio Pavone, “La seconda guerra mondiale: una guerra civile Europea?” në *Guerre Fratricide. Le guerre civili in età contemporanea*, i redaktuar nga Gabriele Ranzato, (Torino: Bollati Boringhieri, 1994), 86-128.

15 Kjo ishte e saktë për pjesët tjera të Evropës. Shembuj të shquar të veprave shkencore mbi këtë temë janë: Franca, ku transformimi i kujtesës së okupimit dhe rezistencës filloi në vitet e 70-ta, shih Rousso, *The Vichy Syndrome*; dhe Itali, me perspektivë e “*memoria divisa*” [kujtesës së ndarë] të rezistencës, dhe ripërkufizimin e saj “luftë civile,” shih mes tjerësh Giovanni Contini, *La Memoria divisa* (Rizzoli, 1997); Claudio Pavone, *Una guerra civile: saggio storico sulla moralità della resistenza* (Bollati Boringhieri, 1991); dhe Alessandro Portelli, *L’ordine e’ già stato eseguito: Roma, le Fosse Ardeatine e la memoria* (Donzelli, 1999). Më gjerësisht, Aleida Assmann, “Europe’s Divided Memory,” në *Clashes in European Memory. The Case of Communist Repression and the Holocaust*, i redaktuar nga Muriel Blaive, Christian Gerbel, dhe Thomas Lindenberger (Studien Verlag, 2011), 270-80.



t'i shquajë këto tensione meqë ato mbesin nën sipërfaqe pa u zhdukur plotësisht, ose që ri-aktivizohen në periudha të caktuara.

---

## Faza I – 1945-1980

Historiografia e Luftës së Dytë Botërore nga fundi i luftës e deri te vdekja e Titos ndjekë kornizën interpretuese të kontrolluar nga shteti që idealizon partizanët komunistë, ndërkohë që kundërshtarët e tyre dhe akterët tjerë jo-komunistë i paraqet si karikatura të pazhvilluara negative; neglizhon adresimin e dimensioneve etnike dhe civile të luftës; dhe rri larg tabuve të caktuara, siç është rasti me dhunën e ushtruar nga partizanët.<sup>16</sup> Kredoja e partizanëve heroik dhe vëllazëror si gurthemel i shtetësisë supranacionale jugosllave mbetet zyrtarisht e palëkundur deri në vdekjen e Titos.

Ekzistojnë disa përjashtime, të cilat zbuluan tensionet nacionale që fshiheshin nën sipërfaqe. Në fillim të viteve të 60-ta, një debat ishte zhvilluar mes historianëve rreth asaj se cili ishte grupi nacional që ishte i pari të fillojë rezistencën dhe cili ishte më bashkëpunues, me fokus në serbët dhe kroatët e Jugosllavisë, por shpejt u shua.<sup>17</sup> Në vitin 1972 libri shumë i popullarizuar *Historia e Jugosllavisë* nga Dedijer et al., u botua pas lëvizjes nacionaliste në Kroaci dhe spastrimit që pasoi, hapi një konfrontim më të gjerë ndërmjet historianëve rreth kontributit përkatës në përpjekjet për luftë të grupeve të ndryshme nacionale.<sup>18</sup> Kritika se si Lufta e Dytë Botërore ishte trajtuar në këtë libër e qortoi librin për marginalizimin e jo-serbëve në lëvizjen çlirimtare.<sup>19</sup>

Në këtë debat, historiani nga Kosova i shkolluar në Beograd, Ali Hadri mbrojti Kosovën, dhe theksoi se ky libër nuk përmend Kosovën në mesin e rajoneve që morën pjesë në luftën e partizanëve deri më 1943, në kohën e betejave të famshme të Neretvës dhe Sutjeskës, e as nuk i dhënë meritë forcave vendase të ushtrisë nacional-çlirimtare për çlirimin e Kosovës më 1944.<sup>20</sup> “Politikë-bërja përmes historiografisë u përmbyll kah mesi i viteve të 70-ta, kur po bëhej përpjekja e fundit legislative e Titos.”<sup>21</sup>

---

16 Hoepke, “War Memory,” 198.

17 Michael B. Petrovich, “Continuing Nationalism in Yugoslav Historiography,” *Nationalities Papers* Vol. VI, 2, (Fall 1978): 161-178, 173. Në vitin 1964 Tito qortoi historianët për meritat e debatimit të historisë së secilit komb jugosllav në Kongresin e Tetë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, shih Ivo Banac, “Yugoslavia,” *The American Historical Review* Vol. 97, 4 (1992): 1084-1104. 1087 dhe Wayne S. Vucinich, “Nationalism and Communism,” në *Contemporary Yugoslavia: Twenty Years of Socialist Experiment*, i redaktuar nga Wayne Vucinich (University of California Press, 1969), 277-78.

18 Petrovich, “Continuing Nationalism,” 164. Vladimir Dedijer, Ivan Božić, Sima Ćircović dhe Milorad Ekmečić, [*Istorija Jugoslavije 1972*] *History of Yugoslavia* (New York: McGraw Hill, 1974).

19 Ibid., 168.

20 Ali Hadri, “Vështrim Kritik Lidhur me ‘Historinë e Jugosllavisë’”, në *Marrëdhëniet Shiptare-Jugosllave*, (Akademia Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: 2003), 85-140, 132-138.

21 Ivo Banac, “Yugoslavia,” 1092.

Për shkak se Kosova ishte krahinë e Republikës së Serbisë në vitin 1945, gjatë periudhës nën shqyrtim këtu, Serbia ka vendosur për politikën e saj arsimore. Shqiptarët, të cilët për herë të parë e kishin fituar të drejtën të shkolloheshin në gjuhën e tyre, fillimisht vazhduan të mësoheshin nga mësimdhënësit – dhe librat – e ardhur nga Shqipëria e cila ishte e okupuar nga italianët gjatë luftës, që shpërndanin narracionin nacionalist. Vetëm në vitin 1948, pas prishjes mes Titos dhe Enver Hoxhës, Serbia ka filluar të ushtrojë kontroll më të fortë në arsim. Qindra mësimdhënës shqiptarë janë përjashtuar dhe librat janë zëvendësuar me përkthimet në shqip të teksteve shkollore serbe.<sup>22</sup>

Librat e historisë së kurrikulës serbe të pasluftës që studentët në Kosovë i lexuan deri në vitin 1980 lartësuan kualitetet heroike të partizanëve dhe u përkujdesën të shmangin vënien e fajit për dhunën e Luftës së Dytë Botërore ndonjërit prej grupeve nacionale.<sup>23</sup> Këto thekse nuk u gjetën vetëm në librat e historisë, por u përhapën edhe në kurrikulën e letërsisë, një lëndë e re që i nënshtrohej kontrollit të stilit Stalinist, që pati rol qenësor në përpjekjen për të arsimuar kombin e ri jugosllav.<sup>24</sup>

Nxënësit shqiptarë e lexuan literaturën obligative në gjuhën serbe për rezistencën partizane, qoftë në serbisht ose të përkthyer në shqip, duke iu falënderuar shtëpisë botuese Rilindja të themeluar atëbotë. Po ashtu, ka ekzistuar një përmbledhje e letërsisë për fëmijë, e shkruar nga shkrimtarët shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë, të cilët morën pjesë në ndërtimin e narracionit dominues të “viktimizimit aktiv” të përbashkët, që përqendrohej në fëmijë heronj që ishin të angazhuar si partizanë apo luftëtarë kundër fuqive të ndryshme dashakeqëse.<sup>25</sup>

### ***Decentralizimi i arsimimit në fund të viteve të 60-ta dhe në fillim të viteve të 70-ta***

Kurrikula e Kosovës vazhdoi të vendosej nga Serbia deri në decentralizimin e parë të madh të autoritetit përcaktues rreth çështjeve arsimore më 1967, dhe kjo çështje gëzoi autonomi edhe më të gjerë pas Kushtetutës së 1974. Më 1975 Kosova u bë me Këshillin e vet Arsimor. Megjithatë, kjo autonomi krahinore i kishte kufizimet e veta, meqë Lidhja e Komunistëve nga qendra kontrollonte kurrikulën dhe ishte vigjilente në refuzimin e çfarëdo devijimi.<sup>26</sup>

Por realizimi i autonomisë në Kosovë në vitin 1974 u përcoll nga krijimi i bashkëpunimit intensiv kulturor me Shqipërinë. Programi për këmbime akademike dhe qarkullim më të lirshëm të librave injektoi më shumë histori shqiptare në kurrikulën e Kosovës. Rezultati i përgjithshëm ishte riprodhimi i historiografisë enveriste në Kosovë, që e kishte Luftën e

22 S. Kojçini-Ukaj. *Kuadri arsimor shiptar në Kosovë në shënjestrën e sigurimit shtetërorë (1945-1951)*. Prishtinë, Instituti e Historisë, 1997, cituar në Denisa Kostovicova, *Kosovo. The Politics of Identity and Space* (Routledge, 2005), 40.

23 Një analizë e shkëlqyer e librave shkollore për klasën e tetë në Serbi është paraqitur nga Tamara Pavasović Trost, “History Textbooks as Sites of Construction and Contestation: Croatia and Serbia 1974-2010,” ASN Convention April 15-18, 2010, studim i pabotuar, i cituar me lejen e autores.

24 Wachtel, *Making a Nation*, 134-140. Ka pasur një përpjekje, me qëllime politike dhe edukative, për të grumbulluar dokumente dhe literaturë mbi luftën partizane, shih Wayne S. Vucinich, “Postëar Yugoslav Historiography,” *The Journal of Modern History* Vol. 23, 1 (March 1951): 41-57.

25 Baton Domi. *Yugoslav Children's Books in Albanian: the Attempt to Build a Yugoslav National Identity in Post WWII Kosova*, punim diplome, i paraqitur pranë Institutit të Kosovës për Gazetari dhe Komunikim, si pjesë e detyrimeve për Master në Arte (MA) në Gazetari, gusht, 2011.

26 Kostovicova, *The Politics of Identity*, 42.



Dytë Botërore njëren nga shtyllat kryesore të saj.<sup>27</sup>

Ky zhvillim nuk e ndërroi rrënjësisht interpretimin jugosllav të Luftës së Dytë Botërore. Librat që vinin nga Shqipëria ishin po aq ideologjikisht të ngarkuar sa librat jugosllav me që zhvillimi i traditës shkencore shqiptare në periudhën e pasluftës ishte ngushtë i lidhur me legjitimimin e regjimit komunist.<sup>28</sup> Ngjashëm me Jugosllavinë, lufta nacional-çlirimtare kundër fashizmit nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, në veçanti të udhëheqësit të saj Enver Hoxhës, ishin bërë miti më i fuqishëm themelues i Shqipërisë moderne. Komunistët shqiptarë demonizuan opozitën jo-komuniste kundër fashizmit në librat e historisë, dhe ushtarakisht e politikisht shtypën çfarëdo gjurmë të saj.

Autonomia e sapofituar e Kosovës u përputh me kulmin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Kosovë, si dhe me integrimin e saj në sistemin jugosllav. Në këtë kontekst, *Kosovo/Kosova*, një projekt bashkëpunimi mes studiuesve shqiptarë dhe serbë, propozoi një rrëfim të Luftës së Dytë Botërore, i cili bazohej kryesisht në simbolin e 'bashkimit dhe vllazërimit' dhe i cili e konsideronte "reaksionare" çdo rezistencë që nuk ishte komuniste.<sup>29</sup>

Historia e popullit shqiptar të Ali Hadrit, të botuar më 1966, gjithashtu propozon narracionin e luftës partizane si faktor unifikues mes kombeve të ndryshme.<sup>30</sup> I njëjti autor ka botuar historinë e luftës anti-fashiste për çlirim në Gjakovë në një vëllim me edicion të limituar, me kopertinë të lëkurës, si dhe historinë gjithëpërfshirëse të rezistencës partizane në Kosovë.<sup>31</sup>

---

27 Rreth kësaj shih Oliver Jens Schmitt, i cili rreshton Luftën e Dytë Botërore si shtyllë të historiografisë shqiptare krahas vazhdimësisë iliro-shqiptare, shtetndërtimit të Skënderbeut dhe Rilindjes në "Historiography in Post-Independence Kosovo," te *Civic and Uncivic Values*, 57. Për përvetësimin nga Kosova të pikëpamjes të pakontestuar të narracionit nacional shqiptar, bazuar në konstruksionin ideologjik të trashëgimisë, dhe lartësimin e traditës, shih Shkelzen Maliqin, "Hapësire kulturore shqiptare," në *Nyja e Kosovës. As Vllasi. As Millosheviqi* (Lublljanë: Knjižna zbirka KRT, 1990), 220-22.

28 Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore regjimi i Enver Hoxhës ka filluar të trajnojë studiues të cilët do të ngarkoheshin me shkrimin e historisë shqiptare dhe që nga fillimi profesioni ishte shumë i ndikuar nga projekti i shtetndërtimit të legjitimuar nga lufta partizane. Për historiografinë shqiptare, shih Ducellier, Alain. "Les Études Historiques en République Populaire d'Albanie." In *L'Albanie entre Byzance et Venise, Xe-XVe Siècles*, 125-144. Variorum Reprints, 1987. Arritja më e madhe e historianëve të rinj ishte vepra në shumë vëllime *Historia e Shqiperisë* (Akademia e Shkencave e RPS të Shqiperisë. Instituti i Historisë, 1959), nga Pollo, Buda, Frashëri dhe Islami 1959.

29 Shih hapësirën që i është kushtuar rrëfimit të Boris (Boro) Vukmirović dhe Ramiz Sadikut, të ekzekutuar më 1943 dhe shembull i relaonit të mirë shqiptaro-serb: bashkëpunëtorët shqiptarë të nazistëve kanë provuar t'i ndajnë dhe t'ia kursejnë Ramizit jetën për shkak të nacionalitetit të tij, por dy shokët kanë vendosur të vdesin së bashku.

30 Ali Hadri, *Historia e Popullit Shqiptar për shkollën fillore* (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1966).

31 Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë, 1941-1945* (Prishtinë, 1971) dhe *Gjakova në LNÇ* (Prishtinë: Bashkësia e Institucioneve Shkencore të KSA të Kosovës, 1974).

Në shkrimet e Hadrit, konfliktet e brendshme në Jugosllavi janë të përcaktuara nga klasa dhe ideologjia, jo etnia. Nëse rekrutimi i shqiptarëve në luftën anti-fashiste nga Partia Komuniste ishte i vështirë, atëherë kjo ishte si pasojë e frikës së rikthimit në “Jugosllavinë e Vjetër” – me fjalë tjera borgjeze dhe represive – dhe kjo për shkak të urrejtjes ndaj Serbisë. Hadri e portretizon bashkimin e tokave të banuara me shqiptarë nga fashistët italianë si vepër të qeverisë “kuislinge”, të cilës i mungon përkrahja popullore. Ai lavdëron partizanët shqiptarë, dhe i quan “reaksonarë” dhe “kuisling” ata shqiptarë, siç është rasti me liderët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, të cilët e kundërshtuan lëvizjen partizane për të realizuar unifikimin kombëtar shqiptar. Në fund, ai i identifikon si “kundërrevolucionarë” shqiptarët të cilët kah fundi i luftës luftuan kundër partizanëve jugosllavë në Drenicë, Ferizaj dhe Gjilan, ku kanë ndodhur episodet më të rënda të dhunës.<sup>32</sup>

---

## Faza II – 1980-1990

Pas vdekjes së Titos në vitin 1980, kujtimi i Luftës së Dytë Botërore, i cili ishte përdorur për ta legjitimizuar Jugosllavinë dhe udhëheqësinë e saj, u sulmua haptas. Derisa republikat po përpiqeshin të fitojnë më shumë autonomi dhe eventualisht pavarësi, ato njëkohësisht nacionalizuan kujtimin e Luftës, që në fakt u shndërrua në “kapital politik” për shfrytëzim të elitave nacionale politike.<sup>33</sup> Konfrontimi më i madh në qarqet e historianëve ishte mes Serbisë dhe Kroacisë, me fokus në bashkëpunim dhe gjenocid.<sup>34</sup>

Por një konfrontim i ngjashëm ndodhi edhe mes serbëve dhe shqiptarëve për historinë e Kosovës, dhe mori një kthesë dramatike me rastin e botimit në vitin 1980 të *Enciklopedija Jugoslavije (Enciklopedisë së Jugosllavisë)*. Anëtarët serbë të redaksisë u ankuan për dy hyrje, “Shqiptarët” dhe “Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave”, të cilat ishin shkruar nga studiuesit e Kosovës, dhe i riformuluan ato. Më pas kërkuan nga abonentët që t’ua shtonin versionet e tyre të korrigjuara vëllimit.<sup>35</sup> Për qëllimet tona, ja vlen të përmendim se ankesat e historianëve serbë u përqendruan te prezantimi i marrëdhënieve serbo-shqiptare si bashkëpunim idilik, dhe ekzagjerimi i pjesëmarrjes së shqiptarëve në luftën partizane.<sup>36</sup> Sipas versionit të tyre, nuk kishte pjesëmarrje.

---

32 Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare*, 189-193

33 Hoepken, “War Memory,” 206.

34 Bette Denich, “Dismembering Yugoslavia: Nationalist Ideologies and the Symbolic Revival of Genocide,” *American Ethnologist*, 21 (2) 1994: 367-390.

35 Një kopje e Enciklopedisë e konsultuar në bibliotekën e Columbia University e ka hyrjen “*Albanci.Ime*” (Shqiptarët. Emër) në fq. 72, por faqja e radhës, qartazi e ngjitur, e mbanë numrin fq. 1, me hyrjen “*Albanci (alb. Shqiptarët). Ime*,” që vazhdon deri në fq. 12 e që pastaj vazhdon në fq. 73. Një radhitje e tillë ekziston edhe pas fq. 86, me hyrjen “*Albansko-Jugoslavenski (Jugoslovenski) Odnosi*” (Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave), që pasohet nga fq. 1 me rishkrim të hyrjes së njejtë.

36 Ali Hadri, “Përgjigje Vërejtjeve Lidhur me Tekstet Historike të Njësive “Shqiptarët” dhe “Marrëdhëniet Shiptare-Jugosllave” në Enciklopedinë e Jugosllavisë,” në *Marrëdhëniet Shiptare-Jugosllave*, 23-84.

Beteja rreth historisë ishte vetëm paralajmërim i gjërave që do të pasonin. Demonstratat e 1981, që filluan në Universitetin e Prishtinës si protesta të studentëve shqiptarë, shpejt u shndërruan në lëvizje me thirrjet për Kosovën Republikë, hera e parë që militantët nacionalist shqiptarë kishin shprehur publikisht këtë kërkesë. Demonstratat u pasuan nga një represion i ashpër. Një Plan Veprimi i Lidhjes Komuniste të Kosovës miratoi këto politika arsimore: spastrimin e mësimdhënësve në universitet dhe shkolla të mesme dhe një rishqyrtim, i bazuar në analizë marksiste, të kurrikulës, librave shkollorë, disertacioneve, dhe të gjitha botimeve akademike. Në fakt, spastrimet hoqën mësimdhënësit që u konsideruan jolojal ndaj Jugosllavisë, dhe librat e autorëve shqiptarë u ndaluan. Hapja e shkëmbimeve kulturore e vitit 1974 mes Kosovës dhe Shqipërisë u mbyll tërësisht, dhe të gjithë librat e importuar nga Shqipëria u hoqën nga qarkullimi, si mjete të “indoktrinimit me ideologji të huaj,” siç kishte shkruar Tanjug atëbotë.<sup>37</sup>

Nga viti 1982, grupet nacionale të lidhura me dhunën dhe rrezikun e Luftës së Dytë Botërore, si armiq të luftëtarëve partizanë të mirë të vetëm, u përmendën për herë të parë në tekstet shkollorë serbe që u përdorën gjithashtu në Kosovë. Këta armiq ishin fashistët kroat *ustашe*; *četnickët*, ithtarë të Serbisë së Madhe; dhe ballistët nacionalistë shqiptarë, por ata akoma përshkruheshin më gjuhë të balancuar. Heronjtë partizanë nga nacionalitete të ndryshme po ashtu ishin përmendur. Pas vitit 1988, librat shkollorë serbë prezantuan nocionin anti-jugosllav të Shqipërisë së Madhe si qëllim të qartë të ballistëve shqiptarë.<sup>38</sup>

Narracioni i viktimizimit serb në Kosovë zhvendoset në qendër pas vdekjes së Titos, duke propozuar rivlerësim të mitologjisë partizane jugosllave. Futja e leximit të librit më të popullarizuar për përvojën partizane *Daleko je Sunce* (Dielli është larg 1950) të Dobrica Ćosić në kurrikulën shkollorë është shembull i transformimit të tillë.<sup>39</sup> Përmes konfrontimit ndërmjet liderit partizan Pavle dhe *četnikut* të zënë rob Vasić, ish shokët e tij të shkollës, Dobrica Ćosić shtron pyetjen nëse revolucioni duhet luftuar me çmimin e tradhtisë ndaj komunitetit të vet. Ndonëse interpretimi kanonik i këtij shkëmbimi gjithmonë i shkon për shtati kozmopolitanizmit komunist të Pavles, më 1991 mundësia që autori të ketë favorizuar Vasić me rrënjë etnike doli si shumë e kapshme, dhe me te edhe miti anasjellë.

---

### Faza III – Nga 1990 deri te lufta

Më 1989, me rishikimin e Kushtetutës jugosllave të vitit 1974 autonomia e Kosovës u shfuqizua dhe praktikisht i dha fund çfarëdo marrëdhënie mes autoriteteve shtetërore serbe dhe lidhshimit të Kosovës. Sistemet paralele të arsimit u shfaqën, që ishin të ndara fizikisht dhe ligjërisht, me serbfolësit që vijonin shkollat që punonin me kurrikulën shtetërore serbe, dhe shqipfolësit që kryesisht shkolloheshin nëpër shtëpi, dhe ndiqnin një kurrikulë tjetër.

Ajo çfarë pasoi ishte prodhimi dhe konsumimi i historiografive krejtësisht të ndryshme për Luftën e Dytë Botërore, të mobilizuara për të mohuar mitin e Jugosllavisë dhe për të avancuar idenë se çdo komb është viktimizuar por kurrë nuk e ka kryer ndonjë krim.

---

37 Prezantimi i këtyre ngjarjeve është marrë nga Kostovicova, *The Politics of Identity*, 53.

38 Pavašović Trost, “History Textbooks,” 19.

39 Wachtel, *Making a Nation*, 150-153.

Është pikërisht në këtë dekadë që historiografia shqiptare filloi ta mohojë pjesëmarrjen shqiptare në lëvizjen partizane të Kosovës; të arsyetojë bashkëpunimin me okupimin fashist dhe nazist si detyrë patriotike; dhe të portretizojë partizanët serbë si forca gjeno- cidale. Historiografia serbe prezantoi shqiptarët si bashkëpunëtorë të fashistëve dhe na- zistëve të cilët u përpoqën të kryejnë gjenocid ndaj popullit serb në Kosovë.

### **Librat serbë**

Analizat e teksteve shkollore serbe të historisë të botuara gjatë viteve të 90-ta dhe pas vitit 2000 qartazi sugjerojnë riprodhimin e narracionit dominues shtetëror të historisë së fun- dit. Siç thekson Dubravka Stojanović, “politikanët serb e perceptojnë mësimdhënien e his- torisë në shkolla publike ‘si instrument për të formësuar kujtesën historike dhe vetëdijen nacionale si mënyrë për t’i arritur qëllimet dhe synimet e parapërcaktuara kombëtare.”<sup>40</sup>

Gjatë viteve të 90-ta, mësimdhënia e historisë dhe librat shkollorë të historisë pasqyruan një “konfuzion ideologjik,” konfuzion që karakterizoi politikën serbe dhe shoqërinë në atë periudhë.<sup>41</sup> Ndryshe prej shteteve tjera të Evropës Lindore dhe Qendrore, librat e parë shkollorë të historisë të botuar në vitin 1993 vazhduan t’i ruajnë strukturat e ideologjisë komuniste. Megjithatë, ato iu përshtatën zhvillimeve politike të asaj kohe kur tashmë lufta kishte shpërthyer në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë.<sup>42</sup> Andaj, një kombinim i na- cionalizmit dhe komunizmit formësoi kornizën politike të librave të parë shkollorë serbë pas rënies së Jugosllavisë, që Therefore, a combination of nationalism and Communism shaped the political framework of the first post-Yugoslav Serbian textbooks, Dubravka Sto- janovic e quan, “Komunizëm me Fytyrë Kombëtare.”

Nga 1990 e tutje, kërcënimi nga separatizmi shqiptar mori një rol më qendror në lidhje me Luftën e Dytë Botërore. Librat shkollorë të historisë të prezantuar më 1993 në Serbi iu referuan “gjenocidit” të Luftës së Dytë Botërore dhe e krahasuan atë me luftën aktuale: “situata që nga 1941 praktikisht është identike.”<sup>43</sup>

Këta libra prezantuan detaje të terrorit të Shqipërisë së Madhe fashiste ndaj popullatës serbe, me dëbimet e dhunshme masive të serbëve dhe malazezëve nga Kosova. E lexuan deklaratën e Këshillit Nacional-Çlirimtar për Kosovë dhe Metohi në Konferencën e Bujanit (dhjetor 1943- janar 1944), ku kërkohet vetëvendosje për Kosovën, dhe kryengritjen e vitit 1945 në Drenicë kundër urdhrave të partizanëve për t’i luftuar gjermanët në veri si një shembull të radhës të separatizmit shqiptar. Si shembull të zinxhirit të ngjarjeve që për qëllim kishin shlyerjen e gjurmëve të serbëve në Kosovë, ajo që ndodhi në Bujan dhe Drenicë u krahasua me planet e supozuara më të vonshme për të spastruar Kosovën nga serbët. Separatizmi shqiptar në fakt u bë nënseksion i librave.<sup>44</sup>

---

40 Dubravka Stojanović, “Serbia: History to Order”. <http://chalkboard.tol.org/serbia-history-to-order/> (linku i klikuar më 27 shtator 2016).

41 Dubravka Stojanović, “Konstrukcija proslosti”, 52.

42 Ibid., 52.

43 Dubravka Stojanović, “Construction of Historical Consciousness, The Case of Serbian History Textbooks,” në *Balkan Identities: Nations and Memory*, i redaktuar nga Maria Todorova (Hurst, 2004), 330.

44 Pavasovic Trost, “History Textbooks,” 22.

Asnjë libër shkollor serb nuk përmend dhunën e partizanëve në Kosovë apo të skenës politike të Kosovës pas kapitullimit të Italisë fashiste.<sup>45</sup> Tito u marginalizua dhe ai bashkë me tërë lëvizjen partizane u akuzuan për krime, sidomos në periudhën pas Luftës. Draza Mihajlović, udhëheqësi *četnik*, për herë të parë prezantohet me përskrim neutral, dhe çeta e tij prezantohet krahas për krahas me partizanët, dhe pothuajse nuk përmenden krimet *četnike* të Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që fokusi kalon të krimet e kryera nga partizanët.<sup>46</sup>

### **Librat shqip**

Ndarja fizike e shkollave më 1990 në bazë të nacionalitetit dhe themelimi i shkollave shqipe në sistem paralel jashtë autoritetit ligjor shtetëror u dha liri të pashembullt për të ndjekur arsimimin e tyre nacional dhe për të zhvilluar një historiografi të pavarur nga Serbia. Sikur në Serbi, historia në Kosovë është përdorur për të ndërtuar narracionin zyrtar nacional shqiptar të bazuar në dy teza kryesore: viktimizim konsistent dhe luftë së qëndrueshme heroike për pavarësi, nga Serbia mbi të gjitha.

Në librat shkollorë të sistemit paralel të shkollimit në Kosovë, nuk ka pasur konfuzion ideologjik për komunizmin, por ka ekzistuar një refuzim i plotë i tij, të paktën komunizmit në versionin jugosllav të tij. Përkundrazi, bashkimi nacional i trojeve shqiptare, që përfshinë Shqipërinë, Kosovën, Serbinë Jugore, dhe pjesë të Maqedonisë e Malit të Zi, që ishte realizuar për herë të parë gjatë okupimit Italian të vitit 1941-1943, i dha kahje të re, pozitive okupesve fashist.

Librat shkollorë paraqitën si pasojë të Luftës së Dytë Botërore ripushtimin e Kosovës nga Serbia dhe vendosjen e një sistemi terrori dhe gjenocidi që shkaktoi humbje të mëdha, deri në dhjetëra mijëra.<sup>47</sup> Për librat e ri të historisë, Deklarata e Bujanit e bërë në fund të vitit 1943, në të cilën Këshilli Nacional-Çlirimtar për Kosovë dhe Metohi “shprehu vullnetin politik të popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe bashkim me Shqipërinë” ishte qenësore, pikërisht për shkak se delegjitimizonte aneksimin e Kosovës pas luftës.<sup>48</sup>

Të gjithë librat, të cilët prezantuan një narracion të konfrontimit të vazhdueshëm mes serbëve dhe shqiptarëve, shquan rezistencën e shqiptarëve në Jugosllavinë socialiste me ngritjen e Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar, një lëvizje e themeluar më 1945 dhe e likuiduar pothuaj menjëherë në një spektakël prej gjykimi të montuar në Prizren.

Krahas teksteve shkollore, në të 90-at u zhvillua edhe një realizim i ri i librave të historisë, të përqendruar në temat e politizuara tabu, të cilat gjatë Jugosllavisë ishin mbajtur gjallë nga tradita orale, jashta mësimdhënies zyrtare. Në mesin e tyre radhitet pikëpamja e luftës antifashiste si strategji për ripushtimin serb të Kosovës, pas boshllëkut të okupimit Italian dhe gjerman; kujtimi i masakrave “*četniko-partizane*” në Drenicë dhe luftës

45 Gashi, *Kosova 1912-2000 in the History Textbooks*, 27.

46 Jovana Mihajlović Trbovc and Tamara Pavasović Trost, “Who Were the Anti-Fascists? Divergent Interpretations of WWII in Contemporary Post-Yugoslav History Textbooks” në *The Use and Abuse of Memory: Interpreting World War II in Contemporary European Politics*, i redaktuar nga Christian Karner dhe Bram Mertens (New Brunswick and London: Transaction Publisher), 185.

47 Kostovicova, *The Politics of Identity*, 149.

48 Ibid., 144.

mes ushtrisë çlirimtare anti-fashiste kundër rekrutëve të udhëhequr nga Shaban Polluzha në dimrin e vitit 1945; dhe masakra e civilëve shqiptarë të rekrutuar me forcë në qytetin malazez të Tivarit në fund të marsit të vitit 1945.<sup>49</sup>

## Faza IV – Periudha e pasluftës

Në periudhën e pasluftës, sistemi arsimor i Kosovës kaloi nëpër një sërë transformimesh, duke kaluar nga trajta të ndryshme të mbikëqyrjes ndërkombëtare deri të Ministri i Pavarur i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008.<sup>50</sup> Asnjëri nga këto entitete që udhëheqin arsimin nuk e ka shtrirë autoritetin në pjesët ku jetojnë serbët, qoftë në jug të lumit Ibër ose në rajonin e Mitrovicës së Veriut. Atje, Ministria e Arsimit të Serbisë<sup>51</sup> vazhdon t'i emërojë mësimdhënësit si dhe të lëshojë direktiva për kurrikulë dhe libra shkollorë. Kjo ndarje e dy sistemeve shkollorë në Kosovën e pas pavarësisë është e lejuar me Kushtetutë, e cila i jep autonomi të gjerë komunave me shumicë serbe, përfshirë të drejtën që arsimit të administrohet nga qeveria serbe.

### **Librat serbë**

Pas vitit 2000 dhe rënies së Millosheviqit, mësimdhënia e historisë dhe tekstet shkollorë të historisë u rishikuan sërish në Serbi. Fillimisht, interpretimi i historisë së Jugosllavisë ndryshoi dramatikisht, sidomos interpretimet e historisë së Jugosllavisë socialiste. Logjikisht, ndryshimet më revizioniste u bënë në relacion me historinë zyrtare të Luftës së Dytë Botërore. Meqë Jugosllavia e Dytë ishte krijuar gjatë vet luftës, interpretimet e kësaj lufte duhej të riformatoheshin.

Në rastin e Serbisë, ndryshime më dramatike prekën interpretimet për rolet e partizanëve dhe *četnikëve* gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe rolin e Dragoljub Draža Mihajlović, udhëheqësit *četnik*, si dhe rolin e Gjeneral Milan Nedić, i cili shërbeu si President i qeverisë marionetë serbe gjatë okupimit nazist gjerman. Lëvizja *četnike* është portretizuar njëjtë anti-fashiste si lëvizja partizane, ndërsa Gjenerali Nedić është përshkruar si dikush që i ka ndihmuar refugjatët serbë që iknin nga Shteti i Pavarur i Kroacisë (NDH). Qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve në mësimdhënien e historisë dhe librave shkollorë ishte të këputen lidhjet mes narracionit dhe historisë zyrtare jugosllave dhe të ofrohet një histori e re nacionale për shtetin e pavarur serb.

49 Mes tjerësh, Muhamet Shatri, *Kosova në luftën e dytë botërore 1941-1945* (Toena, 1997); Muhamet Piraku, *Ripushtimi Jugosllav i Kosovës 1945* (1992); dhe Sabile Keçmezi-Basha, *Lëvizja Ilegale Patriotike Shqiptare në Kosovë (1945-1947)* (1998).

50 Pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999, sovraniteti i Serbisë mbi Kosovën është suspenduar përkohësisht përmes Rezolutës 1244 të KS të OKB-së dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) mori përsipër administrimin e Kosovës. Në vitin 2000, UNMIK themeloi Departamentin Administrativ për Arsim dhe Shkencë (UNMIK/REG/2000/11, 3 mars, 2000), të udhëhequr nga një diplomat i huaj (Oficer kryesor ndërkombëtar). Në mars të vitit 2002, ministri i parë i arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) ishte emëruar por ende si pjesë e institucioneve të qeverisë së përkohshme të vetqeverisjes, pra ende jo të pavarura nga vëzhgimi administrativ i UNMIK-ut për shkak se Kosova nuk e kishte ende statusin e pavarur. Rrëfimi i përpjekjeve të para për të udhëhequr arsimin në Kosovës pas luftës është mjaft mirë i shpjeguar në UNESCO, *Parallel Worlds: Rebuilding the Education System in Kosovo*, 2004. <http://www.unesco.org/iiep/PDF/pubs/kosovo.pdf>

51 Në 1999, Serbia ishte një nga njësitë federale të Republikës Federale të Jugosllavisë; nga 2003 deri më 2006, Serbia ishte pjesë e një bashkimi shtetëror me Malin e Zi. Që prej 2006, Serbia është shtet i pavarur, pasi Mali i Zi vendosi të largohej nga bashkimi shtetëror me të.



Duket se “problem” i Kosovës dhe Lufta e Dytë Botërore ishin në qendër të diskursit që po ndryshonte në historinë e Serbisë, ku narracioni nacionalist ishte futur për të prezantuar “vuajtjen kolektive” historike serbe, rrezikun fizik dhe nevojën për t’i rrokur armët.”<sup>52</sup> Në Kosovë, ekziston një narracion i fuqishëm viktimizimi i serbëve të Kosovës, të cilët janë nënshtruar përmes terrorit, sa për të qëndruar në historinë moderne, gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë Jugosllavisë socialiste dhe pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999. Megjithatë, narracioni më i shquar dhe më i diskutuar i viktimizimit serb lidhet me gjenocidin e Luftës së Dytë Botërore në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH); ngjarjet në Shtetin e Pavarur të Kroacisë i dominojnë të gjitha të tjerat në hapësirën gjeografike të ish-Jugosllavisë në relacion me narracionin e viktimizimit.

Çfarë metoda janë përdorur për këto rishikime dhe ndryshime në mësimdhënien e historisë dhe librave shkollorë të historisë në Serbi? Dhe si është ndërtuar kjo e kaluar e re? Stojanović i ka identifikuar katër nivele manipulimi të fakteve historike që çuan drejt konstruksionit të së kaluarës së afërt në Serbi:

1. Përshtatjen e librave shkollorë të historisë nevojave ditore politike: disa fakte thjeshtë po fshihen. Për shembull, ajo çfarë i lidhte popujt e Jugosllavisë në të kaluarën injorohet, neglizhohet dhe marginalizohet, përderisa fokusi përqendrohet në proceset dezintegruese: luftërat, konfliktet, mospajtimet politike. Si pasojë e narracionit të fuqishëm anti-komunist që u fuqizua shumë, sidomos pas vitit 2000, faktet që lidheshin me Luftën e Dytë Botërore sistematikisht u ndryshuan.<sup>53</sup> Te çështja e krimeve të luftës: pothuajse nuk përmenden fare krimet e *četnikëve*, përderisa fokusi zhvendoset te krimet e kryera nga partizanët.<sup>54</sup>
2. Proceset e prezantimit të koncepteve të reja të vetëdijesimit kolektiv historik dhe nacional serb: krijimin e imazhit stereotipik të “kombit tonë dhe pozitës së tij në histori.” Fokusi në këtë proces të identifikuar është mbi “natyrën fitimtare të kombit tonë,” dhe mbi konceptin e kombit-viktimë.<sup>55</sup>
3. Vet natyra e historisë është e prezantuar si rrjedhë e përcaktuar e ngjarjeve, në të cilën nuk është e mundur t’i ndikosh rrjedhat e paracaktuara historike.<sup>56</sup>
4. Përfundimisht, ndërlidhshmëria mes procesit të riformimit të kujtimeve kolektive pas-jugosllave në Serbi dhe historia zyrtare e mësuar në shkolla thërrasin për vëmendjen tonë. Le Goff, i cituar nga Stojanović: “Kontrollimi i kujtesës, kujtimit dhe harresës ka qenë gjithmonë puna më e rëndësishme për klasat, grupet dhe individët që dominuan, apo ende i dominojnë shoqëritë, pavarësisht se për cilën pjesë të historisë bëhet fjalë.”<sup>57</sup>

52 Hoepken, “War Memory,” 209.

53 Stojanović, *Konstrukcija prošlosti*, 53.

54 Jovana Mihajlović Trbovc dhe Tamara Pavašević Trost, “Who Were the Anti-Fascists?”, 184.

55 Stojanović, *Konstrukcija prošlosti – slučaj srpskih udzbenika istorije*, 57.

56 Ibid., 59. Argumenti i Stojanović’s sipas këndvështrimit pedagogjik është se kur nxënësve ju prezantohet historia si një zinxhir linear ngjarjesh, atëherë nxënësit e kanë të pamundur të zhvillojnë ose përvetësojnë mjetet e nevojshme për mendim kritik.

57 Dubravka Stojanović, “Sećanje protiv istorije. Udženici istorije kao globalni problem”, *Београдски историјски гласник IV*, 2013, 186.

Analiza e tre librave shkollorë të historisë tregon që ngjarjet në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore janë të mbuluara goxha sipërfaqësisht. Përderisa në disa libra shkollorë janë gati 10 faqe që flasin për ngjarjet që kanë ndodhur në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH), situatë në Kosovë mbulohet vetëm në nënkapituj të shkurtë. Më poshtë i identifikojmë deklaratat e përbashkëta në tre librat shkollorë:

- Gjatë Luftës së Dytë Botërore, projekti i Shqipërisë së Madhe është realizuar falë Italisë fashiste
- Shqiptarët ishin në anën e fashistëve gjatë luftës, meqë e kishin përkrahjen e Italisë së Mussolinit;
- Terrori ndaj popullatës serbe çoi drejt vrasjeve masive dhe dëbimit të civilëve serbë;
- Nuk përmenden viktimat shqiptare.

Librat shkollorë e vendosin Kosovën në kontekstin më të gjerë të okupimit të Jugosllavisë nga Gjermania naziste dhe aleatët e saj, dhe e theksojnë ndarjen e “Jugosllavisë së Parë.” Si pasojë, Kosova aneksohet nga tokat jugosllave dhe okupohet e aneksohet nga Shqipëria italiano-fashiste. Librat shkollorë serb i përmendin krimet e kryera nga shqiptarët dhe forcat fashiste. Për shembull, në vitin 2013 në librin shkollor të Ljušić & Dimić, një nënkapitull është titulluar “Terrori i administratave okupuese italiane, shqiptare, hungareze dhe bullgare.” Sipas këtij libri shkollor, “Nën rrezikun e zhdukjes, serbët ishin detyruar të iknin nga protektorati italian i “Shqipërisë së Madhe”. Terrori i militantëve (vullnetarë) shqiptarë shkaktoi dëbimin e 90,000 serbëve. Nga viti 1941-1944, 10,000 serbë ishin vrarë në Kosovë dhe Metohi.”<sup>58</sup>

Ngjashëm, libri shkollor i vitit 2014 i Radojevićit e diskuton “terrorin e përditshëm shqiptarë ndaj civilëve serbë.”<sup>59</sup> Megjithatë, Radojević e kontekstualizon dhunën, duke i përmendur kolonët serbë të periudhës së para luftës – “ata [shqiptarët] kryesisht sulmuan kolonët [vërejtje e jona: ata të cilët kishin marrë toka pas Luftës së Dytë Botërore gjatë reformës agrare dhe kolonizimit]. Këto toka ishin banuar nga shqiptarët e Kosovës ose shqiptarët e Shqipërisë.”<sup>60</sup> Akoma, “dhuna shqiptare ndaj serbëve” është e vendosur jashtë kontekstit. Nxënësve nuk u prezantohet situata e ndërlikuar politike që ishte shkaktuar nga okupimet italiane, bullgare dhe gjermane në pjesët jugore të Jugosllavisë. Çështjet si “cili ishte roli i italianëve?” apo “cili ishte roli i gjermanëve pas disfatës së Italisë?” vazhdojnë të mbesin të pasqaruara.

---

58 Radoš Ljušić and Ljubodrag Dimić, *Istorija za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera i četvrti razred gimnazije društveno-jezičkog smera* (Beograd: Freska, 2014), 201.

59 Mira Radojević, *Istorija IV - udžbenik za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera, četvrti razred gimnazije društveno-jezičkog smera i opšteg tipa i četvrti razred srednje stručne škole za obrazovne profile pravni tehničar i birotehničar* (Beograd: Klett, 2014), 272

60 Ibid., 272.



A ka pasur ndonjë rezistencë në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër okupimit? Sipas librave shkollorë serb të analizuar, ka pasur, por ato përmendin vetëm betejën antifashiste të partizanëve serb dhe malazez. “Kryesisht vetëm serbët ishin partizanë në Kosovë, ndonëse veprimet e partizanëve ishin pothuaj të pamundshme për shkak të pranisë së madhe të militantëve shqiptarë.”<sup>61</sup> Nuk ka sqarim se çfarë në të vërtetë ishin “militantët shqiptarë”.

Dy libra shkollorë përmendin partizanët shqiptarë, por vetëm brenda narracionit për nacionalizmin shqiptar. Në librin shkollor të Ljušić & Dimić përmendet se pas çlirimit të Kosovës dhe Metohisë, ka ngjarë një kryengritje e madhe shqiptare në dhjetor të vitit 1944. Shkaku i kryengritjes ishte refuzimi i shqiptarëve të luftojnë në frontin e Sremit, në veriperëndim të Serbisë. Megjithatë, arsyeja e vërtetë e kryengritjes ishte që shqiptarët vetëm deshën të mbrojnë territorin e Kosovës dhe Metohisë, dhe se një pjesë e tyre deshën të jenë pjesë e Shqipërisë së Madhe. Sipas këtyre teksteve, udhëheqësi i kryengritjes ishte Xhafer Deva, udhëheqësi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit (vërejtje e jona: udhëheqësi i kryengritjes së Drenicës nuk ishte Xhafer Deva, por Shaban Polluzha). Kryengritja ishte shuar në shkurt të vitit 1945.<sup>62</sup>

Veç kësaj, librat shkollorë të Ljušić & Dimić përmendin rolin e shqiptarëve në Divizionin e 21 SS Skenderbeg që është formuar gjatë pranverës së vitit 1944, i përbërë nga oficerë gjermanë dhe ushtarë shqiptarë – ata u mundën nga partizanët në korrik të vitit 1944, gjatë operacionit të Andrijevićes. Divizioni Skenderbeg ishte përgjegjës për masakrat në Plavë.<sup>63</sup>

Siç u theksuar paraprakisht, librat shkollorë serbë të historisë injorojnë çfarëdo fakti që mund të rrezikojë narracionin e viktimizimit. Fakti që ka pasur konflikt mes partizanëve shqiptarë rreth çështjes kombëtare injorohet, sikur që injorohen edhe masakrat e kryera nga forcat partizane serbe dhe malazeze kundër popullatës shqiptare pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Të gjithë librat shkollorë serbë të historisë kanë seksione të ndara që i kushtohen Holokaustit. Përderisa fokusi është në Holokaustin në nivel evropian, ku përmendet numri i viktimave, dhe me theks të veçantë në Auschwitz, Holokausti në Serbi dhe në Jugosllavinë e okupuar është paksa i marginalizuar. Librat e historisë e përmendin vdekjen dhe kampet e koncentrimin në territorin serb dhe jugosllav, në veçanti Jasenovacin dhe Staro Sajmište,<sup>64</sup> megjithatë kryesit e krimeve kryesisht definojnë etnikisht si “gjermanë” ose *ustaše*. Roli i policisë serbe dhe forcave të armatosura nën qeverinë e Nedićit në procesin e shfarosjes së hebrenjve nuk përmendet, përderisa kryesit e krimeve identifikohen ekskluzivisht si ushtarë nazist gjerman dhe aleatë të tyre, në veçanti *ustaše*.

---

61 Ibid., 284.

62 Ljušić dhe Dimić, *Istorija za treći*, 228.

63 Ibid., 227.

64 Jasenovac ishte kam koncentrimi dhe shfarosjeje në territorin e Shtetit të Pavarur Kroat (NDH) gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur dhjetëra mijëra njerëz (serbë, hebrenjë, boshnjakë, romë dhe anti-fashist kroatë) ishin vrarë. Staro Sajmište ishte kamp i koncentrimin gjatë Luftës së Dytë Botërore (sot është i vendosur në qendër të Beogradit), ku mijëra njerëz (hebrenjë, serbë e romë dhe të tjerë) ishin vrarë, apo ishin transferuar në kampe tjera ose në vende të ekzekutimeve masive. Përderisa në Jasenovac ekziston një përkujtimore, në Staro Sajmište nuk ka asnjë gjurmë përkundër përpjekjeve për ta vendosur një memorial aty nga një numër historianësh dhe aktivistësh.

Narracioni i Luftës së Dytë Botërore i propozuar në librat shkollorë serbë të historisë pas vitit 2000 e vendosë nacionalizmin shqiptar, bashkë me ëndrrën e qëndrueshme të Shqipërisë së Madhe, si arsye për pozitën e “dobët” të Serbisë dhe popullit serb në Jugosllavinë e pasluftës, dhe shpërbërjen e saj përfundimtare. Me fjalë të tjera, narracioni i Luftës shtrihet për të përfshirë vuajtjet pasuese të serbëve deri në kohën e tashme.

Përderisa librat shkollorë shqiptarë e theksojnë Bujanin, dhe vendimin e vitit 1944 të komunistëve të Kosovës për t'i dhënë Kosovës të drejtën e vetëvendosjes pas luftës, librat shkollorë serbë e theksojnë aneksimin legjitim të Kosovës nga Serbia më 1945. Për shembull, Djurić dhe Pavlović paraqesin një seksion të vogël, “Serbia si njësi e komplikuar federative,” ku theksojnë se “pas qetësimit të tensioneve në Kosovë, pas shfuqizimit të qeverisë ushtarake, dhe gjatë periudhës së relacioneve më të afërta me Shqipërinë, Kuvendi Popullor Rajonal i Kosovës dhe Metohisë e pranoi Rezolutën (më 9 dhe 10 korrik, 1945) ku shpallnin vullnetin e deputetëve për pranimin e atij rajoni në Serbinë Federale si pjesë integrale e saj.”<sup>65</sup> Por fakti që autorët e quajnë Serbinë, “Serbi Federale”, flet për botëkuptimin e tyre dhe pozicionimin e pozitës së pa privilegj të Serbisë në federatën jugosllave. Ndryshe, do të ishte e pamundur të flitet për “Serbinë Federale” në kuadër të “Jugosllavisë Federale”.

Sipas librit të njëjtë shkollor, aneksimi i Kosovës nga Serbia është kryer nga Jugosllavia në mënyra që e kanë rrezikuar jo vetëm shtetësinë serbe, por edhe popullin serb. Radojević shkruan se, “pas luftës, në kontekst të unifikimit të mundshëm me Shqipërinë, autoritetet e reja (jugosllave) ndaluan kolonët serbë që ishin dëbuar gjatë luftës që të ktheheshin (në Kosovë); për më shumë, ata i lejuan shqiptarët të qëndrojnë atje, dhe në shumë raste, shqiptarët erdhën nga Shqipëria.”<sup>66</sup> Ky lloj prezantimi i periudhës së menjëhershme të pasluftës i kontribuon ideve të gabuara të zakonshme për marrëdhëniet serbo-shqiptare, si dhe betejës së përjetëshme, si në shumë konflikte tjera, rreth çështjes se “kush ishte këtu i pari.”

Kërcënimi nga nacionalizmi shqiptar në Kosovë, dhe dobësia e autoriteteve jugosllave që të përballet me të, është boshti i përbashkët i trajtimit nga librat shkollorë të Jugosllavisë së pasluftës, dobësimit të Serbisë, dhe kolapsit të shtetit jugosllav. Referencat e Luftës së Dytë Botërore janë të qarta, sidomos në raport me ikjet masive të serbëve nga Kosova në vitin 1999, shpesh të krahasuara me dëbimin e kolonëve serbë në vitin 1940.

Shpërbërja e Jugosllavisë në librin shkollor të Djurić & Pavlović është pjesë e kapitullit me titull, “Krizë Sociale dhe Shkatërrimi i Shtetit të Përbashkët 1980-2000.” Nënkapitulli i parë titullohet “Problemet e Kosovës – fillimi i shpërbërjes së shtetit.” Sipas tyre, “shenjat e para të destabilizimit të Jugosllavisë janë parë në Kosovës. Shpërthimi i nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar gjatë pranverës së vitit 1981 shënoi ngritjen e nacionalizmave të fshehur që do të ishin shkatërrimtarë për të gjithë komunitetin.”<sup>67</sup> Sipas autorëve, dhunimet, shkatërrimi i pronës dhe vrasjet në baza etnike shtyn serbët të largoheshin në numra të mëdhenj nga Kosova, proces ky që në fakt kishte filluar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kishte vazhduar pas saj, që çoi në reduktimin e përqindjes serbe në popul-

65 Djordje Djurić dhe Momcilo Pavlović, *Istorija za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera i četvrti razred gimnazije opšteg i društveno-jezičkog smera*. (Beograd: Zavod za Udžbenike, 2012), 235.

66 Radojević, *Istorija IV*, 310.

67 Djurić and Pavlović, *Istorija za treći*, 248.

latën e përgjithshme të Kosovës në 13,2%.<sup>68</sup>

Jehonat e Luftës së Dytë Botërore mund të gjinden edhe në diskutimin së fundi për luftën e Kosovës dhe pasluftën. Librat shkollorë serbë nuk i përmendin asnjë nga zhvillimet shoqërore në Kosovë gjatë viteve të 90-ta, siç është rasti me përjashtimin masiv të shqiptarëve nga pozitat shtetërore dhe publike dhe zhvillimin e sistemit paralel të edukimit, e as nuk flasin për represionin e ashpër serb ndaj popullatës shqiptare. Fokus kryesisht përqendrohet të UÇK-ja si “organizatë terroriste” dhe mbi “agresionin e NATO-s”, dhe në këtë kontekst vetëm viktimat serbe përmenden dhe diskutohen. Sipas librit shkollor të Ljušić & Dimić, SHBA-të i dhanë përkrahje separatistëve shqiptarë, fushatës së NATO-s si luftë agresioni dhe spastrimi i vetëm etnik ka qenë ikja e serbëve pas marrëveshjes së Kumanovës në qershor të vitit 1999.<sup>69</sup> Sërish, vetëm viktimat serbe përmenden – fillimisht si viktimat të bombardimit të NATO-s dhe pastaj, numri i serbëve të dëbuar nga Kosova.

### ***Librat shqip***

Në edicionin e parë të librave shkollorë të historisë pas lufte për të gjitha shkollat e mesme nuk kishte dallim dramatik me ato të botuara gjatë sistemit paralel. Trajtimi i Luftës së Dytë Botërore vazhdoi të propozojë një ndryshim rolesh, ku partizanët jugosllavë ishin të këqijtë dhe kundërshtarët e tyre shqiptarë heronj. Libri e prezanton Lidhjen anti-komuniste dhe anti-partizane të Dytë të Prizrenit si patriotike dhe njërin nga udhëheqësit e saj, Bedri Pejanin, të cilin Hadri e quan “kundër-revolucionar”, si figurë madhështore të rezistencës kundër Serbisë. Lufta e Shaban Polluzhës, represioni i Titos në Kosovë në vitin 1945, dhe masakra e Tivarit shquhen.<sup>70</sup>

Përtej librave shkollorë, e tërë historiografia e Luftës së Dytë Botërore pak a shumë e përcjellë një rrëfim të ngjashëm, por me disa dallime të rëndësishme. Temat tabu morën spikatje të re në harmoni me rishikimet e ngarkuara politikisht të historisë që u diskutuan në Shqipëri.<sup>71</sup> Në një përpjekje shumë ambicioze për të botuar historinë e popullit shqiptar të përqendruar në Kosovë, gazetari Jusuf Buxhovi shkruan për një marrëveshje eksplicite mes liderëve komunistë Enver Hoxha dhe Tito më 1944 për të lejuar “ripushtimin e Kosovës nga forcat partizane në mënyrë që ta lënë (Kosovën) nën Serbi”<sup>72</sup> – konspiracion që çoi drejt rekrutimit me forcë të shqiptarëve dhe vrasjes masive të mbi dy mijave në Tivar.

---

68 Ibid., 248.

69 Ibid., 291.

70 Instituti të Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme* (Libri Shkollor, 2003), 302-344.

71 Uran Butka, *Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar* (Tiranë: ADS Studio, 2011).

72 Jusuf Buxhovi, *Kosova. Nga Konferenca e Londrës deri të protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: Faik Konica and Houston: Jalifat Publishing, 2012), 246- 269.

Megjithatë, nëse kjo gjë sinjalizoi se narracioni nacional shqiptar ishte divorcuar paksa nga Jugosllavia dhe komunizmi,<sup>73</sup> nuk sqaroi se çfarë ndodhi në fund të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Në fakt, më 2011 vëllimi monografik i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, *Kosova: Monografi*, nuk përmend këtë gjoja konspiracion e as që “luftëtarët shqiptarë” vullnetarisht u ishin bashkangjitur forcave partizane në Tivar.<sup>74</sup>

Në fund të luftës së vitit 1999, vendosja e protektoratit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, që zgjati deri më shpalljen e pavarësisë më 2008, krijoi një proces të komplikuar të shtetndërtimit nën një udhëheqje të përzier elitash vendore dhe ndërkombëtare. Librat shkollorë të historisë të përvetësuar në shkolla u vendosën shpejt nën ekzaminimin e Departamentit të Arsimit të administratës civile të OKB-së, dhe iu nënshtruan procesit të rishkrimit, për shkak të ndryshimeve në kurrikulë dhe për shkak të trysnisë ndërkombëtare për të rishikuar përmbajtjen dhe gjuhën e përdorur.

Që nga viti 2001, Instituti Georg Eckert për Hulumtimin e Librit Shkollor Ndërkombëtar themeloi Rrjetin për Libra Shkollorë të Evropës Juglindore në kuadër të Paktit Evropian të Stabilitetit. Rishikimet e para të librave shkollorë të historisë në Kosovë, u përqendruan në edicionet e vjetra të botuara gjatë viteve të 90-ta, ishin jashtëzakonisht me rëndësi.<sup>75</sup> Librat shkollorë të Kosovës vazhduan të ekzaminoheshin periodikisht nga grupe të ndryshme ekspertësh dhe raportet filluan të grumbulloheshin.<sup>76</sup>

Në vitin 2004, një grup ndërkombëtar i ekspertëve kreu një analizë gjithëpërfshirëse të të gjithë librave shkollorë të historisë në gjuhën shqipe (11 vëllime), që shfrytëzoheshin nga klasa e IV deri në klasën e XII, gjithashtu për Institutin George Eckert për hulumtim e Librave Shkollorë Ndërkombëtarë.<sup>77</sup> Analiza u përqendrua në identifikimin e stereotipave, gjuhën politikisht të papranueshme, kontekstet, kuptimin, përfaqësimin e përshtatshëm dhe të papërshtatshëm historik, dhe periodizimin, por hulumtimin i historiografisë studiuëse ishte plotësisht i udhëhequr nga brenga politike që librat “të përputhen me parametrat e rezolutës 1244,” që do të thotë të ushqejnë identitetin multinacional Kosovar të bazuar në diversitet.<sup>78</sup> Përfundimi i ekspertëve ishte që librat nuk u përputhen me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, sepse prezantonin historinë monoetnike të Kosovës.

---

73 Për refuzimin e “historisë kominformiste” qendra e së cilës ishte Tirana, shih diskutimin dinamik të historiografisë shqiptare në Kosovën e pas-pavarësisë nga Oliver Jens Schmitt, “Historiografia në Kosovën e pas pavarësisë,” 60-63.

74 Rexhepi Fehmi, “Kosova in the Second World War,” në *Kosova. A Monographic Survey* (Prishtina: Kosova Academy of Sciences and Arts, 2013), 205-211, 209.

75 Denisa Kostovicova, *Kosovo. The Presentation of Europe and the Balkans in South-East European Textbooks. The Albanian-Language Textbooks Used in the “Parallel” Primary and Secondary Schools on Post-Autonomy Kosovo in the 1990s*, 7/28/2002 presentimi.

76 <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-school-textbooks-fail-accuracy-test>  
[http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=156&document\\_ID=157](http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=156&document_ID=157) (linku i klikuar me 10 nëntor, 2016).

77 *Evaluation of Kosovo Albanian History Textbooks* (Braunschweig, 2004).

78 Ibid., Appendix 2, Kërkesat e Vlerësimit.

Në veçanti, raporti konkludoi që Lufta e Dytë Botërore u portretizua në libra në “terme të thjeshtuara apo narracione lineare bardh e zi që nuk korrespondojnë me kompleksitetin e procesit historik.”<sup>79</sup> Problemet kryesore me prezantimin e Luftës së Dytë Botërore ishin paraqitja negative e shqiptarëve nga partizanët komunist si tradhtarë të Jugosllavisë, dhe paraqitja pozitive e opozitës anti-komuniste ndaj okupimit Italian dhe gjerman si dhe bashkëpunimit të anti-komunistëve me okupatorët; por edhe një sërë lëniesh jashtë të fakteve, siç është mungesa e referimit të bashkëpunimit të divizionit SS Skanderbeg me gjermanët; implikimeve më të gjëra të Holokaustit; dhe garës mes Gjermanisë naziste dhe anglezëve për lojalitetin e shqiptarëve, gjë që reflektohej në fraksionalizimin shqiptar.<sup>80</sup> Raporti rekomandoi rishkrimin e sërishëm të librave shkollorë si përgjigje ndaj këtyre kritikave. Së fundi, vet Ministria ka aprovuar standarde për librat shkollorë.<sup>81</sup> Disa nga librat e botuar rishtas i kanë disa ndryshime, por sa substancial ka qenë ky rishkrim mbetet çështje e hapur.

Narracioni nacional që del në pah në librat aktualë shkollorë të Kosovës, ku trajtimi i Luftës së Dytë Botërore është kopjuar, bazohet fuqishëm në dy ide kryesore:

- Kombi shqiptar vazhdimisht është i tradhtuar nga shtetet më të fuqishme si dhe nga fqinjët e vet keqdashës, dhe në shënjestër të Serbisë për gjenocid;
- Ndonëse i vogël, kombi shqiptar është luftëtar i lirisë dhe pavarësisë, megjithëse i pazot t’i bëj keq kombeve tjera, për shkak të traditës së vet të nderit dhe mikpritjes.

Për ta mbajtur konsistent trillimin e homogjenitetit nacional dhe “mirësisë”, çdo diskutim i luftës civile është hequr dhe asnjë figurë e rëndësishme shqiptare nuk paraqitet negativisht. Në vend të kësaj, librat ndjekin një politikë redaktoriale të baraspeshës në të cilën secila anë i ka heronjtë paralel.

Të gjithë librat shkollorë ia atribuojnë shkaqet e Luftës së Dytë Botërore dy blloqeve kundërshtuese imperialiste, në betejë për të ndarë botën, por është Traktati i Versajit në fund të Luftës së Parë Botërore dhe “hidhërimi” me dispozitat e tij për shtetet si Gjermania, Italia dhe Japonia që nxitën konfliktin. Në këtë kontekst, dështimi i Versajit për të lejuar unifikimin e Kosovës me Shqipërinë është vetëm një aspekt i padrejtësisë fundamentale të Versajit. Aneksimi i Shqipërisë nga Italia në vitin 1939, dëshmi shtesë e mungesës së interesimit të Fuqive të Mëdha për fatin e këtij kombi të vogël, vetëm sa konfirmon viktimizimin e saj të dytë.

Sidoqoftë, një çështje që përvijohet në historinë e pjesës së partë të Luftës është rezistenca e Shqipërisë ndaj pushtimit italian, në Shqipëri dhe në Kosovë, përkundër unifikimit të Kosovës me Shqipërinë si përmbushje të aspiratave të kamotshme. Por derisa në të gjithë librat historia e rezistencës në Shqipëri shtjellon luftën civile mes grupeve nacionaliste anti-italiane si *Balli Kombëtar* dhe *Legaliteti* në njërën anë, dhe komunistët në anën tjetër, historia e Kosovës përqendrohet në protestat paqësore të vitit 1941 dhe 1942.

---

79 Ibid., 11.

80 Ibid., 12.

81 MEST, *Administrative Instruction on the Implementation of the Quality Standards for Textbooks*, 2011.

Në Kosovë, ngritja e Ushtrisë jugosllave Nacional-Çlirimtare nën komandën e udhëheqësit shqiptar Fadil Hoxha, tregohet pa iu referuar Partisë Komuniste jugosllave, e cila përmendet vetëm si akronim.<sup>82</sup> Në një libër, ai shfaqësohet zyrtarisht nga çfarëdo përgjegjësie për dhunën e partizanëve ndaj shqiptarëve, sepse Tito e kishte zëvendësuar atë duke e vënë në komandën e ushtrisë partizane “serbin Sava Derlević më 8 shkurt, 1945 kur e kishte vendosur gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë për të luftuar kundër kundër-revolucionarëve.”<sup>83</sup> Andaj, Fadil Hoxha dhe luftëtarët e tij janë heronj të pa njollë shqiptarë, por njëkohësisht edhe udhëheqës nationalist dhe kolaboracionist të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Sic e cekë Oliver Jens Schmitt, risia në historiografinë e re të Kosovës së pas pavarësisë në përgjithësi, dhe që vlen edhe për Luftën e Dytë Botërore, është “kërkimi për një narracion nacional shqiptar të historisë së fundit që kënaqë palët politike që janë në garë me njëra-tjetrën në shtet.”<sup>84</sup>

Librat adresojnë unifikimin e Kosovës dhe Shqipërisë si pozitiv për zhvillimin e arsimit dhe kulturës, dhe të paktën në dy botime këtij aspekti të luftës i kushtohen kapituj të veçantë.<sup>85</sup> Të gjithë librat ia atribuojnë rekrutimin fillimisht të ulët të shqiptarëve në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare të Jugosllavisë kundruall serbëve dhe malazezëve faktit që okupimi fashist më tepër ishte konsideruar si çlirim nga sundimi serb sesa shtypje. Por rrallë ka diskutim për natyrën e regjimeve fashiste dhe naziste dhe ndikimit të tyre në pjesët tjera të botës, përfshirë Ballkanin.

Në veçanti, Holokausti, i cili nuk paraqitet asnjëherë në librat shkollorë të paraluftës, trajtohet ndryshe në secilin botim të librave, por është zakonisht i prezantuar si pasojë e luftës, jo si njëri nga qëllimet e luftës së Hitlerit. Shumica e librave e përfshijnë një seksion të shkurtë me një diskutim të përgjithshëm të shtypjes nën okupimin nazist dhe fashist, ku vetëm kalimthi përmendet persekutimi i hebrenjve, kampeve dhe vrasja e 6 milion hebrenjve<sup>86</sup> në dhoma gazi. Është shfrytëzimi nga okupuesit i të gjitha tokave nën kontrollin e tyre që shpjegon rezistencën dhe Holokaustin.<sup>87</sup> Hebrenjtë referohen si *çifutë*, një fjalë e vjetër që tash është bërë e papranueshme.

Seksionet më të gjata mbi Holokaustin, për shkak të ndryshimeve të kërkuara nga ekspertët ndërkombëtarë në vitin 2004, siç e pranoi një autor, mbesin problematike. Këtu gjuha është ndryshuar: këtu u referohen si *Hebrenjte*, përmendet Holokausti si krim kundër njerëzimit, por jo si gjenocid; dhe ka një numërim çuditërisht të detajuar të viktimave në kampet naziste të vdekjes në bazë të nacionalitetit.<sup>88</sup> Vetëm një libër shkollor flet për kampet e hebrenjve dhe simpatizuesve komunist në Shqipëri dhe Prishtinë.<sup>89</sup>

---

82 Ankesa lidhur me barazimin e rezistencës anti-fashiste vetëm me komunizmin parashtrohen në një botim të vjetër të një libri të përgjithshëm historie, Instituti të Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme* (Libri Shkollor, 2003), 302-344

83 B1 dhe B2, 157.

84 Schmitt, “Historiography in Post-Independence Kosovo,” 67.

85 A2, 121-123; D1 dhe D2, 131-133.

86 Ky numër paraqitet vetëm në A2.

87 Gjuha e përdorur në këtë pjesë u referohet hebrenjve si çifutë, një fjalë e vjetër, e përdorur gjerësisht, por që sot ka konotacion poshtërues: A1, 185; B1 dhe B2, 142; dhe C1, 145.

88 A2, 93-95; D1, 128-130 dhe D2.

89 A2, 94. Shih Noel Malcom, *Kosovo. A Short History* (Mac Millan: 1998), 310.



Dhuna në fund të luftës, me vrasjen masive të shqiptarëve në Tivar, dhe shtypja e kryengritjes në Drenicë vetëm përmenden, pa ndonjë detaj apo shpjegim. Por të gjithë librat qartazi theksojnë se këto ngjarje janë konfirmim i vazhdueshëm i gjenocidit serb ndaj shqiptarëve.<sup>90</sup> Vetëm një tekst e trajton me detaje luftën në Drenicë dhe e paraqet figurën e Shaban Polluzhës si udhëheqës partizan që u ngritë në këmbë për ta mbrojtur komunitetin e tij nga sulmi *četnik*, duke refuzuar të lëvizë jashtë Kosovës për të përndjekur gjermanët në Serbinë veriore, dhe kështu duke shkelur urdhrin e udhëheqësit partizan Fadil Hoxha.<sup>91</sup> I njëjti libër bën krahasim eksplisit mes “spastrimit etnik” të ushtruar nga komunistët serb dhe malazez në Drenicë, dhe dhunës së ushtrisë serbe më 1912-15.<sup>92</sup>

Të gjithë librat shkollor theksojnë se pjesëmarrësit e Konferencës së Bujanit janë vrarë ose burgosur, por nuk e përmendin faktin se disa prej tyre kanë marrë pjesë në Kuvendin e Prizrenit, ku rezoluta për aneksimin e Kosovës nga Serbia është aprovuar me aklamacion, edhe pse nën kërcënim.<sup>93</sup>

Të gjithë librat shkollorë arsyetojnë radhitjen e Lidhjes së Dytë të Prizrenit me gjermanët si projekt nacionalist dhe jo si projekt ideologjike, duke prezantuar relacionin mes dy palëve oportunist në mënyrë të barabartë. Ata nuk e përmendin dhunën ndaj kolonëve serb dhe malazez dhe dëbimin e tyre, i cili është mirë i dokumentuar nga burimet italiane, përfshirë arkivat ushtarake,<sup>94</sup> si dhe burimet gjermane, siç janë dokumentuar nga Ali Hadri.<sup>95</sup> Një libër shënon që shqiptarët i kanë mbrojtur serbët dhe malazezët, të cilët ishin të kërcënuar nga okupuesit italianë.<sup>96</sup>

Vetëm në një libër të përgjithshëm të vjetër për klasët e ulëta të shkollës së mesme, udhëheqësi i Lidhjes, Bedri Pejani, prezantohet si patriot i madh që meriton seksionin e ndarë, dhe Xhafer Deva që shquhet si kolaboracionist i gjermanëve në masakrën e vitit 1944 të luftëtarëve partizan shqiptar në Tiranë.<sup>97</sup>

---

90 B1: ky libër flet për gjenocidin serb në pjesë e fundit të luftës, me 53,000 viktima shqiptare.

91 D1/2, 124-125.

92 Dyjat D1/2 flasin për rreth 43,000 viktima shqiptare në fund të luftës me partizanët serb.

93 Atje, vetëm 33 nga 143 anëtarë ishin shqiptarë..

94 Carlo Umilta', *Jugoslavia e Albania. Memorie di un Diplomatico* (Milano: Garzanti, 1947) dhe Giovanni Lorenzoni, *Rapporto sulla Riforma Agraria Jugoslava con special riguardo ai territori interessanti l'Albania, la Dalmazia e la Croazia* (Roma: Ministero degli Affari Esteri, 1942) dokumenton kolonat e fshatarëve serbë dhe malazez, të cilët po largoheshin të përndjekur nga shqiptarë të armatosur, veçanërisht mes prillit dhe tetorit 1941.

95 Hadri, *Lëvizja Nacionallirimitare*,

96 A2, 118.

97 Instituti e Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, 320-321 and 323. Ky libër arrin në konkluzionin se lufta anti-fashiste çlirimtare në Shqipëri dhe Kosovë ishte njësoj si të gjitha luftat çlirimtare në Europë dhe se shqiptarët u rreshtuan në anën e fituesve. Ata ishin mes popujve që vuajtën më shumë duke humbur 7% të popullsisë, f. 336.

## Kapitulli i 4: Mësimdhënësit e historisë dhe mësimdhënia e historisë në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë

### *Kushtet dhe ndjenja e përkohësisë*

Përshtypja jonë e parë kur po aranzhonim intervistat si dhe kur po vizitonim shkollat për t'u takuar me mësimdhënës, ishte organizimi shumë i dobët logjistik i shkollave serbe në Kosovë. Disa nga mësimdhënësit janë të angazhuar në më shumë se një shkollë. Një numër shkollash janë në fakt të përqendruara në një ndërtesë, i ndajnë të njëjtat objekte. Disa shkolla e japin një ndjenjë të përkohësisë që kur ka përfunduar lufta. Emrat e shkollave ende u referohen emrave të shkollave të para vitit 1999 dhe lokacioneve në atë që tani është Kosova e pavarur, p.sh. Gjimnazi në Vushtrri me qëndrim të përkohshëm në Mitrovicë.<sup>98</sup> Këta emra u referohen shkollave në lokacione ku nuk ka më komunitet serb në Kosovën e pas vitit 1999. Për shembull, shkolla në kryeqytetin e Prishtinës më nuk ekziston dhe ajo është zhvendosur në një vend të ri. Një gjë e tillë duket se e reflekton një realitet të zgjedhur vet për t'i paузuar shumë aspekte të përditshmërisë dhe nevojave të komunitetit, të jetojnë në kushte të përkohshme, pa i njohur strukturat e reja vendimarrëse apo duke u përpjekur t'i mbajnë gjallë disa realitete të së kaluarës që më nuk ekzistojnë në Kosovë. Asnjë nga këta mësimdhënës nuk shprehu hezitim apo konfuzion rreth këtyre kushteve, të cilat sipas gjitha gjasave i perceptojnë si gjendje "normale".

Sipas një mësimdhënësi, është goxha vështirë të japësh mësim, jo vetëm në histori por edhe në fusha tjera, apo të punosh në çfarëdo profesioni tjetër për shkak se ata jetojnë nën okupim. Siç tha mësimdhënësi, "këtu kemi një situatë specifike, meqë jetojmë nën okupim. Përndryshe çdo gjë do të ishte normale, sikur në pjesët tjera të Serbisë..." (Intervista 21). Në përpjekjen tonë për të sqaruar këtë deklaratë – Kush janë okupatorët? Çfarë është natyra e okupimit? ai iu referua akterëve ndërkombëtarë të cilët tani qeverisin Kosovën. Derisa po flisnim, një grup policësh të BE-së kaluan pranë, dhe ai iu referua atyre si dhe të tjerëve si NATO, amerikanëve e BE-së.

---

98 Shembujt mund të gjehen në uebfaqen gjithpërfshirëse mes informacionit tjetër që lidhet me arsim, lista e shkollave në Serbi çfillore dhe të mesme] sipas radhitjes alfabetike të lokacionit [shih: [www.srednjeskole.edu.kg/drzavne-srednje-skole/svi-gradovi](http://www.srednjeskole.edu.kg/drzavne-srednje-skole/svi-gradovi)]. Për shembull: Shkolla e mesme Laplje Selo (e zhvendosur nga Prishtina) ose Shkolla e Mesme dhe Shkolla Teknike në Mitrovicën e Kosovës, e zhvendosur nga Vushtrria. Emrat e shkollave të mesme në listën e uebfaqes së cekur më lartë shpesh dallojnë nga emrat që janë të vendosur në shenjat jashtë shkollave, siç është rasti me Shkollën e Mesme në Vushtrri që përkohësisht është e vendosur në Mitrovicë (emri i shkollës siç shfaqet në listën e shkollave të mesme serbe nga uebfaqja e cekur më lart: Shkolla e Mesme dhe Shkolla Teknike e zhvendosur nga Vushtrria)



## ***Librat shkollorë***

Të gjithë mësimdhënësit e intervistuar i përdorin librat shkollorë të historisë të aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Serbisë (nga këtu Ministria e Arsimit). Vetëm një mësimdhënës ende e përdorë një version më të vjetër të librit shkollor serb të historisë (Intervista 24). Të gjithë mësimdhënësit thanë se nuk kanë kontakte apo lidhje me Ministrinë e Arsimit të Kosovës. Edhe pse u përmendën seminarët që janë organizuar gjatë viteve, me qëllim për t'i lidhur mësimdhënësit serbë dhe shqiptarë nga Kosova, asnjë nga mësimdhënësit nuk ka pasur dëshirë të marrë pjesë në to, e për tepër, asnjë nga mësimdhënësit si ka parë të rëndësishme as sa për t'i përmendur.

Të dhënat tona sugjerojnë që jo të gjithë mësimdhënësit e historisë së shkollave të mesme në Kosovë domosdoshmërisht i përdorin librat shkollorë zyrtarë të historisë në klasë, meqë disa zgjedhin të përdorin resurse tjera në vend të tyre. Shpesh mësimdhënësit as nuk kërkojnë nga nxënësit t'i blejnë librat shkollorë të përcaktuar. Shumica e mësimdhënësve kanë theksuar se i inkurajojnë nxënësit e tyre t'i përdorin librat shkollorë më të vjetër të historisë gjithashtu, për shkak të çmimit të lartë të librave të rinj shkollorë serbë. Andaj, nxënësit huazojnë librat nga familjarët më të vjetër, fqinjët ose miqtë. Andaj, duhet pasur goxha kujdes kur tentohet të bëhet lidhja direkte mes përmbytjes së librave shkollorë të tanishëm të historisë, ligjëratave dhe komunikimit në klasë e diskutimit të materialit. Shpesh, ligjëratat dhe komunikimi në klasë varen nga pikëvështrimi politik i mësimdhënësit dhe/ose përkatësisë së tij politike.

## ***Vetinterpretimet***

Intervistat tregojnë një diskrepancë të madhe mes përmbytjes që gjendet në librat shkollorë të historisë dhe asaj se çfarë mësimdhënësit përfundojnë duke e ligjruar në klasë. Secili mësimdhënës i ka spikatur ngjarjet e ndryshme nga Lufta e Dytë Botërore që duhet të theksohen në veçanti. Mirëpo, pothuaj asnjë nga këto ngjarje nuk lidhen me Kosovën, mbase për shkak se kryengritja e armatosur kundër forcave okupuese ishte shumë më e ashpër në pjesët e tjera të Jugosllavisë si në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, dhe Mal të Zi sesa në Kosovë.

Mësimdhënësit përqendrohen në pushtimin dhe ndarjen e Jugosllavisë, duke e shquar okupimin ushtarak gjerman nazist të Serbisë së brendshme dhe krijimin e shtetit marionetë të Shtetit të Pavarur të Kroacisë (NDH); gjenocidit ndaj serbëve në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH) dhe kampin e koncentrimit në Jasenovac; kryengritjet e armatosura të partizanëve dhe njësisive *četnike*; dhe lufta civile mes partizanëve dhe *četnikëve*.

Për shembull, sipas një mësimdhënësi, gjithmonë ka ekzistuar një trysni e madhe nga qeveria mbi planprogramin e historisë si lëndë mësimore. Ky presion është reflektuar në librat shkollorë të historisë, në lidhje me të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me historinë e shekullit 20 të kombit serb (Intervista 21). I njëjti mësimdhënës shtoi se janë një sërë ngjarjesh të Luftës së Dytë Botërore që duhet të adresohen më mirë në librat shkollorë. Sipas tij, material shtesë për kampin e koncentrimit në Jasenovac të Shtetit të Pavarur të Kroacisë (NDH) duhet të jepet në klasë nga mësimdhënësit, meqë kjo temë nuk është e prezantuar si duhet në librat shkollorë të historisë.

Dy mësimdhënës të historisë sqaruan se nxënësit tashmë vijnë në klasë me njohuri paraprake të tyre për disa ngjarje në të cilat gjyshërit e tyre kanë qenë pjesëmarrës (intervista 22 dhe 25). Andaj, sipas tyre, transmetimi oral ndër gjenerata i kujtimeve historike luan rol të rëndësishëm në socializimin e hershëm në mes të familjeve serbe të Kosovës, duke siguruar interpretime të historisë që shpesh hasin në kundërthënie me atë çfarë prezantojnë librat shkollorë. Siç thotë një mësimdhënës, “Pothuaj secili nxënës i ynë ka një njohuri paraprake që e ka marrë nga baballarët e tyre dhe nga më të vjetrit në familje, dhe ata e dinë fare mirë se çfarë ka ndodhur në këto pjesë” (Intervista 22).

Përderisa të gjithë mësimdhënësit serbë përdorin terme si Kosova e Metohia dhe “shqiptar” kur u referohen shqiptarëve, ne kemi arritur t’i identifikojmë disa shenja të vogla të diversitetit, sidomos kur ata iu referuan Luftës së Dytë Botërore dhe ngjarjeve aktuale. Dallimet varen nga e kaluara e tyre, për shembull nëse ata dhe/ose familjet e tyre janë pro-jugosllav apo pro-Titos, apo pro-*Çetnik*. Kjo ndarje na duket çështje e brendshme serbe që ende sot e kësaj dite e përcakton se si një mësimdhënës do ta ligjërojë Luftën e Dytë Botërore, si dhe ngjarjet e tjera që pasuan me shpërbërjen e dhunshme të Jugosllavisë, apo qoftë edhe Jugosllavinë socialiste.

Sa më të moshuar të jenë mësimdhënësit, aq më shumë ka gjasa që ata të kenë ende kujtime të gjalla dhe referenca për vitet e arta të Jugosllavisë gjatë viteve të 70-ta, kur relacionet përbrenda komuniteteve të tyre lokale nuk definoheshin vetëm nga përkatësia etnike, edhe në rastin e Kosovës. Kemi vërejtur një ndjenjë të së ashtuquajturës “Jugo-nostalgji” te ata – nostalgji për kohën kur komunitetet lokale nuk definoheshin vetëm nga përkatësia etnike, edhe në rastin e Kosovës, dhe kur standardi i jetës ishte më i lartë.

Pjesëmarrësit më të rinj, të cilët nuk kishin referenca të tilla, tashmë tingëllonin si produkt i historisë revizioniste të Luftës së Dytë Botërore si dhe të luftërave të viteve 90 të thurur pas shkatërrimit të Jugosllavisë. Ata janë më të orientuar kundër Jugosllavisë, duke besuar se Serbia e pavarur ishte “çliruar” nga komunizmi, dhe se si shtet i pavarur, do të respektohet më shumë nga shtetet e tjera dhe do të jetë e lirë që ta ushqejë traditën e vet serbe dhe trashëgimin historike të saj.

### ***Lufta e Dytë Botërore - Ngjarjet***

Çka është me rëndësi? Kemi hasur në një pasqyrë goxha të thjeshtuar të Luftës së Dytë Botërore që mësimdhënësit e mësojnë kur e diskutojnë atë në kontekst të Kosovës. Cilat janë temat kryesore? Shqiptarët ishin aleat të Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste në mënyrë që ta arrijnë qëllimin e tyre, që ishte dhe është, Shqipëria e Madhe. Serbët ishin viktima, dhe shqiptarët kryen krime të tmerrshme ndaj tyre; nuk përmenden krimet që serbët i kryen ndaj shqiptarëve. Gjithashtu, të gjithë serbët ishin antifashist, pavarësisht se a ishin pjesë e lëvizjeve partizane apo *çetnike*. Dhe përfundimisht, nuk përmendet aspak rezistenca shqiptare apo shqiptarët që luftuan kundër italianëve dhe/ose nazistëve.

Shumica e mësimdhënësve që u intervistuan thanë se u sqarojnë nxënësve të tyre se shqiptarët janë përpjekur ta shfrytëzojnë mundësinë që u është dhënë gjatë Luftës së Dytë Botërore për të krijuar “Shqipërinë e Madhe.” Shumica e popullatës shqiptare, sipas të gjithë mësimdhënësve të intervistuar, përkrahën forcat okupuese, Italinë fashiste dhe Gjermaninë naziste, në mënyrë që ta përmbushin qëllimin e tyre politik.

Sipas një mësimdhënësi të historisë, “Të gjithë myslimanët ishin fashist,” dhe ai i portretizoi të gjithë shqiptarët si myslimanë (Intervista 21). Dy mësimdhënës theksuan se shqiptarët erdhën në Kosovë nga Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore, dhe u vendosën në ato zona prej nga kolonët serbë të periudhës së mes dy luftërave ishin dëbuar (Intervistat 22 dhe 25). Shumica e mësimdhënësve po ashtu besojnë se serbët po iknin në ato zona që nuk ishin të kontrolluara nga shqiptarët dhe ballistët sepse ndiheshin më të sigurtë në pjesët e tjera të okupuara sesa në pjesët e Kosovës të kontrolluara nga shqiptarët nën protektoratin italian.

Asnjëri nga mësimdhënësit nuk identifikoi një ngjarje të vetme të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë që ja vlen të shquhet. Atyre iu interesojnë vetëm ato ngjarje që janë të lidhura me vuajtjet dhe çlirimin e Serbisë/Jugosllavisë, pra, me gjenocidin në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH), kampin e koncentrimin të Jasenovacit, çlirimin e Beogradit dhe *frontin e Sremit*. Përderisa dy kanë të bëjnë me dhunën fashiste dhe naziste, ngjarja e tretë ka të bëjë me dhunën e partizanëve. *The Sremski Front (Fronti i Sremit)* është themeluar në fund të vjeshtës së vitit 1944, pas çlirimit të Beogradit, dhe kur është thyer ky front, pjesët e tjera të Jugosllavisë ishin çliruar. Në historiografinë bashkëkohore serbe, ekziston një polemikë për operacionet që kishin ndodhur në atë front, në veçanti për njëri shpjegim të ngjarjes që tregon se si shumë të rinj nga Beogradi rekrutoheshin me dhunë.

Siç tha njëri nga mësimdhënësit, varet nga preferenca e mësimdhënësit, “disa mësimdhënës preferojnë Luftën e Parë Botërore; disa preferojnë Luftën e Dytë Botërore, andaj ai/ajo përqendrohen më shumë në atë” (Intervista 24). Ngjashëm, secili mësimdhënës “preferon” njëjën apo tjetrën ngjarje të Luftës së Dytë Botërore. Duke u bazuar në intervista, është e qartë që disa mësimdhënës i kushtojnë më shumë kohë Luftës së Dytë Botërore dhe disa aspekteve më të gjëra të kësaj ngjarjeje nëpër mbarë botën, derisa tjerët përqendrohen vetëm në Luftën e Dytë Botërore dhe pasojat e saj për Jugosllavinë.

Mësimdhënësit theksuan se Luftës së Dytë Botërore i kushtohet pak kohë dhe vëmendje në zbatimin konkret të kurrikulës. Shpesh, derisa vjen koha për mësuesit ta mësojnë në klasë këtë temë, mbaron viti shkollor. Atyre u mungon koha, dhe hasin në mungesë të pjesëmarrjes së nxënësve, andaj u duhet të përshpejtojnë kalimin nëpër këtë material.

Sipas të gjithë mësimdhënësve, ata nuk kanë kohë adekuate të merren me këtë temë detajisht, e as nuk kanë mundësi të merren me nuancat e ngjarjeve më të komplikuar që ndodhën gjatë luftës, siç është rasti me luftimet e ashpra mes partizanëve nationalist shqiptarë dhe partizanëve jugosllavë apo për masakrën e Tivarit. Kur u pyetën se sa kohë ja kushtojnë mësimdhënies për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë, mësimdhënësit kryesisht thanë që nuk kanë kohë të përqendrohen në të. Siç tha njëri nga mësimdhënësit kur u pyet për rolin e shqiptarëve në lëvizjen antifashiste në Kosovë, “unë nuk kam kohë të mjaftueshme të flas për pjesëmarrjen e shqiptarëve në lëvizjen partizane” (Intervista 22). I pyetur për vuajtjet e serbëve në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, një mësimdhënës tha, “unë flas shumë pak për këtë çështje sepse nuk kam kohë” (Intervista 21).

## ***E kaluara e mësimdhënësve si parametër definues i mësimdhënies së tyre dhe komunikimit me histori***

Bazuar në të dhënat tona, e argumentojmë se e kaluara e mësimdhënësve, prejardhja dhe kujtimet, e kanë ndikimin më të madh në mësimdhënien e historisë nga ai apo ajo. Për shembull, kemi identifikuar dallime të rëndësishme në mësimdhënie e një mësimdhënësi që është refugjat nga që qytet i Kosovës që ka qenë etnikisht heterogjen para luftës, dhe një mësimdhënësi gjyshi i të cilit ka qenë simpatizant i lëvizjes *çetnike*. Në narracionin dhe botëkuptimin e mësimdhënësës së parë, edukimi në frymën jugosllave dhe niveli i lartë i tolerancës për çështje të caktuara ka ndikuar në mësimdhënien e saj, derisa disa nga kolegët e saj kanë shprehur qëndrime shumë të ngurta, përfshirë mësimdhënësin gjyshi i të cilit ishte simpatizant i lëvizjes *çetnike*.

Siç shpjegoi një mësimdhënës, ai gjithmonë e fillon klasën e tij me Luftën e Dytë Botërore në Jugosllavi me pyetjen, “Ku ishte gjyshi juaj gjatë luftës? Kush ishte gjyshi juaj?” Siç tha ai, “I njoh pothuaj të gjithë studentët e mi, ua di të kaluarën familjare dhe historinë, e di kush ishte pjesëtar i lëvizjes partizane, kush ishte pjesëtar i lëvizjes *çetnike*, ndonëse këtu (në Kosovë), serbët kryesisht ishin të përqendruar në mbijetesën e tyre dhe nuk ishin në gjendje t’i bashkoheshin lëvizjeve fare. Këtu, kemi më shumë fëmijë të luftëtarëve të Luftës së Parë Botërore, ‘Solunaca,’ gjyshi im ishte ‘Solunac’”<sup>99</sup> (Intervista 25).

Të gjithë mësimdhënësit që i intervistuaam ndjenë nevojë të na tregojnë diçka për të kaluarën e tyre dhe atë të paraardhësve. Tre mësimdhënës thanë se e ndajnë të kaluarën e tyre dhe prejardhjen familjare me nxënësit e tyre. Që të tre thanë se i ndajnë kujtimet e tyre personale të vitit 1999 me nxënësit.

Sipas vrojtimit tonë arrijmë në përfundim që meqë mësimdhënësit e zbulojnë prejardhjen e tyre politike familjare në klasë, atëherë nuk mbetet pothuaj aspak vend që në mënyrë kritike t’i trajtojnë ngjarjet që i mësojnë, duke u nisur nga Lufta e Dytë Botërore si dhe ngjarjet e tjera, në veçanti me ato që lidhen me ndasitë e brendshme mes partizanëve dhe *çetnikëve*. Është e rëndësishme ta përmendim që këto ndasi, sidomos mes partizanëve dhe *çetnikëve*, janë ende të pranishme në diskutimet e vazhdueshme dhe në debatet në Serbinë bashkëkohore. Përderisa partizanët shihen si pro-jugosllav, pothuaj anti-serb, nga shumica e historianëve serbë, çetnikët shihen si ata që kanë luftuar për Serbinë, jo për Jugosllavinë.

---

99 “Solunac” në serbisht do të thotë “qytetar i Selanikut”. Gjatë Luftës së Parë Botërore, pasi Serbia u pushtua nga Austro-Hungaria, Gjermania dhe aleatët e tyre, shumë serbë shkuan në Greqi ku u bashkuan me Forcat Aleate, veçanërisht me forcat franceze. Këtu ata formuan “frontin Solunski” ose “frontin maqedonas”, përpjekje të cilat, më së fundi, çuan në çlirimin e Serbisë gjatë Luftës së Parë Botërore.

### ***Konfliktet e brendshme serbe dhe ndasitë e identifikuar në Kosovë si dhe në Serbi.***

Mbi të gjitha mësimdhënësit serb në Kosovë janë shumë të vetëdijshëm për trendet historio-grafike në Serbi. Siç diskutuam më lart, në Kapitullin 3, ndryshimet në librat shkollor të historisë në vitet e 1990-ta dhe pas vitit 2000, reflektojnë zhvillimet përbrenda historio-grafisë serbe, në veçanti sa i përket rehabilitimit të lëvizjes *četnike*. Meqë katër nga pesë mësimdhënësit e intervistuar përdorin librat shkollorë të aprovuar nga Ministria serbe e Arsimit, këto zhvillime të reja dhe konfliktet e brendshme serbe, e në veçanti rehabilitimi i lëvizjes *četnike*, mund të identifikohen në librat shkollor të historisë që i shfrytëzojnë mësimdhënësit.

### ***Konstruksioni i shqiptarëve si “Tjetri”***

Mësimdhënësit kryesisht e përdorin termin Kosovë dhe Metohi, emrin zyrtar të Kosovës e cila sipas Kushtetutës së Serbisë të vitit 2006 është ende krahinë e Serbisë, për të shënuar atë që në gjuhën shqipe quhet Kosovë dhe në gjuhën angleze Kosovo. Veç kësaj, ata e përdorin termin “*Šiptar*,” të cilin shqiptarët e konsiderojnë si term ofendues.

Në intervista, ne e shtrojmë këtë pyetje: “A i ka rezistuar popullata shqiptare në Kosovë okupimit?” Shumica e mësimdhënësve thonë që nuk duhet befasuar që shqiptarët ishin “në anën tjetër” gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse serbët dhe shqiptarët gjithmonë kanë qenë në taborre të kundërta përgjatë historisë.

Imazhi të cilin nxënësit mund ta formojnë për shqiptarët është ai i “armikut të përbetuar” të serbëve. Sipas njërit mësimdhënës, “Këtu, në Kosovë, *Ballistët* ishin aleat të okupatorëve. Ata kryesisht ishin *Šiptar*, ose shqiptarë. Andaj, gjatë Luftës së Dytë Botërore, më shumë se 200,000 serbë ikën nga Kosova dhe Metohija për shkak të terrorit, për shkak të frikës. Ata ikën në Serbinë Qendrore, dhe pas luftës nuk u është lejuar të kthehen në tokat e tyre. Ato familje mbetën përgjithmonë në Serbi” (Intervista 24).

Një mësimdhënës tjetër thotë që, “Ata [shqiptarët] e fituan Shqipërinë e Madhe, kështu që kishin mundësinë të bënin kërdi, të vrisnin, të vidhnin; i veshën uniformat e Hitlerit...” (Intervista 21). Meqë secili mësimdhënës theksoi që nuk ka kohë të mjaftueshme në klasë të sqarojë me detaje se çfarë ka ndodhur në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore (për shembull ndasitë mes shqiptarëve), imazhi i vetëm që studentët mund ta kenë është që shqiptarët ishin të gjithë “kryes të krimeve,” “aleat të fashistëve dhe nazistëve”, pa asnjë shembull të bashkëpunimit mes shqiptarëve dhe serbëve, e gjithashtu pa përmendur faktin se në Kosovë ka pasur po ashtu njësi jugosllave partizane të përbëra nga shqiptarët gjithashtu.

### ***Dallimet në dinamikë dhe referencë ndërmjet mësimdhënësve nga Graçanica dhe nga Mitrovica Veriore.***

Kemi hasur në një ton dhe qasje paksa më të butë te mësimdhënësit e Graçanicës, të cilët në shumë mënyra vërtetojnë se e pranojnë realitetin aktual në Kosovë, ndërrimin e raportit të forcës mes serbëve dhe shqiptarëve, të vulosur me krijim e komunave serbe. Këtu, nevojat e përditshme kryhen në gjuhën serbe. Me sa kuptuam kjo qasje po ashtu e formëson qasjen e mësimdhënësve në klasë. Këtë dy shembuj shërbejnë si ilustrim:

1. Mësimdhënësit nga Graçanica kryesisht e përdorin termin “shqiptarët” në vend të “Šiptar;”
2. Kur flasin për shqiptarët, mësimdhënësit nga Graçanica, në mënyrë indirekte përmendin gjithmonë nevojën që të bashkëpunojnë me shqiptarët.

Siç tha një mësimdhënësi, “Si historian, nuk mund t’ia lejoj vetes të jem subjektiv. Për mua, qëllimi është t’ua shpjegoj atyre fëmijëve se si ta kuptojnë historinë, dhe jo t’iu them se kroatët e shqiptarët janë njerëz të këqij. Gjithmonë ju them nxënësve të mi ‘kurrë mos i urreni shqiptarët si komb.’ Mund ta urreni si individ dikë që u ka bërë keq (juve), por nuk mund të urreni një komb të tërë. E ndaj këtë dashuri me nxënësit e mi sa mundem.” Dhe në fund shtoi, “Në fund të fundit, jemi fqinj këtu” (Intervista 25). Ky qëndrim duket se ilustron se sa i vetëdijshëm është ky mësimdhënësi për mësimdhënien e historisë në mënyrë që të mos i ushqejë tensionet etnike.

Në anën tjetër, asnjë nga mësimdhënësit me të cilët biseduam në Mitrovicë nuk e theksoi nevojën për ta portretizuar mësimdhënien e historisë si mjet potencial për të shtendosur tensionet etnike. Në përgjigjet e tyre, ata ishin më të përqendruar në marrëdhënien mes Beogradit zyrtar dhe pjesës veriore të Kosovës, gjë që nuk ishte rasti me mësimdhënësit e Graçanicës. Vërejtëm që kur u referoheshin kolegëve dhe punës së edukatorëve në fushën e tyre, mësimdhënësit nga Mitrovica iu referoheshin vetëm historianëve dhe mësimdhënësve të historisë nga Serbia. Asnjëherë nuk i përmendën apo nuk ju referuan serbëve në jug të lumit Ibër kur e diskutuan mësimdhënien e historisë në Kosovë. Me fjalë të tjera, ata sikur e identifikonin lumin Ibër si kufi gjeografik dhe politik, që sot shënon kufirin mes Kosovës dhe Serbisë.

Përderisa injorimi i serbëve që jetojnë në pjesën jugore të Kosovës ishte i qartë në intervistat e zhvilluara në Mitrovicë, situata ishte ndryshe në intervistat e zhvilluara në Graçanicë. Atje, mësimdhënësit janë plotësisht të vetëdijshëm për kolegët e tyre serb në veri të Kosovës. Ata e përmendën që shpesh shihen si tradhtarë nga ta.

Siç tha njëri mësimdhënësi, “Ekziston një dallim i madh në mësimdhënien e historisë në Mitrovicë dhe Graçanicë. Serbët nga Kosova veriore nuk kanë ide sa vështirë ka qenë (për ne) të mbijetojmë këtu. Shumica prej tyre as nuk e kalojnë lumin Ibër, por e quajnë veten ‘serbë të mëdhenj.’ Kam biseduar me kolegët e mi nga veriu, dhe këta historianë mund të jenë shumë armiqësor, flasim për njëfarë ‘Serbianizimi.’ Eja këtu, dhe shih se si duket beteja e vërtetë, dhe sa vështirë është të mbijetosh... Ata gjithmonë na kanë parë si tradhtarë për shkak se ne ishim ata që filluam të bashkëpunojmë me shqiptarët. Më është dashur të mbijetoj. Ju (Serbët e Kosovës veriore) jeni atje lart, në kufi me Serbinë, mund të shkoi në Serbi kur të doni. Mua më është dashur të marrë letërnjoftim për ta regjistruar veturën” (Intervista 25). Gjithashtu, thotë mësimdhënësi, “Ata janë serbë të mëdhenj, por edhe unë jam Serb i Madh. Nuk do të thotë që jam tradhtar vetëm pse kam vendosur të mbijetoj. Unë jam më realist në këtë rrëfim, është e pavërtetë se si na portretizojnë. E di që jam për dhjetë herë serb më i madh se shumica absolute e atyre që jetojnë në veri. Dhe nxënësit këtu e dinë këtë gjë dhe e pranojnë” (Intervista 25).

Megjithatë, përkundër dallimeve të mësimdhënësve të Mitrovicës dhe Graçanicës se si i perceptojnë shqiptarët, nuk kemi identifikuar dallime në mësimdhënien e historisë. Secili



mësimdhënës e konsideron si detyrë të veten kryesore të japë mësim në përputhje me planprogramin e Ministrisë serbe të Arsimit, dhe t'i mbajnë të gjitha ligjëratat sipas orarit para përfundimit të vitit shkollor.

### ***Mungesa e interesimit të nxënësve dhe frustrimi i mësimdhënësve***

Shumica e mësimdhënësve pohojnë se nxënësve nuk iu intereson historia, se kanë vështirësi ta joshin vëmendjen e tyre dhe kanë nevojë të jenë kreativ për ta mbajtur vëmendjen e nxënësve larg nga lojërat e tyre në telefon dhe mediat sociale. Gjithashtu, sipas disa mësimdhënësve, politika e sotme ndërhyrëse në mësimdhënien e tyre të historisë.

Siç theksoi një mësimdhënës, “dua t’iu them nxënësve të mi se duhet ta studiojnë historinë e mos të merren me politikë. Fëmijët sot dinë më shumë për politikë, sepse prindërit e tyre flasin për politikë gjatë gjithë kohës, dhe për shkak se e përdorin internetin. Megjithatë, ata nuk po e përdorin internetin për të mësuar, por për t’u argëtuar...” (Intervista 25). Ky mësimdhënës po ashtu tha, “për mua, kur bëhet fjalë për historinë, çdo gjë është interesante... por më duket që nxënësit nuk janë aspak të interesuar, në fakt nuk e di, por po bëj çmos që t’i interesoj në histori” (Intervista 25).

### ***Holokausti në Serbi dhe Jugosllavi***

Të gjithë mësimdhënësit serb të historisë theksuan se e ligjërojnë në klasë Holokaustin, dhe pohuan që Holokausti është njëri ndër mësimet më të rëndësishme që i ligjërojnë për Luftën e Dytë Botërore. Ata përqendrohen në Holokaustin në nivel evropian, megjithëse kur i pyetëm për Holokaustin në Serbi dhe Jugosllavi, morëm përgjigje dhe interpretime të ndryshme. Të gjithë mësimdhënësit e pranuan që Holokausti ka ndodhur në Serbi dhe Jugosllavi, megjithatë e interpretuan në mënyra të ndryshme.

Mësimdhënësit përqendrohen në Holokaustin e kryer në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH), duke e dhënë kampin e koncentrimit të Jasenovacit si shembullin më të qartë të gjenocidit. Megjithatë, të paktën dy mësimdhënës i bëjnë bashkë vrasjet e hebrenjve dhe serbëve. Siç tha njëri mësimdhënës, “Natyrisht që e përmendim Holokaustin, dhe rrëfimet tona të dhimbshme të historisë tonë. Serbët, hebrenjtë dhe romët me të vërtetë vuajtën shumë” (Intervista 22). Dy mësimdhënës përmendën ekzistimin e kampit në Staro Sajmište, dhe dytë ia mveshën përgjegjësinë për kampe dhe për Holokaust në Serbi gjermanëve nazist dhe njësisive *ustaše*. Një mësimdhënës edhe e theksoi që Beogradi ishte qyteti i parë evropian që u deklarua “*Juden-frei*,” megjithatë i njëjti mësimdhënës deklaroi që nuk ka përgjegjësi serbe në këtë çështje (Intervista 23). I njëjti mësimdhënës po ashtu e përmendi deportimin e hebrenjve të Prishtinës më 1944, kur italianët u tërhoqën, dhe kur qyteti u vendos nën kontrollin e gjermanëve dhe njësitit SS Skenderbeg (Intervista 23).

Vetëm një mësimdhënës shprehu pakënaqësi me librat shkollorë të historisë sa i përket Holokaustit. Sipas tij, “Ekziston një pjesë e veçantë në librin shkollor për Holokaustin, që është interesante, sepse po i kushtojnë më shumë rëndësi atij, e po i injorojnë viktimat serbe. Nëse dikush ishte i përzier në Holokaust, ata ishin *Šiptarët*, sepse gjermanët dhe italianët nuk deshën gjak në duart e tyre” (Intervista 21). Është e rëndësishme po ashtu të përmendet që i njëjti mësimdhënës e bëri një deklaratë që ku në mënyrë indirekte e krahasoi situatën në Auschwitz me pozitën e tanishme të serbëve në veri të Kosovës.

## **Kapitulli i 5: Mësimdhënësit e historisë dhe mësimdhënia e historisë në shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë**

Gjatë intervistimit të mësimdhënësve të shkollave të mesme të historisë, në përgjithësi diskutuam se çfarë ligjërojnë ata për Luftën e Dytë Botërore, por i ngushtuam pyetjet për të përfshirë tema dhe ngjarje thelbësore, të cilat janë heshtur apo janë theksuar nëpër libra shkollorë në kohë të ndryshme për arsye politike apo ideologjike. Në veçanti, u përqendruam në pikat e qëndrueshme të narracionit kombëtar shqiptar të luftës, të cila reflektohen në librat aktual shkollorë të historisë vetëm në mënyrë të çrregullt, por që mbesin shumë të pranishme në komunikime private dhe në libra të botuar nga historia-nët profesionist dhe amator:

- Këndvështrimi se lëvizja partizane ishte krijesë ekskluzivisht serbe dhe malazeze;
- Bashkëpunimi i shqiptarëve me okupimin e mirëpritur italian dhe gjerman si i përshtatshëm për të fituar pavarësinë nga Serbia;
- Heshtje e plotë për dëbimet masive të kolonëve serb dhe malazez;
- Vëmendje e pamjaftueshme Holokaustit me përjashtim të vlerësimit se të gjithë shqiptarët ishin shpëtimtarë të hebrenjve;
- Definimin e dhunës masive të kryer në Drenicë dhe disa qytete të Kosovës, por më dramatikisht në Tivar në fund të Luftës, si gjenocid serb ndaj shqiptarëve.

I kemi pyetur mësimdhënësit se si e ligjërojnë Luftën e Dytë Botërore dhe specifikisht se si i mësojnë këto tema të spikatura më lart. Pasi që u përgjigjen në pyetjet tona, ne i konfrontuam me qëndrimet kundërthënëse të përkrahura nga studimet e njohur të Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi dhe në Kosovë, por edhe me librat aktualë shkollorë.

Rezultati i përgjithshëm i hulumtimit tonë mbi mësimdhënien e historisë së Luftës së Dytë Botërore në shkollat e mesme në gjuhën shqipe të Kosovës së pasluftës, është ky:

1. Pothuaj në të gjitha rastet, mësimdhënësit shprehën pakënaqësi të përgjithshme me librat shkollorë të historisë të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe që përdoren në të gjitha shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë. Ankesat e tyre përqendrohen te sasia e klasëve kushtuar Luftës së Dytë Botërore (shumë të shkurta, shumë pak orë), dhe reduktimit të kësaj ngjarje të madhe historike në data, vende, beteja dhe shifra të të vrarëve. Megjithatë, mungesa e trajtimit më substancial të luftës nuk konsiderohet si lëshim profesional i autorëve, por si produkt i kufizimeve politike.
2. Dyja gjeneratat e mësimdhënësve të historisë – të rinj dhe të moshuar – janë thellësisht dyshues ndaj autoritetit politik dhe ndikimit të tij në mësimdhënien e historisë – pavarësisht a i nënshtrohen apo e kritikojnë – një mosbesim që shtrihet në të gjithë librat e historisë dhe që është pengesë serioze për profesionalizimin e mësimdhënies së historisë.



3. Mësimdhënësit theksuan se i përcjellin në plotësi librat shkollorë gjatë ligjërimeve të tyre në klasë. Pajtoheshin se korniza e përgjithshme ishte pjesërisht e fshehur në trajtimin mbase balancues të Luftës së Dytë Botërore në libra, që i përshtatet narracionit dominues nacional të kombit shqiptar: komb i vogël, vazhdimisht i viktimizuar nga fuqitë perëndimore, sidomos nga Serbia, dhe që lufton për liri, përderisa është i paaftë për t'i bërë keq ndokujt.
4. Edhe atëherë kur sfidohen nga intervistuesit – duke ua shpalosur kundërthëniet në librat shkollorë ose prezantimet e mësimdhënies së tyre me atë çka shkruhet në libra, apo burime historike me autoritet – mësimdhënësit qëndruan pranë narracionit dominues nacional.
5. Zbuluam që mësimdhënësit vinin thekse të ndryshme në tema të veçanta. Por kjo duket se ka të bëjë fillimisht me dallimet rajonale, dhe së dyti me dallimet mes gjeneratave, më shumë se me ndonjë faktor tjetër, që sugjeron ndikimin e rrëfimeve të familjes dhe komunitetit, që ka qenë burimi kryesor i informimit për historinë përgjatë gjeneratave të shqiptarëve të Kosovës.
6. Larg nga të qenit individuale dhe private, rrëfimet që transmetohet oralisht dhe që u barten nxënësve nga mësimdhënësit, përpos nga familjet e tyre, u përkasin narracioneve kolektive dhe i zbulojnë ndasitë politike përbrenda narracionit dominues nacional.

### ***Mësimdhënia sipas librave***

Të gjithë mësimdhënësit shprehën pakënaqësi të përgjithshme me librat shkollorë të historisë, të cilët përqendrohen në fakte dhe shifra dhe i shmangen dëshmimeve të rëndësishme të ngjarjeve dhe proceseve. Dëgjuam shumë komente për gabimet, kundërthëniet, lënien jashtë, thjeshtëzimet, dhe kritikë më gjithëpërfshirëse për thellësinë studimore të librave shkollorë. Kjo e fundit, megjithatë shpejt zbutet nga kuptimi i kufizimeve strukturore: për shembull, nevoja për të botuar libra historie që nuk janë shumë voluminoz, ose përndryshe nxënësit do të frikësohen nga ta, dhe nevoja për të futur shumë material në një numër shumë të vogël të orëve mësimore.

Në fakt, duke marrë parasysh kufizimet brenda të cilave veprojnë – nga minimum një orë në javë deri në maksimum të orë në javë në gjimnaz të shkencave sociale – mësimdhënësit thanë se i përdorin librat shkollorë edhe nëse ju pëlqejnë shumë. Përgjithësisht, krijohet ndjenja që nuk kanë kohë të dalin nga programi.

Për disa, nuk ka absolutisht asnjë alternativë tjetër, “Nxënësit nuk duan të devijojnë nga librat dhe prindërit i përkrahin. Po bëra më shumë, ankohen, duan të lexojnë vetëm atë që është në libër” (Intervista 7). Në observimin tonë në një klasë, vërejtëm se studentëve u ishte kërkuar të lexonin mësimin e ditës dhe pastaj ta recitojnë atë klasës; ata nuk lexonin nga libri, por nga fotokopjet e librit shkollor.

Megjithatë, mësimdhënësit e tjerë thanë që u japin theks tjetër një mori temash dhe i inkurajojnë nxënësit të hulumtojnë më shumë në internet, duke përdorur si avantazh njo-

hurinë e tyre të gjuhës angleze. Librat shkollorë vuajnë, në fakt, nga një deficit i përgjithshëm besimi, ndjenjë që nuk është as e re e as unike për Kosovën e pasluftës. Ky fenomen e ka një histori të gjatë. Ka ndikuar dhe ndikon në shkollimin dhe edukimin në lëndën e historisë.

Çfarë lloj librash?

Përderisa i kritikojnë librat shkollor, mësimdhënësit rrallë ankohen veçmas për autorët. Siç thotë një mësimdhënës (Intervista 7), “Nuk mendoj që e kanë lirinë të shkruajnë çfarë të duan.” Në disa libra lufta në Drenicë dhe vrasja e heroit kombëtar Shaban Polluzha prezantohet me gjuhë pasive, me lënie jashtë të kryesve të vrasjes, të cilët në librat e tjerë prezantohen si “partizanë serbo-malazez.” Ky mësimdhënës na tha se arsyeja për lënien jashtë të identitetit të kryesve të vrasjes është fakti se autorët e kanë pasur për qëllim të “eliminonjë gjuhën e urrejtjes.”

Dy autorët e librave shkollor e pranuan “intervenimin” e UNMIK-ut dhe Bashkimit Evropian, pas luftës, me kërkesën e tyre të ndryshojnë gjuhën e përdorur në përshkrimin e veprimeve të grupeve të tjera nacionale (Intervistat 19 dhe 20). Njëri tha, “Sot, në vend se të themi serbët vranë pesëdhjetë shqiptarë, ne themi policia dhe ushtria serbe vranë pesëdhjetë shqiptarë” (Intervista 20). Tjetri shtoi, “Ngase kjo është e vërteta, populli nuk vret, nuk ka mekanizëm (për popullin) të vras” (Intervista 19) Për shkak të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, tha një mësimdhënës, “nuk ka gjuhë nacionaliste në libra” (Intervista 8).

Është interesant që vetëm një mësimdhënëse tha se merr pjesë në grupet punuese ndërkombëtare të Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën juglindore me bazë në Selanik, e cila, sipas saj, ofron trajnim shumë të mirëpritur (Intervista 1). Por as ajo nuk e përmendi librin e punës të Qendrës për Luftën e Dytë Botërore, që ka për qëllim të shërbejë si burim alternative ndaj historiografive nacionaliste, dhe që është i gatshëm për përdorim online në gjuhën shqipe, si edhe në të gjitha gjuhët e tjera rajonale.<sup>100</sup>

Është me rëndësi të përmendet që dy autorët e librave shkollor me të cilët biseduam shprehën mlllef më shumë për presionin politik të qeverisë turke ndaj qeverisë së Kosovës. Në vitin 2010, Turqia kundërshtoi gjuhën negative që përdorej për t’i përshkruar osmanët, (“hordhitë”) dhe karakterizimit të sundimit osman në Kosovë dhe në Ballkan si okupim i huaj, e jo si “bashkëjetesë” dhe “bashkëqeverisje”, dhe kërkoi ndryshimin e gjuhës – në këtë rast jo për çështje përshtatjeje, por për gjykim historik.<sup>101</sup>

Trysnia politike mund të vijë edhe nga elitat vendore. Gjatë bisedës, një historian na tha se bashkë-autori i tij mori pozitë në Institutin e Historisë për shkak se vinte nga një familje e rëndësishme shqiptare gjatë kohës së Jugosllavisë, andaj ka limit në kritikën ndaj ish elitës jugosllave që librat mund të ofrojnë. Perceptimi se librat e ri shkollor të historisë mund të kenë agjenda politike është shqetësim që e ndajnë pothuaj të gjithë.

100 <http://cdrsee.org/publications/education/workbook-4-second-world-war> (linku i klikuar me 11 nëntor, 2016).

101 Emine Arifi-Bakalli, “Trajtimi i Turqisë Moderne në Tekstet e Historisë të Republikës së Kosovës: Politika dhe Historiografia,” në *Përballje Historiografike* ( Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2015).

Për mësimdhënësit më të vjetër, që kishin kompletuar arsimimin bazik gjatë kohës së Jugosllavisë, mosbesimi në libra kishte filluar kur atyre iu ishte mësuar dhe është dashur ta mësojnë histori jokritike të Luftës së Dytë Botërore si “histori e popullit jugosllav,” me “Betejën e Sutjeskës dhe Betejën e Neretvës si alfa dhe omega e luftës (Intervista 12; Intervista 18 po ashtu përmend dy filmat), dhe të gjitha betejat tjera me “dhjetë partizanë që me guxim luftuan kundër ushtrisë së fuqishme gjermane, sikur nëpër filma” (Intervista 1). Kështu që, “historia e luftës nacional-çlirimtare ishte shkruar në kontekst pozitiv. Forcat që nuk e përfillnin këtë vijë prezantoheshin si reaksionar ose kolaboracionist. Narracioni ishte bardhë e zi” (Intervista 3).

Të gjithë librat shkollor jugosllav të historisë ishin shkruar në gjuhën që atëbotë quhej serbo-kroate, dhe kishin mungesë informacioni për dinamikën e Luftës në Shqipëri dhe Kosovë. Një autor, student i Ali Hadrit, rikujton se si e kishte mbrojtur temën e tij të doktoraturës mbi historinë e Luftës së Dytë Botërore pa mentorin e tij, i cili ishte përjashtuar në spastrimet pas protestave të vitit 1981. Pasi që kishte diplomuar, ky historian ishte përjashtuar nga Lidhja e Komunistëve por nuk ishte përjashtuar nga pozita e tij në Institutin e Historisë. Në vend të kësaj, Lidhja e kishte ngarkuar atë dhe një koleg të shkruanin esenë me titull, “E vërteta e luftës nacional-çlirimtare në Kosovë.” Në kontekstin e shtypjes së nacionalizmit shqiptar menjëherë pas protestave të vitit 1981, eseja duhej të theksonte se të gjithë shqiptarët në Kosovë gjithmonë e kishin urreyer Titon, Jugosllavinë dhe “vëllazërim-bashkimin”; dhe se të gjithë shqiptarët kishin qenë ballistë, kryengritës jo-komunist, pra bashkëpunëtorë të Gjermanisë naziste. Dy historianët nuk e kishin bërë këtë gjë që iu ishte kërkuar, dhe ishin thirrur për t’u qortuar nga “komiteti i ideologjisë” së Lidhjes Komuniste (Intervistë 20).

### ***Mësimdhënia në bazë të asaj që dinë***

Në vitet e 80-ta mësimdhënësit shqiptarë të historisë zhvilluan praktika tjera të mësimdhënies në Kosovë nga frika e hakmarrjes nga autoritetet shtetërore. Ata ose i qëndronin besnik kurrikulës zyrtare pa bërë ndonjë devijim, ose gjenin mënyra indirekte për të dhënë udhëzime që zhvilloheshin paralelisht me ato të gjetura në librat shkollor. Në mesin e mësimdhënësve që i intervistuaam hasëm në dyja praktikatat.

Edhe atëherë kur mendonin që librave ju mungonin pjesë të rëndësishme të historisë, shumë mësimdhënës kurrë nuk devijuan nga programi zyrtar për shkak se frikësoheshin se do ta humbnin punën. “Nuk kishim të drejtë të përdornim libra tjerë përtej atyre zyrtar, ose do të dënoheshim, nuk guxonim të flisnim për historinë kombëtare shqiptare, nuk thoshim asgjë, ngase kishim këshilltarë pedagogjik, inspektorë dhe ata na kontrollonin” (Intervista 18).

Por kishte edhe të tillë që e konsideruan rolin e tyre si detyrë patriotike dhe në ditarin e përditshëm shkruan mësime që duhej t’i ligjëronin sipas planprogramit, ndërkohë që ligjëronin diçka tjetër, “atë që dinim dhe që ishte e vërtetë” (Intervista 16). Meqë historinë e tyre nacionale nuk e gjenin të reflektuar në libra, të cilat i konsideronin krijim të huaj dhe nuk iu besonin, ata i diktuan shënime personale për t’ia shtuar historinë shqiptare historisë së Jugosllavisë. Ata e kishin mësuar historinë shqiptare vet, përmes disa librave që vinin nga Shqipëria dhe librave të Ali Hadrit, edhe pse shpeshherë edhe ato iu dukeshin të njëanshme. Në fakt, nëse në ato që ata i quajnë librat serbo-kroat asnjëherë nuk

i përmendnin luftëtarët jo-komunist shqiptarë kundër gjermanëve dhe italianëve, librat shqip iu përmbajtën të njëjtit narracion komunist të luftës çlirimtare, që e konsideronte çfarëdo devijimi nga linja partiake si tradhti (Intervista 12).<sup>102</sup>

Mësimdhënësit më të vjetër përgjithësisht u ankuan për pengesat në të cilat kanë hasur për t'i përfunduar studimet e tyre, meqë pozita në qarkun akademik, që kishte të bënte me ideologji, i ekspozonte ndaj censurës dhe përndjekjes politike. Të paktën dy mësimdhënës na thanë që ishin tërhequr nga universiteti për shkak se donin t'iu iknin telasheve dhe t'i përkrahnin familjet e tyre. Të tjerët u ankuan se nuk kishin fonde ose mundësinë për të hulumtuar për shkak të mosnjohurisë së gjuhëve të huaja. Profesionalizmi i tyre vuajti nga këto kufizime.

Atë që mësimdhënësit e kanë mësuar për historinë e Luftës së Dytë Botërore e kanë mësuar kryesisht nga tradita orale. "Historia jonë është në terren, jo në dokumentet e armikut sepse ne nuk kishim shtet tonin për t'i shkruar dokumentet" (Intervista 17). "Ne i kishim kullat dhe oda, e aty e tërë historia është mësuar përmes traditës dhe kështu e mbajë mend ta kem mësuar historinë, në mbledhi" (Intervista 5).

Gjenerata më e vjetër e mësimdhënësve theksuan se edhe pse kanë menduar që kishin njohurinë historike të transmetuar në formë dëshmie nga pleqtë në familjet dhe lagjet e tyre, por një gjë të tillë nuk mund të flisnin hapur ngase shkollat ishin të përgjuara, sidomos pas vitit 1981. Të gjithë ishin të frikësuar se po i spiunonin. "Varej se kush ishte profesori, por Lufta e Dytë Botërore është mësuar mes rreshtash, jo ashtu si ishte. Na është dashur të rrimë në vijë për shkak se politika në atë kohë ishte abuzive, por me shokë mësonim mes rreshtash. Për shembull, kur e elaboruam Luftën e Dytë Botërore, e bëmë këtë përmes Bismarckut, sepse siç thotë një fjalë e urtë, 'gjuha shkon aty ku të dhemb dhëmbi'. I referoheshim ndarjes së Gjermanisë si metaforë për të shpjeguar ndarjen e tokave shqiptare që të mos binim pre e politikës serbe të asaj kohe" (Intervista 5).

Për këta mësimdhënës, sistemi paralel i shkollimit në vitet e 90-ta, ishte çlirim, për shkak se tash mund të mësonin çfarë të donin. Nuk kishte më libra jugosllav për të imponuar narracionin, por nuk kishte libra fare, të paktën jo deri në vitin 1994. Andaj, mësimdhënësit i diktuan mësimet, me liri ta pashembullt. "Unë personalisht kam diktuar për *Ballin Kombëtar*, i kam diktuar shënimet për tema që ishin të ndaluara" (Intervista 12).

---

102 I njëjti narracion vazhdoi të ekzistojë edhe pas rënies së komunizmit. Në Historia e Popullit Shqiptar për Shkollën e Mesme, në edicionin e parë të vitit 1994, një koleksion i shkruar nga autorë të paemëruar, rezistenca kundër gjermanëve ende prezentohet si luftë nacional-çlirimtare e dominuar nga komunistët, me një përpjekje të mangët për të njohur kontributin e të tjerëve. Hoxha mbetet figura qendrore dhe mungesa e konsistencës – mes lavdatave për Hoxhën apo demonizimit të tij si dhe të komunizmit – janë më pak të rëndësishme se rikonfirmimi i kozmologjisë kombëtare shqiptare. Këto informata i morëm nga Erind Pajo në "Albanian Schoolbooks in the Context of Societal Transformation: Review Notes," në *The Politics of History Education*, I redaktuar nga Christina Koulouri (The Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe, CDRSEE, 2002), 445-461.

Për gjeneratat më të reja, ata që kanë vijuar shkollën e mesme e ndonjëherë edhe universitetin në vitet e 90-ta, sistemi paralel ishte përvojë tjetër. Ajo çfarë ata mbajnë mend për shkollimin e tyre kryesisht ishte shqetësimi dhe frika. Iu duhej t'i shkruanin diktimet e mësimdhënësve të ulur në dysheme dhe me fletore që i balanconin në prehër. Dhe atyre që jetonin në zonat rurale u shtojte trauma e ecjes me kilometra për të shkuar në një vend që quhej shkollë, që zakonisht ishte një shtëpi private. Me pak fat në anën e tyre, ora mësimore zgjaste 20 minuta, nëse mësimdhënësit arrinin të kalonin nëpër punkte policore pa u ndaluar.

Një mësimdhënës, atëbotë nxënës i shkollës së mesme, na tregoi se policia e kishte ndaluar rrugës për në shkollë (Intervista 4). E kishin maltretuar, e kishin quajtur "irredentist," dhe ia kishin marrë librin të cilin ai sapo e kishte blerë, historinë e shqiptarëve, autori i së cilës nuk i kujtohet tash. Kur ishte kthyer në shtëpi, ai kishte qajtur më shumë për librin e humbur se për abuzimin fizik që e kishte përjetuar në punktin policor. Kujtesa për lëndët shkollore është edhe më e turbullt. Nuk arrinte t'i kujtonte mësimet e Luftës së Dytë Botërore. Atij i kujtohej vetëm 1912 dhe historia e pavarësisë shqiptare "për shkak se ishte historia e popullit shqiptar." Dhe kjo është "mjerueshëm pasoja e sistemit paralel."

Të tjerët theksuan se, "Nuk mbajnë mend asgjë nga Lufta e Dytë Botërore, absolutisht asnjë gjë" (Intervista 7); "Ne vetëm sa mbajtëm fjalën shkollim gjallë" (Intervista 13); dhe "Kishte të bënte me mbijetesën, kuantitetin, jo kualitetin" (Intervista 8). Pastaj, atë çfarë kanë nevojë ta mësojnë në histori e kanë mësuar në *oda*, "ku kemi folur shumë për çështjen kombëtare" (Intervista 3).

Njërit mësimdhënës, i cili ishte shumë i motivuar të mësonte, iu kujtuan 5-6 faqe diktim atëbotë, dhe prezantimi i luftës, që ishte, duke parafrazuar, luftë mes dy blloqeve të fuqive të mëdha, në të cilën shqiptarët u pozicionuan përkrahë 2 roleve, në njërin anë me Gjermaninë me shpresë se do të çliroheshin nga Serbia, dhe një kundër fashizmit si rrezik më i përgjithshëm. (Intervista 2).

Mësimdhënia e historisë është ndikuar gjithashtu nga ideologjitë. Në një rast një mësimdhënës theksoi se varësisht nga qëndrimi ideologjik i mësimdhënësit, ata do favorizonin njërin palë gjatë shpjegimit të Luftës së Dytë Botërore. "Po të ishe i majtë, do i nderoje më shumë partizanët dhe nacional-çlirimtarin, por po të ishte përkrahës i krahut të djathtë, do t'i nderoje më shumë *Ballistët*" (Intervista 3).

### ***Partizanët si "Tjetri" etnik***

Një mësimdhënës tha se ai tenton të demaskoj besimin e përhapur që partizanët ishin ekskluzivisht serbë, që në libra ekziston si rrjedhojë e heshtjes së plotë të pjesëmarrjes së shqiptarëve në lëvizjen partizane, që e pasqyron një besim të popullarizuar mes shqiptarëve të Kosovës, pavarësisht sa kundërthënës dhe të papërshtatshëm, se "partizanët ishin serbosllav" dhe "çetnikë," dhe se ata kryen dhunë të jashtëzakonshme ndaj shqiptarëve. "Nxënësit e kuptojnë që *Ballistët ishin shqiptarë*, dhe partizanët nuk ishin shqiptarë, por unë e shpjegoj që kjo ishte çështje ideologjike, që partizanët kishin nocion tjetër të politikës" (Intervista 13).

Por për shumë mësimdhënës të tjerë, tema e partizanëve ende nuk është e hapur për diskutim. “Lufta dhe partizanët janë ende tabu dhe kjo është arsyeja pse gjeneratat e vitit 1999 dhe 2000 nuk e kuptojnë” (Intervista 3). Gjatë hulumtimit tonë gjetëm të paktën konfirmim anedotik të këtij pohimi kur e vizituam klasën e 12 në gjimnazin Sami Frashëri në Prishtinë, ku asnjë nxënës nuk ishte në gjendje të përgjigjet në pyetjen e thjeshtë se “Kush ishin partizanët?” derisa njëri, që po kërkonte përgjigje, gabimisht i përmendi banditët që operonin në Kosovës mes dy Luftërave Botërore.<sup>103</sup>

Perceptimi për partizanët si “tjetri” armik etnik mbetet në sipërfaqe si besim mitik edhe atëherë kur provat flasin ndryshe. Komandanti i ushtrisë çlirimtare anti-fashiste në Kosovë, Fadil Hoxha, ishte shqiptar, i cili pas luftës mbajti pozita të rëndësishme në establishmentin komunist jugosllav, fillimisht në vend e pastaj në shtet. Është e qartë që kishte edhe komunistë shqiptarë në mesin e partizanëve, por shumica e mësimdhënësve nuk ndalen te ky fakt. Kur ndalojnë, duhet të shpjegojnë se si është e mundur që ndonjë shqiptar t’i bashkëngjitet ushtrisë që e çoi Kosovën drejt aneksimit në Jugosllavi.

Një mësimdhënës tha se ju sqaron nxënësve marrëdhënien mes shqiptarëve dhe partizanëve në Kosovë përmes rrëfimit të ndikimit të Enver Hoxhës dhe fushatës që udhëheqësit si Fadil Hoxha dhe Xhavit Nimani e kishin bërë për t’i rekrutuar shqiptarët në aradhet partizane që ishin kryesisht sebo-malazeze. Kur këta të fundit u munduan ta bindnin hoxhën e Rezallës, “se sot Serbia nuk është Serbia e Mbretit, është Serbi tjetër në vijë me ideologjinë komuniste të zhvillimit dhe prosperitetit, hoxha thjeshtë iu tha, ‘qepa e vjetër dhe qepa e re mbajnë erë të njejtë, janë qepë” (Intervista 11).

### ***A e kanë mbajtur partizanët plisin?***

Të gjithë mësimdhënësit ia atribuojnë dhunën partizane për të shtypur kryengritjen në Drenicë në fund të vitit 1944, kur partizanët vendor refuzuan të shkojnë në frontin verior për të qëndruar prapa në mbrojtje të shtëpive të tyre nga sulmet e çetnikëve. Megjithatë, mësimdhënësit i kanë ligjëruar dhe i ligjërojnë këto ngjarje në mënyra të ndryshme.

Para luftës, kur udhëheqësi i Drenicës Shaban Polluzha ishte prezantuar si armik i popullit, mësimdhënësit i trajtonin ligjëratat për kryengritjen e tij në planprogram me shtirje. “Do ta shkruaja se i kishim mbajtur këto ligjërata, por nuk i kam elaboruar para studentëve. Ose do t’iu jepja kahje tjetër ose nuk do të flisja fare për to” (Intervista 17). “Do ta thoje të kundërtën, që ai nuk ishte armik, por patriot.” “Na është mësuar që ‘me forca të mëdha Fadil Hoxha dhe ushtria komuniste e udhëhequr nga Moša Pijade, pastaj Ramiz Sadiku çsic], punuan shumë dhe arritën t’i zbrapsin hordhitë shqiptare derisa ato ishin zhdukur plotësisht,’ por unë e ligjeroja ndryshe këtë pjesë para nxënësve të mi... që Shaban Polluzha ishte një plak, por një njeri i madh... i përkrahur edhe në Rugovë dhe në të gjitha pjesët tjera të Kosovës” (Intervista 15).

Sipas mësimdhënësve, vetëm pas vitit 1990 ata kanë filluar të flasin për luftën në Drenicë, “ashtu siç kishte qenë” (Intervista 11). “Shqiptarët ishin të palumtur Albanians për shkak se ishin dëshmitarë të gjenocidit, i panë njerëzit teksa vriteshin natën dhe hidheshin në lumenj dhe gjëra të tjera që është vështirë të kuptohen. Kishte shumë hidhërim të mbyllur nën dry, Shaban Polluzha nuk kishte zgjidhje, pos të reagojë ashtu siç bëri.”

---

103 Sami Frashëri Gymnasium, observim në klasë 16 maj, 2016.



Megjithatë, rrëfimi i Shaban Polluzhës aktualisht përmendet shumë shkurt në shumicën e librave, dhe mezi përmendet nga disa mësimdhënës në klasat e tyre. Mbase rrëfimi është paksa i komplikuar, sqaroi një mësimdhënës (Intervista 2). Nënkupton se duhet shpjeguar që Polluzha kishte luftuar në anën e partizanëve, dhe vetëm atëherë kur e pa që serbët po e rrezikonin rajonin e tij u nda nga partizanët jugosllav. Por në këtë dyndje të plotë të fateve historike, të pranosh që Polluzha ishte partizan është anatëmë bashkëkohore. “Në vend të kësaj sot atij i mvishet vetëm konotacioni nationalist dhe askush nuk flet për këtë shkëputje në librat shkollor, vetëm në librat universitar.”

I njëjti mësimdhënës tha se u tregon nxënësve të tij për kryengritjen e Polluzhës “ashtu siç është,” ndonëse shkurt, dhe se si pas luftës komunistët kishin ardhur në pushtet dhe “njerëzit që kishin bashkëpunuar me Polluzhën dhe vet Shaban Polluzha ishin etiketuar (si armiq)”. Historia shkruhet nga fituesit, tha ai, dhe për këtë arsye për pesëdhjetë vite Polluzha asnjëherë nuk është përmendur në klasë. “Intelektualët e Gjakovës ishin elita politike dhe ata ndërtuan historinë, një histori politike dhe e mbajtën Shaban Polluzhën të fshehur por tani plejada politike ka ndryshuar; fatmirësisht mund ta mësojmë historinë sërish (Intervista 4).

Qartazi është më sigurt për mësimdhënësit që të lidhin rishfaqjen e emrit të Polluzhës pas luftës me një varg heronjsh kombëtar shqiptar prej Skënderbeut e tutje, sesa me një episod specifik të dhunës së lokalizuar partizane (Intervista 7). Vetëm edhe një mësimdhënës tjetër e përmendi që e dinë dhe që e shpjegon në klasë faktin që Shaban Polluzha ka qenë partizan deri në momentin kur u prish me Fadil Hoxhën, komandantin e ushtrisë çlirimtare anti-fashiste, “për shkak të masakrave që po ndodhnin” në Drenicë (Intervista 16).

### ***Vrasjet masive në Tivar***

Vrasja masive në Tivar më 1945, kur lufta në Kosovë tashmë kishte përfunduar, është çështja e madhe e pathënë. Të gjithë mësimdhënësit thanë se nuk ligjërojnë për ngjarjen e Tivari, sepse nuk ka burime e as studim akademik mbi të. Por shumica e tyre dinë për të, duke qenë të vetëdijshëm për numrin e vogël të literaturës mbi këtë ngjarje, dhe kanë folur për këtë çështje me familjarë apo fqinj të cilët i kanë mbijetuar masakrës.

Për shkak se ngjarja është censuruar në librat jugosllav të historisë, shumë mësimdhënës thanë se nuk kanë ditur gjë për të deri në fillim të viteve të 1990-ta. “Kemi ditur për të vetëm privatisht, nga dikush në shkollë ose në shtëpi por askush nuk ka pasur guxim ta përmend. Mund të flisnim për këtë gjë vetëm në familje, por me babain tim ose ndonjë dajë, jo para mysafirëve ose fqinjëve” (Intervista 11). Kishte variante të ndryshme që qarullonin mes atyre që e tregonin këtë rrëfim në atë kohë. Si mësimdhënës rikujtoi që “numrat ishin të ekzagjeruar nga 7,000 deri 11,000 të vrarë, por ne filluam të flasim publikisht për të vetëm pas fillimit të viteve të 90-ta, dhe nuk ishin historianët që e filluan këtë temë, por publicistët” (Intervista 3).

Njëri mësimdhënës na tregoi për kureshtjen e tij për këtë ngjarje në fund të viteve të 70-ta, pasi që kishte lexuar diçka në librin me titullin 41, sepse bëhej fjalë për 41 autorë. Ai e kishte përfshirë Tivarin në temën e tij të diplomës, por kur e prezantoi temën para

profesorit, atij iu tha ta hiqte atë pjesë, sepse kishte shumë frikë për pasojat e mundshme (Intervista 9).

Kur tregimi për masakrën u shtua në kurrikulë, pas segregacionit të shkollave, ishte kryesisht i bazuar në dy burime: burimi i parë ishte libri i historisë për shkollë të mesme që u përgatit dhe u botua në fillim të viteve të 90-ta,<sup>104</sup> dhe burimi i dytë ishin dëshmitë e të mbijetuarve e gojëdhëna për ngjarjen. Secili kishte dëgjuar diçka nga dikush tjetër. “Nuk ka pasur literaturë për çështje të këtilla, sidomos për Tivarin, gjë që është shumë keq dhe që nuk është trajtuar mirë për shkak se ka shumë viktime të Tivarit. Kushëriri im është njëri nga të mbijetuarit dhe ai më ka thënë që e ka parë detin në Tivar të bëhet I kuq dhe ata plisat e bardhë të shqiptarëve... ai është liruar dhe ka shpëtuar” (Intervista 1). “E njoh një të mbijetuar, një fqj, ka vdekur para 4-5 viteve” (Intervista 2).

Për njërin mësimdhënës, rrëfimi është jashtëzakonisht personal. Ai ka dëgjuar nga gjyshi i tij se si stërgjyshi i është vrarë në Tivar dhe si shteti është munduar të shlyejë gjurmët e masakrës dhe të stërgjyshit të tij duke ia dorëzuar familjes certifikatën e vdekjes që nuk jepte as shkakun e as vendin e vdekjes. I njëjti mësimdhënës ndërton një teori më të përgjithshme të kësaj ngjarjeje duke u bazuar në këtë rrëfim traumatik të familjes: “Në tetëdhjetë për qind të rasteve i kanë marrë meshkujt që ishin vetëm një fëmijë, që ishin pa vëlla... për t’ua shkatërruar çdo gjurmë” (Intervista 10).

Sidoqoftë, ekziston një hezitim i fuqishëm dhe konsistent rreth mësimin për ngjarjet e Tivarit. Një mësimdhënës na tha se si ai aludon po qenë specifik. “U kam thënë nxënësve se është rruga shtatë metërshe ishte mbushur me plisa, dhe më vonë ata e kishin kuptuar se çfarë ju ka thënë arsimtari, por nuk kam thënë, “Tivari ishte mbushur gjak, ky e ka bërë këtë, ka ndodhur kështu” (Intervista 12).

Ky hezitim vazhdon në veçanti në vazhden e politizimeve të fundit të ngjarjeve në Tivar, pas rënies së komunizmit në Shqipëri. Çështja kyçe është përpjekja për t’i dhënë theks të ri masakrës si komplot të supozuar të Enver Hoxhës dhe Titos në ekzekutimin e pesë mijë shqiptarëve në Tivar dhe një mijë të tjerëve që ikën nga Kosova në Shqipëri pas luftës.<sup>105</sup> Në vitin 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e krijoi Komisionin Hetues për t’i hetuar këto ngjarje, zhvillim ky që u shikua me plot interesim në Kosovë. Rezultati i Komisionit ishte një publikim që thekson përgjegjësinë e dy udhëheqësve komunist për masakrën.<sup>106</sup>

Në Kosovë, preokupimi me vendosjen e përgjegjësisë se kush e kishte urdhëruar vrasjen është po ashtu i zakonshëm, dhe ndodhë që është edhe arsyeja pse mësimdhënësit nuk flasin shumë në klasë për ngjarjet në Tivar. “Dilema është se kush e inicioi masakrën, nëse ka pasur marrëveshje me Partinë Komuniste të Shqipërisë apo jo” (Intervista. 6). “Nuk befasonem që ka ndodhur, kushdo që ka menduar ndryshe ishte “armiku.” Përgjegjësia është e Enver Hoxhës dhe Fadil Hoxhës, ata i kanë fshehur dokumentet, burimet...” (Intervista 2).

104 Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, 335.

105 Elsidë Luku, “Albanian-Yugoslav Relations (1945-1948) and their Presentation in School History Textbooks,” Punim i prezantuar në Georg Eckert Institute, The Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians and the Institute for National History Conference on *Historiography dhe History Education in the South-Slavic and Albanian Speaking Regions*, Shkup, 3-4 qershor, 2015, 42-43, duke cituar nga Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi, *Historia e Popullit shqiptar* 12 (Tirana: Uegen 2009), 300-301.

106 Për këtë shih Butkën, *Masakra e Tivarit*.

## ***Fadil Hoxha dhe Gjakova***

Diskutimi konfuz mbi pjesëmarrjen e shqiptarëve në lëvizjen partizane e mbërrin kulmin kur përmendet emri i Fadil Hoxhës. Ndonëse qeveria e Kosovës e ka nderuar kur vdiq më 2001 me varrim shtetëror dhe nderime ushtarake, figura e Fadil Hoxhës ende është kontroverze. Ka grupe që e përkrahin rolin e tij në luftën partizane, dhe më vonë në nomenklaturën jugosllave, dhe grupe që e mohojnë kujtimin pozitiv të Hoxhës. Gjykohet pjesëmarrja e shqiptarëve në establishmentin politik të Jugosllavisë së pasluftës.

Mësimdhënësit e historisë thanë se ata përgjithësisht i ndjekin librat shkollor, ku Hoxha prezantohet si komandant heroik i lëvizjes antifashiste dhe kampion i shqiptarëve në Jugosllavinë socialiste. Megjithatë, ata nuk e përmendin rolin e tij në shtypjen e aradheve të Shaban Polluzhës në Drenicë në dimrin e vitit 1945 dhe në episodet tjera të dhunës, të cilat janë shumë të freskëta në kontekstin e kujtimit të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë.

Një mësimdhënës tha se Fadil Hoxha ishte vetëm komandant i partizanëve shqiptarë (Intervista 3). Një tjetër e mëson klasën se Fadil Hoxha i kishte “hapur shkollat dhe universitetin,” dhe luajti rol të rëndësishëm në zhvillimin politik të Kosovës si pjesë të Jugosllavisë (Intervista 6). Por pothuaj të gjithë hezitojnë të flasin për rolin e tij në luftë. Njëri nga të intervistuarit tha, “A e din që Fadil Hoxha dhe shumë politikanë të asaj kohe ende i kanë gjallë anëtarët e familjeve të tyre?” duke nënkuptuar që askush nuk duhet të flasë keq për njeriun, pavarësisht se cila ishte përgjegjësia politike për dhunën e partizanëve në Kosovë (Intervista 16).

Të paktën njëri nga mësimdhënësit i thotë klasës që “në anën e djathtë, *Ballistët* kishin për qëllim t’i çlironin dhe t’i bashkojnë të gjitha tokat shqiptare, dhe Fadil Hoxha dhe klika e tij komuniste në të majtë u munduan t’i përmyllin çështjet e Luftës së Dytë Botërore dhe t’i përcaktojnë kufijtë, gjë që nuk kishte fuqi ta bënte” (Intervista 9).

Në Gjakovë gjykimi historik për figurën e tij politike është krejtësisht pozitiv. Një mësimdhënës u kishte dhënë detyrë nxënësve të vet që të shkruajnë punim për Fadil Hoxhën. Këtë detyrë ua dha në kontekst të një polemike të nxehtë në vitin 2010 rreth dedikimit të një monumenti për Hoxhën. Shumica e punimeve ishin pozitive. “Ishin të ndikuar nga familjet dhe ambienti, si dhe interneti. Kur adoptojmë qasjen e argumentuar me fakte për çështje si arsimimi, punësimi, zhvillimi i kulturës, fakti që ai ishte komandant gjatë kohës së luftës, gjatë autonomisë së 1974, natyrisht që opinioni është pozitiv” (Intervista 8).

Ky mund të mos jetë opinioni në Drenicë, ku nuk ishte bërë asnjë investim gjatë Jugosllavisë, “përderisa nëse Gjakova kishte 37,000 njerëz të punësuar në fabrika, kjo ishte për shkak të Fadil Hoxhës” (Intervista 8). Kur pyetëm se pse nuk ishte investuar në Drenicë mësimdhënësi i njëjtë tha, “po të më jepej rasti të ndërtoj një rrugë, natyrisht se do ta ndërtoja në fshatin tim, jo tëndin.”

## ***Holokausti në Kosovë dhe Shqipëri***

Në përputhje me librat shkollor, të gjithë mësime të mësimdhënësit thanë se e mësojnë Holokaustin si pasojë të luftës, me përjashtim të njërit që tha se Holokausti e prezanton si qëllim të luftës naziste. Ai ishte po ashtu i vetmi që i përmendi burgjet në Shqipëri dhe Prishtinë, “ende mund ta shohësh murin e vjetër të burgut në Ulpianë” (Intervista 4).

Të gjithë mësime të mësimdhënësit thanë se e theksojnë pafajësinë e shqiptarëve në kontekst të Holokaustit, dhe në fakt thanë se u thonë nxënësve se mund të bëhet një paralele mes shqiptarëve dhe hebrenjve. Sikur hebrenjtë, shqiptarët janë konstruktuar si “armiku” nga serbët dhe janë vënë në shënjestër për shfarosje. (Intervista 2). Sikur hebrenjtë, shqiptarët ishin persekutuar dhe prandaj i kanë mbrojtur hebrenjtë, për shkak të humanitetit të tyre (Intervista 4).

Njëri mësime të mësimdhënës e përdorë Holokaustin për të bërë krahasim mes dy kombeve gjenocidale. “U them nxënësve, mos besoni çfarë lexoni në rrjete sociale ose çfarë shihni në dokumente, shtete sllave kanë bërë edhe më zi” (Intervista 5).

## ***Bashkëpunimi dhe simpatizimi i Gjermanisë/Italisë***

Të gjithë mësime të mësimdhënësit ndjekin narracionin dominues që okupimet italiane dhe gjermane të Kosovës ishin një lloj çlirimi nga Mbretëria e Jugosllavisë. Okupatorët sollën shkolla dhe kulturë për herë të parë në Shqipëri. Andaj, bashkëpunimi me okupatorët nuk shihet si problematik.

Mësime të mësimdhënësit nuk i identifikojnë bashkëpunëtorë e njohur të okupatorëve gjerman dhe italian si “tradhtarë” siç kishin bërë të gjithë librat shkollor serbisht dhe shqip, para luftës. “Këta libra duhet të mbahen larg nxënësve,” tha njëri (Intervista 2). Historianët e Hoxhës mbase do ta kishin quajtur Mehdi Frashëri dhe Rexhep Mitrovica tradhtarë të Gjermanisë, “por kjo ishte logjika e asaj kohe, shqiptarët nuk mund t’i kundërshtonin gjermanët dhe edhe nëse nuk mund t’i quajmë patriotë nga prizmi i sotëm nuk mund t’i quajmë as tradhtarë. Me të njëjtën masë, shqiptarët që morën pjesë në qeverinë tranzitore pas vitit 1999 janë tradhtarë sepse ata u ndikuan nga gjermanët, amerikanët, etj.” Askush nuk duhet harruar, u thonë nxënësve, se “shqiptarët i kanë pasur dy armiq, një të vjetër dhe një të ri” (Intervista 13).

Sindroma i shtetit të vogël të pafajshëm sugjerohet nga mësime të mësimdhënësi, i cili e shpjegon kështu aleancën e shqiptarëve me Italinë në Shqipëri dhe Kosovë: “I pyes nxënësit, a ka qenë në rregull që Zogu ka bashkëpunuar me Italinë?... në atë kohë, mos harroni, nuk mund të bëheshim me Greqinë, nuk mund të bëheshim me Serbinë ose Maqedoninë, me këta, me ata, çfarë do të kishit bërë ju? (Nxënësi) thotë, po profesor, do të bëheshim me Italinë” (Intervista 12).

Njëri mësime të mësimdhënës tha se për shkak që shqiptarët ju pëlqenin italianëve, të moshuarit e kujtojnë okupimin me dashuri, ata nuk kanë kujtime të këqija prej tyre apo prej gjermanëve, “por unë po flas për popullatën, jo për atë çfarë shkruhet në libra... dhe po e them këtë vetëm pas viteve të 90-ta” (Intervista 11).

Nuk arritëm të hyjmë në diskutim me asnjëri mësimdhënës për vlerësimin e fashizmit apo nazizmit më vete, ndaras nga roli i tyre në unifikimin e Shqipërisë dhe Kosovës. Dy autorët e librave shkollorë që i intervistua në fakt e konfirmuan simpatinë e thellë që ende mbretëron në mesin e të moshuarve për dy udhëheqësit Mussolinin dhe Hitlerin: “I quanin Daja Musë, Daja Hetë” (Intervista 19).

Nga të paktën tre mësimdhënës dëgjuam për fascinimin që figura e Hitlerit ushtron në nxënës, të cilët e përdorin internetin për të thelluar njohuritë e tyre për atë figurë historike, përfshirë gjurmimin e teorive të çuditshme konspirative për mbijetesën e tij në Amerikën Latine pas luftës.

### ***Dëbimin e kujt?***

Është fakt historik i etabluar se mes dy luftërave, përmes reformës agrare Mbretëria Jugosllave u kishte ndarë tokë kolonëve serb dhe malazez, duke ua marrë atë nga pronësia pronarëve shqiptarë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas kolapsit të Mbretërisë së Jugosllavisë dhe okupimit italian të Kosovës, kolonët serbë dhe malazezë ishin dëbuar në masë. Të pyetur se si e ligjërojnë këtë ngjarje, gati të gjithë, mësimdhënësit e keqkuptuan pyetjen dhe u përgjigjën duke cituar dëbimin e shqiptarëve në periudhën mes dy luftërave. Duke iu falënderuar Luftës së Dytë Botërore, sipas argumentit të popullarizuar, dëbimi i shqiptarëve në Turqi u ndërpre.

Një mësimdhënës u përgjigj se ligjëron se si propaganda serbe e shfrytëzoi ikjen e serbëve nga Kosova në vitin 1999 por edhe në vitin 1689-90 dhe tërheqjen e trupave të tyre më 1915 për të shpërndarë dyshime rreth dominimit demografik të shqiptarëve. Vetëm pas insistimit tonë dhe citimit të burimeve të huaja për dëbimet e vitit 1941-44, ai e pranoi se ka lexuar për to (më herët tha që nuk kishte burime), dhe tha se burimet serbe kishin ekzagjeruar, “nuk ishin dyzetmijë apo pesëdhjetë mijë refugjatë, mbase kishte dëbime, por jo aq shumë” (Intervista 2). Me fjalë tjera, “nëse kishte dëbime, ato nuk ishin të organizuara” (Intervista 13).

Një mësimdhënës tjetër tha, “kur bisedoj me nxënësit e mi, kolonët serbë erdhën dhe okupuan tokën tonë dhe e morën tokën më të mirë, në atë kohë kjo kërkonte gjak... por ne nuk e trajtojmë çështjen kështu... ne e trajtojmë në bazë të librave shkollorë” (Intervista 12). Njëri mësimdhënës që i kishte mësuar nxënësit për dëbimet e kolonëve të cilët kishin ardhur në Kosovë mes dy luftërave, tha se gjatë ligjeratave shton që shqiptarët i kishin mbrojtur të njëjtit kolonë nga dhuna (Intervista 16). “Shqiptari i mirë” që i përmbahet traditës së besës dhe i mbron të gjithë ata që kanë nevojë, përfshirë armiqtë serb, del në pah edhe në diskutimet me një mësimdhënës tjetër (Intervista 14).

## KAPITULLI 6: PËRMBYLLJE

Zhvilluam intervista të thellësishme me një grup mësimdhënësish të historisë serbë dhe shqiptarë në Kosovë për të kuptuar më mirë se si mësohet historia e Luftës së Dytë Botërore në shkollat e mesme publike në vend. Meqë studimi dhe debati për librat shkollor zyrtar ka gjetur mbizotërim të narracioneve zyrtare nacionaliste dhe reciprokisht në botimet e secilit grup nacional, jemi nisur të zbulojmë nëse mësimdhënësit i përdorin dhe i ndjekin udhëzimet e atyre librave. Dëshëm të testojmë besnikërinë e tyre ndaj narracioneve zyrtare duke parë se si ballafaqohen me sfidimin e atyre narracioneve.

Gjetjet tona bazohen në metoda kualitative të hulumtimit përmes intervistave të thella dhe shqyrtimit të veprave të shkruara. Mostra jonë përbëhet nga 25 intervista të strukturuar me mësimdhënësit e historisë së shkollave të mesme. Intervistat janë gjysmë të strukturuar, me një listë pyetjesh të hapura. Për ta zgjedhur mostrën e rastit kemi intervistuar mësimdhënës nga të gjitha zonat e Kosovës, që kanë përvoja të ndryshme dhe të veçanta me Luftën e Dytë Botërore, për t'i kapur dallimet dhe ngjashmëritë nëpër klasë të ndryshme në tërë Kosovën. Para intervistave, ne shqyrtuam se si librat shkollor të historisë të aprovuar nga Ministria e Arsimit e Kosovës dhe Serbisë prezantojnë luftën.

Zbuluam një realitet që nuk është përshtatet lehtë me kategorizimet ekzistuese.

Për fillim, mësimdhënësit nga dyja grupet janë “kujdestarë” të narracioneve të tyre nacionale, por asnjëri nga këto dy grupe nuk janë homogjen nga brenda, meqë Lufta e Dytë Botërore është shënjuese e fuqishëm i lindjes së Jugosllavisë Socialiste dhe si e tillë ngjallë ndjenja dhe qëndrime politike kundërthënëse.

Së dyti, mësimdhënësit nga të dyja grupet nuk u besojnë autoriteteve institucionale – qeverive të huaja, organizatave ndërkombëtare, ministrive të tyre – për instrumentet e tyre të mësimdhënies dhe praktikat. Por ata janë edhe konformistë, dhe kryesisht u përshtaten direktivave administrative siç janë kurrikulat dhe programet, përderisa ato nuk kundërshtojnë bindjet e tyre të thella që i kanë rrënjët në rrëfimet personale dhe të përbashkëta për Luftën.

### ***“Kujdestarë” të narracioneve të tyre nacionale***

Roli i mësimdhënësve serb si kujdestarë të narracionit nacional bazohet në materialin e tyre të tanishëm dhe kushtet politike. Jeta dhe puna e tyre zhvillohen në rrethana shumë të vështira, apo qoftë edhe nën okupim, siç thekson njëri nga ata. Punojnë në shkolla që janë të emëruara sipas institucioneve arsimore serbe të cilat më nuk ekzistojnë në vendin ku ishin dikur. Varen nga Beogradi për udhëzim administrative, dhe e mësojnë historinë e Luftës së Dytë Botërore në të cilën Kosova përbënë një pjesë të vogël, meqë tragjeditë e mëdha dhe lavdet e popullit serb ndodhën gjetiu.

Ata kryesisht e shpjegojnë historinë e Luftës së Dytë Botërore që është kristalizuar në librat shkollor zyrtar serb që nga fundi i viteve të 90-ta, në të cilat ekziston një përpjekje për të balancuar narracionin ideologjik jugosllav të luftës së mirë, shumëkombëshe par-



tizane me rehabilitimin e lëvizjes *četnike*, që ishte kundër okupimit të huaj dhe kundër partizanëve, e që ndonjëherë bashkëpunonte me nazistët. Në këtë rrëfim, serbët luftuan në anën e drejtë kundër fashizmit dhe nazizmit, ndërkohë që pothuaj të gjitha kombet tjera në Jugosllavi luftuan në anën e gabuar dhe i viktimizuan serbët; të gjithë shqiptarët në Kosovë janë fajtorë, bashkëpunues të armiqve fashist, për spastrimin e Kosovës nga serbët dhe për grabitjen e saj nga Serbia.

Mësimdhënësit shqiptarë të historisë jetojnë në kushte të tjera, si qytetarë të Republikës së Kosovës, por edhe ata janë kujdestarë të narracionit të tyre nacional. Disa ndihen që duhet të reagojnë ndaj lobimit të të huajve për të ndryshuar shkuarjen e historisë për qëllime politike, qoftë për vullnetin e Turqisë për të imponuar imazhin e Perandorisë së parrezikshme Osmane, apo presionin e organizatave ndërkombëtare për ta rishkruar historinë me qëllim të uljes së tensioneve etnike. Të tjerët janë bërë kujdestar të narracionit të tyre nacional nën Jugosllavi, kur ishin shtyrë të komformoheshin, apo mësuan se sit ë bëhen kritikë nëntokësor të historisë jugosllave; në dekadën para luftës së fundit, ata mësuan dhe shkuan nëpër shkolla shtëpi ku mësuan dhe e ligjëruan rezistencën kombëtare më shumë se historinë.

Narracioni nacional shqiptar i Luftës së Dytë Botërore, i ribotuar në librat zyrtar shkollor, është plotësisht i bazuar në idetë që shteti shqiptar, vazhdimisht i tradhtuar nga shtete më të fuqishme dhe fqinj keqdashës, është detyruar të bashkëpunojë me Italinë fashiste dhe Gjermaninë naziste për ta çliruar veten nga Serbia; dhe që gjithmonë është luftëtar për liri dhe pavarësi, i paaftë për t'i bërë keq ndonjë shteti tjetër, përfshirë armikut kryesor Serbisë. Në këtë rrëfim, partizanët shqiptarë dhe nacionalistët shqiptarë që e kanë luftuar njëri-tjetrin, si dhe bashkëpunëtorët shqiptarë, janë të gjithë heronj të barabartë.

### ***Kontestimet përbrenda narracioneve nacionale***

Megjithatë, mësimdhënësit nga dyja grupet na thanë se në klasat e tyre ata i theksojnë ngjarjet e ndryshme të Luftës dhe ofrojnë interpretime të ndryshme të ngjarjeve të tilla, në bazë të asaj se çfarë mësojnë jashtë teksteve shkollore. Ata iu tregojnë studentëve se çfarë dinë nga përvoja e tyre personale dhe e përbashkët, dhe rrëfimet që i kanë dëgjuar nga familjet e tyre. Por këto rrëfime nuk janë thjeshtë private apo anekdotike, për shkak se ato lidhen me korniza më të gjëra ideologjike dhe politike, që shprehin ndasitë dhe fragmentimin përbrenda narracioneve të tyre nacionale, dhe preokupimin e thellë me të tashmen.

Për shembull, mësimdhënësit serb na thanë që në klasë e kumtojnë qartazi se a janë me partizanët apo četnikët. Të dyja grupet prezantohen si anti-fashiste, në “anën e mirë” të historisë. Pozicionimi i këtyre mësimdhënësve individual mund t'i ketë rrënjët në përvojën familjare, por është gjithashtu reflektim i fragmentimit të vet narracionit nacional. Mësimdhënësit të cilët i prezantojnë partizanët pozitivisht ndajnë vështrim pozitiv për Jugosllavinë socialiste, dhe mbase edhe ndiejnë nostalgji për të, përfshirë kredon e saj të bashkëjetesës etnike. Por ata që me krenari e mbështesin identitetin *četnik* si trashëgimi familjare ndajnë me nxënësit më shumë se rrëfimin e tyre personal; ata kanë qëndrim më kritik ndaj Jugosllavisë, si shtet që ka dobësuar Serbinë.

Këto qasje të ndryshme pasqyrojnë debate më të gjëra. Nocioni i lëvizjes *četnike* si luftëtarë në “anën e drejtë” të luftës kundër fashizmit dhe nazizmit filloi me rehabilitimin

e tyre ligjor pas shpërbërjes së Jugosllavisë, por si fakt historik është i kontestuar në qarqet akademike dhe debatet publike. Vet emri *četnik* është shumë i ngarkuar politikisht: gjatë luftërave të viteve të 90-ta është përdorur shumë në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe nga shqiptarët në Kosovë për t'i etiketuar kryesit serb të krimeve të luftës, por në të shumtën e rasteve ata serbë që i kishin kryer krimet më famëkeqe e përshkruanin veten si *četnik*. Ndarja *četnik*-partizan në mesin e serbëve nuk ka të bëjë vetëm me memorien e historinë; ajo zbulon përkatësitë politike apo mendimet për Jugosllavinë socialiste si dhe luftërat e viteve të 90-ta. Andaj, është edhe çështje politike me pasoja praktike, sidomos në relacionet mes Serbisë dhe shteteve fqinje. Marrë në përgjithësi, këto ndasi vinë në shprehje, ata që janë pro-*četnik* janë të prirë të jenë më nacionalist dhe konservativ, derisa pro-partizanët dhe pro-jugosllavët mund të konsiderohen më liberal e socialist, ndonëse ne argumentojmë që këto ndasi kërkojnë një diskutim më të thellë që mbase është i domosdoshëm nëse vazhdojmë ta trajtojmë më tutje këtë temë.

Gjetëm që ajo çfarë mësimdhënësit shqiptarë e ligjërojnë ndikohet nga konteksti i tyre rajonal. Kosova përbëhet nga komunitete të vogla, dhe përvoja e dhunshme e Luftës së Dytë Botërore ka lënë shenja të thella në ta, sidomos në ato pjesë ku lufta vazhdoi pas çlirimit nga gjermanët – qoftë për shkak të qërimit të hesapeve ndëretnike, apo luftës së partizanëve për kontroll të plotë të territorit, që ishte po ashtu një luftë civile. Këto dallime rajonale, të cilat u theksuan pas Luftës dhe për shkak të Luftës, vazhdojnë të jenë të pranishme edhe sot në një Kosovë që ka ndryshuar plotësisht. Rajonet janë strehë të elitave të ndryshme politike, qoftë si ish partizanë që kishin udhëhequr Kosovën nën Jugosllavi, ose kur si pasardhës të atyre që janë mundur nga partizanët e qeverisin Kosovën bashkëkohore.

Mësimdhënësit i theksojnë dhe i justifikojnë, brenda klasës së tyre, ngjarjet dhe figurat e lëvizjes partizane, apo episodet e dhunës partizane ndaj shqiptarëve varësisht nga përvoja e familjeve dhe komuniteteve të tyre. Por pikëpamja e tyre nuk është vetëm personale, ajo ka konotacion politik. E sugjeron një kontestim të pjesëmarrjes në luftën anti-fashiste, që çoi drejt çlirimit nga fashizmi dhe nazizmi dhe ktheu Serbinë në Kosovë.

Kemi gjetur që mësimdhënësit nga dy grupet janë të zënë në mes rolit të tyre të përgjithshëm si kujdestarë të narracionit nacional të Luftës së Dytë Botërore dhe pjesëmarrjes së tyre aktive në kontestimin politik të narracioneve të njëjta historike. Ata duket se gjeneratave të reja po ua komunikojnë pikërisht një miks të pranimit të rrëfimeve të përgjithshme dhe kritikave specifike që janë të rrënjësura në përvojat personale, të përbashkëta dhe politike. Por këto forma të ndryshme komunikimi, që lidhin përvojat personale, rrëfimin e anekdotave apo përdorimin e metaforave, me auto-censurë, fshehin qëndrime politike.

### ***Problem i izolimit dhe besimit***

Ajo që është e qartë nga bisedat që i kishim me të gjithë mësimdhënësit është që veprat akademike shqiptare dhe serbe për historinë e Luftës së Dytë Botërore janë të izoluar, ende shumë ideologjike, dhe nuk e marrin parasysh diturinë më të gjerë ndërkombëtare të kësaj periudhe. Si burim alternative të teksteve shkollore, ata i inkurajojnë nxënësit të mbështeten në internet për të hulumtuar ngjarje të mëdha dhe figura historike. Por interneti është burim problematik i informimit pa mbikëqyrje të afërt akademike, dhe mund të përjetësojë dezinformatat dhe konspiracionet.

Një problem i madh i një historie të tillë të prodhuar pa u bazuar në studim për Luftën e Dytë Botërore është se për shkak që historitë zyrtare nacionale, të serbëve dhe shqiptarëve, janë të përqendruara që ta portretizojnë secilin popull si viktimë të krimeve dhe asnjëherë si kryes të ndonjë krimi, asnjëra prej tyre nuk do të ballafaqohet me çështjet kontroverse dhe të komplikuara, siç është bashkëpunimi me regjimet naziste dhe fashiste. Kjo gjendje nuk është unike për Kosovën e as për Serbinë, siç edhe shkruan detajisht në librin e botuar së fundi nga Istvan Deak.<sup>107</sup>

Bashkëpunimi minimizohet për të justifikuar qëllimin nacional, siç është rasti me bashkëpunimin e shqiptarëve me okupatorët fashist dhe nazist për ta mbajtur Kosovën dhe Shqipërinë të bashkuar, ose në rastin e Serbisë në kohën e Gjeneralit Nedić kur bashkëpunonte me gjermanët nazist, e Nedić konsiderohej si “shpëtimtar” i serbëve që po iknin nga Shteti i Pavarur i Kroacisë (NDH). Bashkëpunimi po ashtu mund të diskutohet vrazhdë duke e vënë një grup të tërë nacional në “anën e gabuar”, siç është rasti me refuzimin e serbëve që të njohin çfarëdo pjesëmarrje të shqiptarëve në rezistencën anti-fashiste.

Këto histori nacionale nuk i pranojnë faktet e vërtetuara mirë, gjë që do t'i vendoste shtetet e tyre në dritë negative. Shqiptarët mohojnë dëbimin e dhunshëm të kolonëve serb dhe malazez gjatë luftës. Serbët mohojnë dhunën ndaj popullatës shqiptare nga cilado anë – qoftë nga partizanët apo četnikët e përfshirë në Luftën e Dytë Botërore.

Kur i konfrontuam mësimdhënësit me narracionet e Luftës që përbëjnë alternativë ndaj narracioneve të tyre nacionale, hasëm në rezistencë në të dyja grupet. Mosbesimi në historiografitë që sfidojnë narracionet e tyre nacionale ose për të qenë më të saktë, narracionet historike të ndikuara nga komunitetet e tyre shoqërore dhe politike, është thellësisht i rrënjësor në trashëgiminë e historiografisë pas Luftës së Dytë Botërore – që ishte në mënyrë konsistente shumë ideologjike dhe e ndryshueshme, në përputhje me statusin politik të Kosovës dhe Serbisë.

Një njeri që e tha këtë troç ishte një nxënës në Prishtinë, i cili tha “mua nuk më pëlqen historia, nuk i besoj historisë, sepse nuk ka fakte, gjithmonë është dikush që vjen na tregon se çfarë është historia – fillimisht ishin jugosllavët, pastaj UNMIK-u, pastaj Turqia.” Megjithatë, trysnia politike nuk ndjehet vetëm nga jashtë. Ajo është karakteristike e politikës së brendshme dhe kontrollit social.

---

107 Istvan Deak, *Europe on Trial: The Story of Collaboration, Resistance, and Retribution During World War II* (Westview, 2015).

## SHTOJCA A: KONTEKSTI LIGJOR

Në Kosovën e sotme botimi i librave shkollor vazhdon të udhëhiqet nga Ligji Nr. 02/L-67, i bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të 15 majit, 2001 (UNMIK është Misioni i OKB-së në Kosovë). Ligji është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 29 qershor, 2006. Në të përcaktohet që librat shkollor duhet të përmbushin standardet edukative, shkencore, pedagogjike, psikologjike, didaktike/metodologjike, etike, gjuhësore, artistike dhe teknike në përputhje me standardet dhe qëllimet e caktuara të kurrikulës arsimore. Librat shkollor mund të përmbajnë propagandë kundër Kosovës, material që promovon shkeljen e të drejtave të njeriut apo të parimeve të barazisë gjinore, apo material që nxitë urrejtje në baza fetare, politike apo kombësisë. Ligji gjithashtu përcakton që librat shkollor duhet të redaktohen nga specialistë të fushës relevante shkollore. Specialistë janë të zgjedhur në bazë të konkursit të hapur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHT). Procedurat për përpilimin dhe redaktimin e librave shkollor mbikqyren nga ekspertët e MASHT-it. Vlerësimi kritik për përmbajtjen e shkuar në librat shkollor bëhet nga recensentët.

Ligji për arsimin parauniversitar në vend, Ligji nr. 04/L-032 i 29 gushtit 2011 bazohet në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që përcakton që arsimi parauniversitar është i organizuar në bazë të niveleve të ISCED (Standardit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit) dhe në përputhje me fazat kryesore të kornizës kombëtare të kurrikulës së Kosovës (Kompetencat kryesore të BE-së LLL 2009). Arsimi parauniversitar në Republikën e Kosovës organizohet në fazat e pesë të parave, pastaj katër, pastaj edhe tri vjet shtesë.

Sipas Ligjit të vitit 2015 për Librat Shkollor në Serbi, shkollat duhet t'i zgjedhin të paktën tri tekste shkollore për secilën lëndë nga lista e ofruar nga Ministria e Arsimit dhe Zhvillimit Teknologjik. Lista e librave shkollor të historisë që mbulon periudhën e shekullit 20 dhe fillimshkullin e 21 përbëhet nga katër libra kryesor shkollor (Shih Shtojca B). Analiza jonë është e përqëndruar në tre librat më të rinj shkollor, ndërkohë që libri i katërt shkollor është i bazuar në burime dytësore.

## **Shtojca B – Libra Shkollorë**

### ***Libra Shkollorë të Kosovës [siç janë koduar në raport]***

A1. Fehmi Rexhepi dhe Isa Bicaj, *Historia 9*. Libri Shkollor, 2004.

A2. Fehmi Rexhepi, *Historia 9*. Libri Shkollor 2015.

B1. Jusuf Bajraktari, Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj. *Historia (10)*. Gjinnazi matematikë dhe informatikë/Gjinnazi I shkencave natyrore. Libri Shkollor, Prishtinë, 2004

B2. Jusuf Bajraktari, Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj. *Historia (10)*. Gjinnazi matematikë dhe informatikë/Gjinnazi I shkencave natyrore. Libri Shkollor, Prishtinë, 2012

C. Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj, *Historia 11*. Gjinnazi I gjuhëve, Libri Shkollor 2004

C2. Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj, *Historia 11*. Gjinnazi I gjuhëve, Libri Shkollor 2013

D1. Isa Bicaj dhe Isuf Ahmeti, *Historia 12*. Gjinnazi Shoqëror. Libri Shkollor, 2005

D2. Isa Bicaj dhe Isuf Ahmeti, *Historia 12*. Gjinnazi Shoqëror. Libri Shkollor, 2012.

### ***Libra Shkollorë të Serbisë***

1. Mira Radojević, *Istorija IV - udžbenik za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera, četvrti razred gimnazije društveno-jezičkog smera i opšteg tipa i četvrti razred srednje stručne škole za obrazovne profile pravni tehničar i birotehničar*, 2014.

2. Djordje Djurić, Momcilo Pavlović, *Istorija za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera i četvrti razred gimnazije opšteg i društveno-jezičkog smera*, 2010 and 2012.

3. Radoš Ljušić, Ljubodrag Dimić, *Istorija za treći razred gimnazije prirodno-matematičkog smera i četvrti razred gimnazije društveno-jezičkog smera*, 2013.

4. Kosta Nikolić, Nikola Zutić, Momcilo Pavlović, Zorica Špadijer, *Istorija za gimnazije opšteg i društveno-jezičkog smera + dodatak*, 2002.

## Shtojca C – Lista e Intervistave

Intervista	Rajoni	Gjinia	Ditëlindje	Përvoja	Statusi	Data e intervistës
1.	Prishtina/Priština	F	1968	Para +Pas Luftës	Mësuese	19/5
2.	Vushtrri/Vuçitrn	M	1980	Pas Luftës	Mësues	19/5
3.	Prizren/Prizren	M	1958	Pas Luftës	Mësues	26/5
4.	Vushtrri/Vuçitrn	M	1980	Pas Luftës	Mësues	19/5
5.	Klina/Klina	F	1959	Para+Pas Luftës	Mësuese	23/5
6.	Prishtina/Priština	M	1960s	Para+Pas Luftës	Mësues	17/5
7.	Mitrovica/Mitrovica	F	1982	Pas Luftës	Mësuese	19/5
8.	Gjakova/Djakovica	M	1962	Para+Pas Luftës	Mësues	31/5
9.	Mitrovica/Mitrovica	M	1955	Para+Pas Luftës	Mësues	19/5
10.	Prizren/Prizren	M	1977	Pas Luftës	Mësues	26/5
11.	Klina/Klina	M	1953	Para+Pas Luftës	Mësues	23/5
12.	Gjakova/Djakovica	M	1962	Para+Pas Luftës	Administr.	26/5 & 31/5
13.	Skënderaj/Srbica	M	1980	Pas Luftës	Mësues	21/5
14.	Gjakova/Djakovica	F	1960s	Para+Pas Luftës	Mësuese	31/5
15.	Peja/Peç	M	1951	Para+Pas Luftës	Pensionist	24/8
16.	Prishtina/Priština	M	1950	Para+Pas Luftës	Pensionist	17/5
17.	Gjilan/Gnjilane	M	1943	Para+Pas Luftës	Pensionist	25/8
18.	Prishtina/Priština	F	1950s	Para+Pas Luftës	Mësuese	17/5
19.	Prishtina/Priština	M	1973	Para+Pas Luftës	Mësues	25/5
20.	Prishtina/Priština	M	1945	Para+Pas Luftës r	Pensionist	25/5
21.	Kosovska Mitrovica/ Mitrovica veriore	M	1973	10 vjet	Mësues	9/6
22.	Kosovska Mitrovica/ Mitrovica veriore	F	1969	23 vjet	Mësuese	9/6
23.	Kosovska Mitrovica/ Mitrovica veriore	M	1985	6 vjet	Mësues	9/6
24.	Gračanica/Gračanica	M	1977	12 vjet	Mësues	10/6
25.	Gračanica/Gračanica	M	1972	16 vjet	Mësues	10/6